



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 576 Akti

Nr. 607 Vendimi
Tiranë, më 22.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datat 19.12.2022 dhe 22.12.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kledian Llaho**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit

Kledian Llaho, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VË R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Kledian Llaho është subjekt i rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara: (i) nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Kledian Llaho, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike në datën 23.7.2020 se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 30.11.2022, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Kledian Llaho; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 1.12.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 14.12.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Pasi ishte njohur me aktet e dosjes në datën 5.12.2022 dhe ka marrë kopje të tyre, në datën 14.12.2022, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 15.12.2022, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

9. Në datën 19.12.2022 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga DSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ/KLP-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 25.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të

zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, z. Kledian Llaho është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004, kur ka dorëzuar deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPFDF) si oficer i policisë gjyqësore (në vijim OPGJ) me nr. indeksi ***. Në vitin 2014 ka plotësuar DPFDF si prokuror dhe, në vijim, ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) si prokuror.

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Kledian Llaho, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) janë përfituar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho, si dhe të personave të lidhur me të.

17. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

18. *Garazh me sip. 23 m², ndodhur në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, Durrës, blerë në prill të vitit 2014 nga kursimet familjare, me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.4.2014. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.*

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

18.1. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë nga aktet¹ rezultoi se:

- Sipas certifikatës së pronësisë, lëshuar në datën 13.12.2012 nga ZVRPP-ja Durrës, pasuria nr. ***, e llojit “garazh”, me sip. 23 m², ka qenë në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.
- Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 17.4.2014, z. Kledian Llaho e ka blerë këtë pasuri nga shoqëria “****” sh.p.k., në çmimin 500.000 lekë.
- Pasuria është regjistruar në pronësi të shtetasve Kledian I. Llaho dhe L. V. Ll., sipas certifikatës së pronësisë në datën 24.4.2014.
- Në DPFDF/2014, subjekti ka deklaruar pasurinë garazh me sip. 23 m², me burim kursimet familjare, ashtu sikurse edhe në deklaratën *Vetting*.

¹Shihni shkresat nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 25.8.2021, të ASHK Drejtoria Vendore Durrës në dosjen e Komisionit; aneksin nr. 4/2 dhe aneksin nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

- ASHK Drejtoria Vendore Durrës ka konfirmuar se pasuria nr. *** ka kaluar në pronësi të shtetasit O. T. me kontratën e shitjes së datës 14.4.2018.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë së kësaj pasurie, e cila është blerë përpara se subjekti të fillonte detyrën (datë 20.6.2014).

18.2. Duke qenë se garazhi është blerë gjatë kohës që subjekti nuk ka pasur automjet në pronësi dhe pavarësisht faktit se sipas shkresës nr. *** prot., datë 12.11.2022², të Komisarariatit të Policisë Sarandë, në emër të tij dhe bashkëshortes nuk ka pasur asnjë masë administrative për shkelje të Kodit Rrugor, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me blerjen e garazhit pa pasur një automjet në pronësi. Në parashtrimet e tij subjekti sqaroi se në deklaratën përpara fillimit të detyrës, të plotësuar në korrik të vitit 2014, ka deklaruar automjetin “Volkswagen”, të blerë në qershor të vitit 2013, deklarim i cili është i saktë, pasi në momentin e blerjes së garazhit në vitin 2014, ai ka pasur në pronësi automjetin me targa ***, blerë në datën 4.6.2013³.

18.3. Sa i takon likuidimit të çmimit 500.000 lekë, për të cilin janë deklaruar si burim kursime familjare, u konstatua se sipas kontratës së shitjes me datë 17.4.2014, çmimi prej 500.000 lekësh është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 subjekti sqaroi se çmimi i blerjes së garazhit është dakordësuar në vitin 2010 me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k., z. P. K., dhe pagesat janë bërë *cash* në tri këste: 100.000 lekë përgjatë viteve 2011 – 2013 dhe kësti i fundit me vlerë 200.000 lekë, kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes në vitin 2014. Subjekti paraqiti deklaratën noteriale të z. P. K., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit. Meqenëse pasuria objekt verifikimi është blerë përpara fillimit të detyrës, Komisioni iu referua deklaratimeve të subjektit dhe administratorit të shoqërisë në lidhje me pagesat *cash* dhe shuma prej 500.000 lekësh është konsideruar si shpenzim në analizën financiare të kryer për periudhën para fillimit të detyrës, e cila në përfundim të hetimit administrativ rezultoi me balancë negative. Në ushtrim të barrës së provës, subjekti ka paraqitur parashtrimet dhe dokumente shkresore duke kundërshtuar konstatimin e Komisionit (trajtuar hollësisht në paragrafët 49, 50 dhe 51 të këtij vendimi).

19. *Depozitë bankare në “Credins Bank”, çelur në datën 8.7.2015, me afat dyvjeçar dhe interes 3.5 %, si rezultat i shitjes së apartamentit me sip. 105 m², kontratë shitjeje nr. ***, para noterit F. H., datë 24.4.2015. Apartament i ndodhur në Lagjen Nr. ***, Durrës, blerë në muajin mars 2014, me të ardhurat: pjesërisht nga kursimet familjare; nga kredia në “Raiffeisen Bank”; ndihmesë nga vëllai i punësuar në Itali; dhe pjesërisht ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes. Vlera: 5.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.*

Në lidhje me këtë depozitë, ILDKPKI-ja ka konstatuar: Për blerjen e apartamentit me sip. 105 m² rezultojnë dy vlera, kontrata e sipërmarrjes në shumën 54.000 euro dhe kontrata e shitblerjes në shumën 50.000 euro. Gjithashtu, nuk ka paraqitur dokumentacion (aktmarrëveshje) për dakordësimin e ndryshimit të çmimit. Lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 105 m², përveç kredisë bankare, është e paqartë vlera konkrete e dhënë nga prindërit e bashkëshortes së subjektit nga vëllai i subjektit, si dhe kontributit të vetë subjektit.

²Shihni përgjigjet në pyetësorin datë 11.11.2022.

³Shihni kontratën në shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2022, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë depozitë

19.1. Në lidhje me krijimin e depozitës rezultoi se:

- Sipas kopjes së kontratës së depozitës me afat me interes preferencial, të datës 8.7.2015⁴, mes “Credins Bank” dhe z. Kledian Llaho vërtetohet çelja e depozitës në vlerën 5.000.000 lekë me afat maturimi 24-mujor, datë maturimi 8.7.2017, me interes 3.5%.

- “Credins Bank” ka konfirmuar këto të dhëna⁵ dhe sipas ekstraktit të llogarisë bankare në lekë, në llogari të z. Kledian Llaho, në datën 8.7.2015 është transferuar shuma 5.000.000 lekë me përshkrimin “transferte me/nga banka të tjera, kalim fondi në llogarinë personale në ‘Credins Bank’ të ardhura nga shitja e apartamentit”.

19.2. Subjekti nuk e ka deklaruar këtë depozitë në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë së DPV/2015”, sikurse e kërkon ligji, por gabimisht e ka deklaruar në rubrikën “Përshkrimi i detyrimeve”, ku ka deklaruar shumë qartë depozitën me afat në vlerën 5.000.000 lekë, në datën 8.7.2015, nga të ardhurat e shitjes së apartamentit. Gjatë hetimit administrativ u verifikua që kjo depozitë është krijuar me të ardhura nga shitja në vitin 2015 të apartamentit me sip. 105 m², të blerë në muajin mars 2014. Konkretisht, nga dokumentet shkresore të administruara⁶, rezultoi se:

- ASHK Drejtoria Vendore Durrës ka konfirmuar se në emër të shtetasve Kledian dhe L. Ll. ka qenë pasuria nr. ***, z.k. ***, e llojit “apartament”, me sip. 105 m².

- Sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. ***, datë 24.4.2015, shtetasit Kledian dhe L. Ll. ia kanë shitur këtë pasuri shtetasit R. T., në çmimin 7.000.000 lekë, likuidimi i të cilit do të bëhet në këtë mënyrë:

i) *Kësti parë në shumën 2.000.000 lekë paguhet me datë 24.4.2015, nëpërmjet “Tirana Bank” nga llogaria e blerësit tek llogaria e shitësit.* Subjekti ka paraqitur mandat bankar me datë 24.4.2015 të “Tirana Bank”, sipas të cilit shtetasi R. T.

ka transferuar shumën 2.000.000 lekë, me përshkrimin “për Kledian Llaho I., pagesë kësti për blerje apartamenti”, vërtetuar edhe nga Komisioni nëpërmjet lëvizjeve të llogarisë pranë “Tirana Bank”⁷.

ii) *Kësti i dytë në shumën 5.000.000 lekë do të paguhet në fund të muajit qershor 2015, në bankë, tek llogaria e noterit për tjetërsim pasurie.* Subjekti ka paraqitur njoftim debitimi datë 24.6.2015 të “Raiffeisen Bank”, ku vërtetohet se shtetasi R. A. T. ka kaluar shumën 5.000.000 lekë për tjetërsim pasurie nr. ***, pagesë kësti i dytë, në llogarinë e noterit F. H., vërtetuar edhe nga Komisioni nëpërmjet lëvizjeve në llogarinë pranë “Raiffeisen Bank”.

- Nga lëvizjet e llogarisë së “Raiffeisen Bank”, evidentohet se në datën 6.7.2015 është transferuar shuma 5.000.000 lekë nga llogaria e noterit F. H. në llogarinë e subjektit me përshkrimin “shumë përfundimtare sipas kontratës së shitjes nr. *** dhe deklaratës nr. ***, urdhëruesi F. H. PF”.

- Në datën 7.7.2015, shuma 5.000.000 lekë është transferuar nga subjekti, nga “Raiffeisen Bank” në “Credins Bank”, me përshkrimin “të ardhura nga shitja e

⁴Shihni aneksin nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2021, të “Credins Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁶Shihni aneksin nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., *** prot., datë 25.8.2021, të ASHK Drejtoria Vendore Durrës në dosjen e Komisionit.

⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.5.2021, të “Tirana Bank”, në dosjen e Komisionit.

apartamentit”. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së subjektit në “Credins Bank” është evidentuar edhe kreditimi i kësaj shume në këtë bankë në datën 8.7.2015, dhe se shuma 5.000.000 lekë është investuar në depozitë me afat 2-vjeçar, me maturim deri në datën 10.7.2017.

Sa më sipër, rezultoi se deklaramet e subjektit në lidhje me burimin e krijimit të depozitës objekt verifikimi në “Credins Bank” me të ardhura nga shitja e pasurisë apartament me sip. 105 m², është i saktë.

Hetimi i Komisionit për apartamentin me sip.105 m², blerë në vitin 2014 dhe shitur në vitin 2015

20. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë së këtij apartamenti, në rend kronologjik nga aktet në dosje⁸, rezultoi se:

- Sipas kontratës së sipërmarrjes datë 16.7.2010, subjekti Kledian Llaho ka porositur pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator shtetasin P. K., një apartament në katin e gjashtë të një godine në Durrës, me sipërfaqe apartamenti dhe ambienteve të përbashkëta 113 m², në shumën 54.000 euro.

- Sipas certifikatës së pronësisë, lëshuar në datën 13.12.2012, nga ZVRPP-ja Durrës, pasuria me nr. ***, apartament me sip. 105.26 m², figuron në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.

- Sipas kontratës nr. ***, datë 29.3.2014, z. Kledian Llaho ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë me nr. ***, apartament me sip. 105.26 m², në çmimin 50.000 euro.

- Sipas kartelës së pasurisë dhe certifikatës së pronësisë vërtetohet regjistrimi i pasurisë në datën 24.4.2014, në emër të shtetasve Kledian dhe L. Ll. Në DPFD/2014, subjekti ka deklaruar apartamentin me sip. 105 m², të blerë në mars 2014, në vlerën 50.000 euro dhe pjesën takuese 50%.

- Nga krahasimi i kontratës së sipërmarrjes me kontratën e shitjes rezultoi se: (i) kontrata e sipërmarrjes kishte për objekt apartamentin me sip. totale 113 m², ndërsa kontrata e blerjes apartament me sip. 105.26 m²; (ii) çmimi i porositjes sipas kontratës së sipërmarrjes ishte 54.000 euro, ndërsa çmimi i shitjes në kontratën e shitjes është 50.000 euro.

- Sa i takon ndryshimit të sipërfaqeve, me kërkesë të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti konfirmoi se bëhet fjalë për të njëjtin apartament, duke shpjeguar se në kontratën e prenotimit është përfshirë edhe ambienti i përbashkët, ndërsa në kontratën e shitjes është përcaktuar vetëm sipërfaqja e apartamentit, sikurse është pasqyruar në regjistrimin në ZVRPP, pretendim i cili vlerësohet i bazuar, pasi është një fakt që ka ndodhur shpesh në praktikë.

- Sa i takon ndryshimit të çmimit të blerjes, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ashtu sikurse edhe në deklaramet në ILDKPKI, në datën 10.2.2016⁹, subjekti ka deklaruar se kjo ka qenë për shkak se shoqëria e ndërtimit u vonua në përfundimin e pallatit, pasi sipas kontratës së sipërmarrjes ishte parashikuar se apartamenti do të dorëzohej në datën 26.5.2011 dhe për çdo ditë vonesë parashikohej penalitet për shoqërinë. Sipas subjektit, çmimi i shitjes është ndryshuar me marrëveshje të palëve, vërtetuar me deklaratë

⁸Shihni aneksin nr. 4/3 dhe dokumentet e paraqitur nga subjekti si kopje: kontratë sipërmarrjeje datë 16.7.2010; kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.3.2014 në dosjen e ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., *** prot., datë 25.8.2021 të ASHK Drejtoria Vendore Durrës në dosjen e Komisionit dhe anekset nr. 28 dhe nr. 40, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.6.2021, të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

noteriale të administratorit P. K, i cili deklaroi se diferenca/ulja në çmimin e shitjes prej 4.000 euro ka ndodhur me marrëveshje dhe mirëkuptim mes palëve, për shkak të vonesës në kohë të dorëzimit të apartamentit. Pretendimet e subjektit, konfirmuar edhe nga administratori i shoqërisë, çmohen të vërteta referuar kontratës së porosisë, ku parashikohet se: *“Sipërmarrësi detyrohet të përfundojë dhe dorëzojë apartamentin deri në datën 26.5.2011 dhe për çdo ditë vonesë detyrohet të paguajë një gjobë prej 0.02 %”*. Ndërkohë, regjistrimi i pasurisë në emër të shoqërisë është kryer në datën 13.12.2012.

- Nga verifikimi i kryer nuk rezultoi që subjekti të ketë qenë në kushtet e një konflikti interesi me shoqërinë dhe administratorin e saj¹⁰.

- Në përfundim të hetimit administrativ, pasuria objekt verifikimi, e cila është porositur dhe është blerë në mënyrë të ligjshme përpara se subjekti të fillonte detyrën, është konsideruar e blerë në çmimin 50.000 euro, sikurse e përcaktuar në kontratën përfundimtare të shitjes me datë 29.3.2014.

21. Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit prej 50.000 euro për blerjen e apartamentit me kontratë nr. ***, datë 29.3.2014, pasi u administruan aktet e paraqitura prej subjektit në ILDKPKI¹¹, gjatë hetimit administrativ subjektit iu kërkuan sqarime dhe dokumentacion provues për kryerjen e të gjitha pagesave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit të tij, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 deklaroi se nga data 17.6.2010 deri më 4.1.2012 janë kryer pesë pagesa në shumën totale 49.000 euro, ndërsa vlera 1.000 euro është paguar *cash*. Deklarimet e subjektit janë konfirmuar edhe me deklaratën nr. ***, datë 29.5.2021, të administratorit të shoqërisë P. K. Pesë pagesat e deklaruara janë vërtetuar me dokumentet shkresore, si vijojnë:

- Depozitë në arkë në datën 16.7.2010, në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., në “Alpha Bank”, Durrës, shuma 10.000 euro, me përshkrimin “Kledian Llaho likuidim pjesor apartament”.

- Depozitë në arkë datë 22.12.2010¹², në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., në shumën 20.000 euro, me përshkrimin “derdhje nga Kledian Llaho likuidim pjesor blerje apartamenti”.

- Dokument nxjerrje llogarie në emër të shtetasës E. Ll. (nëna e subjektit) nga “ProCredit Bank”, sipas të cilit është paguar prej saj në datën 29.4.2011, shuma 10.000 euro. Sipas subjektit, kjo pagesë është kryer nga nëna e tij për blerjen e apartamentit të tij, por, në fakt, në përshkrimin e veprimit “për blerje apartamenti” nuk përcaktohet emri i subjektit.

- Mandatpagesë e shtetasit A. Ll. (vëllai i subjektit) në BKT, dega Durrës, sipas së cilës në datën 8.8.2011 është paguar shuma 7.000 euro, pa përcaktuar për cilin apartament është kryer kjo pagesë. Në lidhje me këtë pagesë, subjekti deklaroi se është ndihmë e vëllait për blerjen e apartamentit të tij dhe paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.6.2022, të shtetasit A. Ll., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

¹⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.10.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

¹¹Shihni aneksin nr. 4/3 dhe nr. 40 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹²Një pjesë e kësaj shume është përfituar me kredi bankare për të cilën në pyetësorin nr. 3 subjekti ka paraqitur dokumentin banka “veprim në arkë” datë 22.12.2010, të “Raiffeisen Bank”, me përshkrimin “Kledian Llaho tërheqje nga llogaria *cash* 2.427.000 lekë”, kredi e marrë sipas kontratës nr. ***, datë 16.12.2010 (trajtuar në vijim).

- Depozitim *cash* në valutë në BKT, datë 4.01.2012, në shumën 2.000 euro, në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kledian Llaho derdhje këst apartamenti”.

22. Siç vërehet nga të dhënat e mësipërme, për blerjen e pasurisë apartament objekt verifikimi, përveç subjektit janë kryer pagesa edhe nga vëllai i tij A. Ll. (7.000 euro) dhe nga nëna e tij E. Ll. (10.000 euro). Ndërkohë, në lidhje me këta dy shtetas, gjatë hetimit administrativ u evidentuan faktet si vijojnë:

- Me prokurorë të përgjithshme nr. ***, datë 1.6.2013, shtetasi A. Ll., blerës, ka emëruar përfaqësues z. Kledian Llaho, për të nënshkruar kontratë shitblerjeje apartamenti pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator P. K., në Lagjen Nr. ***, rrua “****” Durrës.

- “ProCredit Bank”¹³, ka konfirmuar llogarinë rrjedhëse në euro nr. *** në emër të znj. E. Ll., hapur në datën 1.12.2007 dhe mbyllur në datën 5.1.2017, ku vërehen veprimet si vijojnë: (i) në datën 13.9.2010 është paguar shuma 10.000 euro, me përshkrimin “E. Ll. për P. K. lik. pjesor blerje apartament A. Ll.”; (ii) në datën 2.3.2011 është paguar shuma 9.000 euro, me përshkrimin “Ll. E. H., E. Ll. për P. K. blerje apartamenti A. Ll., K. P. A.”; (iii) në datën 29.4.2011 është paguar shuma 10.000 euro, me përshkrimin “Ll. E. H., E. Ll. P. K. blerje apartamenti, K. P. A.”.

23. Nga të dhënat si më sipër, rezultoi se: (i) vëllai i subjektit shtetasi A. Ll., ka paguar shumën 7.000 euro në datën 8.8.2011 për apartamentin e blerë nga subjekti, ndërkohë që ka porositur një apartament banimi pranë të njëjtës shoqëri ndërtimore dhe në të njëjtën godinë që ndodhet apartamenti i blerë nga subjekti; (ii) nëna e subjektit E. Ll., në dy raste ka kryer pagesa për pasuri të z. A. Ll. dhe në një rast tjetër, ka kryer një pagesë në shumën 10.000 euro në datën 29.4.2011, pa emër personi, e cila sipas subjektit është për apartamentin e blerë nga subjekti.

24. Në këto kushte, është bërë e domosdoshme kryerja e veprimeve verifikuese në lidhje me pasurinë apartament të blerë nga vëllai i subjektit A. Ll., me qëllim heqjen e çdo dyshimi për një pasuri të mundshme të fshehur të subjektit të rivlerësimit si dhe për: (i) vërtetimin e faktit që pagesa e kryer prej këtij shtetasi në shumën 7.000 euro në datën 8.8.2011, në BKT, dega Durrës ka qenë për apartamentin e blerë nga subjekti i rivlerësimit (pra, jo për blerjen e pasurisë së tij), si dhe, (ii) vërtetimin e faktit që pagesa prej 10.000 euro e kryer nga znj. E. Ll. në datën 29.4.2011 në “ProCredit Bank”, ka qenë pagesë për apartamentin e subjektit (pra, jo për blerjen e pasurisë nga djali tjetër A. Ll.).

Në lidhje me apartamentin e blerë nga A. Ll.

25. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se vëllai i tij A. Ll. ka blerë një apartament me nr. pasurie ***, me sip. 99.6 m², nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 50.000 euro, për të cilin nga data 17.2.2010 deri në datën 8.11.2011, janë kryer gjashtë pagesa në shumën totale 49.000 euro (1.000 euro paguar me lidhjen e kontratës së shitjes). Subjekti i vërtetoi këto deklarime me dokumentet shkresore si vijojnë:

- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.8.2013 në emër të z. A. Ll.;
- depozitë në arkë në “Alpha Bank” në datën 8.11.2010, me përshkrimin “A. Ll. likuidim pjesor blerje apartamenti”, në shumën 3.000 euro;
- depozitë në arkë në “Alpha Bank” në datën 8.11.2010, me përshkrimin “A. Ll. likuidim pjesor blerje apartamenti”, në shumën 2.000 euro;

¹³Shihni shkresën nr. ***, datë 9.6.2021, në dosjen e Komisionit.

- depozitë në arkë në “Alpha Bank” datë 20.5.2010, me përshkrimin “derdhje nga A. Ll. likuidim pjesor blerje apartamenti”, në shumën 10.000 euro;
- urdhërpagesë të “ProCredit Bank” datë 13.9.2010, me përshkrimin “E. Ll. për P. K., lik pjesor blerje apartamenti A. Ll.”, në shumën 10.000 euro;
- depozitë në arkë të “Alpha Bank” datë 17.2.2010, me përshkrimin “derdhje nga A. Ll. likuidim pjesor blerje apartamenti”, në shumën 15.000 euro;
- urdhërpagesë e datës 2.3.2011 e “ProCredit Bank” me përshkrimin “E. Ll. për P. K. blerje apartamenti A. Ll.” në shumën 9.000 euro;
- deklarate noteriale nr. ***, datë 11.6.2022 e z. A. Ll., i cili deklaron se të gjitha kursimet e tij nga puna në Shqipëri dhe Itali ia ka administruar nëna e tij E. Ll., një pjesë të cilave i ka mbajtur në shtëpi, dhe se, të gjitha pagesat e kryera në bankë për shlyerjen e pagesave të apartamentit, janë kryer me porosinë e tij verbale nga Italia;
- shkresë e ASHK Durrës sipas së cilës z. A. Ll., nuk ka pasuri të regjistruar në emër të tij.

26. Nisur nga informacioni i ASHK-së që subjekti paraqiti, duke qenë e paqartë përse shtetasi A. Ll. nuk e ka pasur të regjistruar apartamentin e blerë prej tij, iu kërkua subjektit të japë sqarime e dokumente¹⁴ në lidhje me këtë fakt, të vërtetojë statusin juridik/pronësinë aktuale të apartamentit, të sqarojë se nga kush është përdorur apartamenti duke vënë në dispozicion librezat dhe pagesat e energjisë elektrike dhe ujit. Gjithashtu, nisur nga një depozitim në emër të nënës së subjektit E. Ll. në “Credins Bank”, në shumën prej 35.000 euro në datën 3.9.2018, u pyet subjekti në lidhje me faktin se çfarë përfaqësonte ky depozitim. Në përgjigjet e tij¹⁵, subjekti ka deklaruar se: (i) apartamenti me sip. 99.6 m², blerë nga i vëllai i tij A. Ll. me kontratën nr. ***, datë 28.8.2013, është i regjistruar në emër të vëllait dhe bashkëshortes së tij sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, lëshuar në datën 2.10.2013; (ii) kjo pasuri është përdorur nga vëllai me familjen e tij nga muaji gusht 2013 deri në muajin gusht 2016 kur është shitur me kontratë shitjeje noteriale me datë 8.10.2016, në çmimin 35.000 euro. Sipas subjektit, kjo shumë është depozituar në “Credins Bank” nga nëna e tij E. Ll., e cila ka administruar të gjitha kursimet e vëllait A. nga puna në Shqipëri dhe Itali, sikurse ky i fundit ka konfirmuar edhe me deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.6.2022.

Deklarimet e tij, subjekti i ka vërtetuar me dokumentet e poshtëshënuara¹⁶:

- kontratë nr. ***, datë 28.8.2013 që vërteton blerjen e pasurisë nr. ***, apartament me sip. 99.6 m² nga z. A. Ll. dhe dokumentet bashkëlidhur;
- certifikatë pronësie të pasurisë lëshuar në datën 2.10.2013, kartelë dhe hartë treguese në emër të A. dhe L. Ll.;
- kontratë shitjeje nr. ***, datë 8.10.2016, që vërteton shitjen e kësaj pasurie nga shtetasi A. dhe L. Ll., bashkëlidhur prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 26.8.2016, me anë të së cilës shtetasi A. dhe L. Ll., kanë autorizuar znj. E. Ll. për nënshkrimin e kontratës së shitjes;
- mandat bankar për depozitim e shumës 35.000 euro nga nëna e blerësit B. C. në llogari të ‘F. H.’ PF, në “Raiffeisen Bank”;

¹⁴Shihni *email*-in dërguar subjektit të rivlerësimit datë 11.11.2022.

¹⁵Shihni përgjigjet e protokolluara me nr. *** prot., datë 16.11.2022 dhe dokumentet bashkëlidhur.

¹⁶Në parashtrimet e veta, me kërkesë të Komisionit, subjekti i ka paraqitur dokumentet shkresore të noterizuara.

- fatura të OSHE-së për abonentin A. Ll. për periudhën kohore janar 2012 -dhjetor 2016, të nxjerra në formatin elektronik, nga ku duket se gjatë kësaj periudhe ka faturime të energjisë elektrike paguar nga ky abonent;
- shkresë të subjektit drejtuar UK Durrës, sipas së cilës ka kërkuar informacion mbi kontratën dhe faturat e ujit të abonentit A. Ll., për të cilën ka shpjeguar se nuk ka mundur të marrë përgjigje.

27. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në të gjitha sa më sipër, rezultoi e vërtetuar se:

- i) Vëllai i subjektit A. Ll. ka blerë në datën 28.8.2013 një apartament banimi nga e njëjta shoqëri ndërtuese dhe në të njëjtën godinë që subjekti ka blerë apartamentin e tij, apartament të cilin e ka përdorur deri në datën 8.10.2016 kur e ka shitur;
- ii) Znj. E. Ll. ka kryer dy pagesa në “ProCredit Bank” përkatësisht në datat 13.9.2010 dhe 2.3.2011 për blerje apartamenti të shtetasit A. Ll., fakt që tregon se pagesa e datës 29.4.2011 paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, e cila nuk ka emër personi, është për apartamentin e blerë nga subjekti i rivlerësimit, ashtu sikurse ai pretendon (në vijim Komisioni ka analizuar justifikimin e kësaj shume me të ardhura të ligjshme, paragrafët nr. 29/6 dhe 32/3 pika ii e këtij vendimi).
- iii) Nuk rezulton të jetë kryer ndonjë pagesë nga shtetasi A. Ll. në datën 8.8.2011 për blerjen e apartamentit të tij. Ky fakt tregon që pagesa e kryer prej këtij shtetasi në shumën 7.000 euro pikërisht në datën 8.8.2011 në BKT dega Durrës paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka qenë për blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, ashtu sikurse ai pretendon (në vijim Komisioni ka analizuar justifikimin e kësaj shume me të ardhura të ligjshme, paragrafi nr. 31 i vendimit).

Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 105.26 m² blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën 29.3.2014 dhe shitur më 24.4.2015

28. Në deklaratën *Vetting*, si burim i krijimit të këtij apartamenti të blerë në çmimin 50.000 euro, janë deklaruar të ardhurat pjesërisht: (i) nga kursimet familjare; (ii) nga kredia në “Raiffeisen Bank”; (iii) ndihmesë nga vëllai i punësuar në Itali; (iv) ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes. Në DPF/2014, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: (i) kursimet familjare; (ii) kredi në “Raiffeisen Bank”; dhe (iii) pjesërisht ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes.

Siç vërehet, ka një mospërputhje të burimeve në deklaratën *Vetting* dhe në DPF/2014, pasi në këtë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar ndihmën nga vëllai i punësuar në Itali dhe shumën e dhënë nga nëna e tij. Gjatë hetimit subjekti është pyetur në lidhje me këtë mospërputhje dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ai deklaroi se apartamenti është blerë para fillimit të detyrës si prokuror, ku kësti i parë i pagesës daton thuhetse 4 vjet para fillimit të detyrës. Gjithashtu, subjekti sqaron se me termin “pjesërisht nga kursimet familjare” në DPF/2014, e cila ka qenë eksperiencia e parë e deklarimeve, ka pasur parasysh edhe pjesën financiare të nënës dhe vëllait duke i përfshirë si të ardhura nga kursimet familjare. Kjo për faktin se ata kanë qenë në një certifikatë familjare. Gjithashtu subjekti sqaron se në vitin 2016, pasi i është kërkuar nga ana e ILDKPKI-së të specifikojë termin “kursim familjar”¹⁷, në procesverbalin e datës 10.2.2016 ka dhënë sqarime shumë të detajuara për burimet e pasurisë, të cilat përputhen me ato të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Nga verifikimi i këtij procesverbali subjekti ka specifikuar të ardhurat e secilit prej burimeve si vijojnë:

¹⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.6.2021, të ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

- kredi në “Raiffeisen Bank” në vlerën 2.500.000 lekë;
- kursime në vlerën 1.400.000 lekë nga paga e tij dhe e bashkëshortes, duke sqaruar se ai ka qenë në marrëdhënie pune që nga data 1.2.2000, ndërsa bashkëshortja ka filluar punë në datën 1.3.2009;
- ndihmë nga prindërit e bashkëshortes në shumën 1.500.000 lekë, të cilët kanë aktivitet privat prej vitit 1996 si bar-restorant dhe nga viti 1999-2000 si bar-restorant-hotel në Sarandë, ku një pjesë prej 7.000 euro vjehri apo vjehrra e ka kaluar në llogari bankare të djalit të tij B. Ll.;
- ndihmesë nga vëllai A. Ll. në shumën prej 7.000 euro, të cilat i derdhur direkt në llogarinë e shoqërisë ndërtuese, duke paraqitur edhe mandatin e BKT-së datë 8.8.2011;
- një shumë prej 600.000 lekësh dhënë nga nëna e tij, e cila ka shitur së bashku me tre motrat e saj një pasuri prej 4860 m² e ndodhur në fshatin H., Sh., në vitin 2005, duke paraqitur certifikatën e pronësisë.

Analizë specifike e secilit prej burimeve të deklaruara

29. Sa i takon burimit “kursime familjare”

29.1. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se në termin “kursimet familjare” ka përfshirë: (i) shumën 10.000 euro të paguar prej tij në datën 16.7.2010 sipas mandatpagesës me datë 16.7.2010 në “Alpha Bank”, Durrës; si dhe (ii) kontributin e nënës së tij në shumën 600.000 lekë, të cilat kanë shërbyer për të paguar prej saj këstin në vlerën 10.000 euro në datën 29.4.2011 sipas dokumentit për nxjerrje llogarie të “ProCredit Bank” (pjesa e mbetur prej 5.500 euro, ka qenë e dhuruar nga prindërit e bashkëshortes, trajtuar si burim më vete në vijim në paragrafin 32/3 pika ii e këtij vendimi).

29.2. Sa i takon shumës 10.000 euro të paguar në datën 16.7.2010, subjekti ka sqaruar se¹⁸ e ka burimin te depozita në emër të nënës së tij E. Ll. pranë “ProCredit Bank”, çelur prej saj në datën 20.11.2009 në vlerën 10.000 euro, e cila ka qenë krijuar nga kursimet e tij me bashkëshorten, por, duke mos pasur llogari në euro, i kanë depozituar në llogarinë e nënës së tij. Kjo depozitë është tërhequr prej nënës së tij në datën 15.7.2010, me qëllim kryerjen prej tij të pagesës së këstit në datën 16.7.2010. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së nënës së subjektit në PCB, përputhen deklaratimet e subjektit me të dhënat bankare.

29.3. Për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit për të krijuar këtë shumë, Komisioni ka kryer analizën financiare deri në datën 20.11.2009 kur është çelur llogaria në emër të nënës. Për efekt të kësaj analize, gjatë hetimit administrativ u pyet subjekti nëpërmjet dy pyetësorëve për periudhat kur ai ka jetuar vetëm ose/dhe me anëtarë të tjerë të familjes, përbërjen faktike familjare të çdo periudhe, të ardhurat e tyre, si janë përballuar shpenzimet e jetesës apo udhëtimeve në rastet kur nuk ka punuar aty ku banonte, periudhat kur janë kryer shpenzimet e mobilimit, etj.

29.4. Në përfundim të hetimit administrativ, pasi Komisioni administroi deklaratimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe pyetësorit të datës 11.11.2022¹⁹, kreu analizën financiare sikurse është treguar në tabelën më poshtë, sipas së cilës duket se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të krijuar shumën 10.000 euro që ka shërbyer për pagesën e këstit në datën 16.7.2010, për shkak të një balance negative prej 288.562 lekësh.

¹⁸Shihni përgjigje të pyetjes 6/d të pyetësorit nr. 3.

¹⁹Shihni *email*-in dërguar subjektit të rivlerësimit datë 11.11.2022 dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit protokolluar datë 16.11.2022 me nr. *** prot. dhe dokumentet bashkëlidhur.

Përshkrimi	<i>1.1.2005 deri më 20.11.2009</i>
PASURI	5 370 813
Apartament me sip. 75 m ² , Durrës, me privatizim 1/3 pjesë	0
Apartament me sip. 105.26 m ² , Durrës, blerë me K. 29.3.2014 (para detyrës)	0
Garazh 23 m ² , Durrës blerë 17.4.2014 - 50%	0
Automjet tip "Volkswagen Passat", V. 2001 – *** datë 4.6.2013	0
Blerë apartament nga nëna me sip. 126.9 m ² , L. ***, Rr. "****" – Durrës	4 000 000
Krijuar <i>cash</i> deri më 20.11.2009	0
	0
	0
<i>Ndryshimet e Likuiditeteve</i>	1 370 813
Gjendja e Likuiditeteve	
Detyrime	0
Kredi tek "Raiffesen Bank" më 6.5.2008	800 000
Shlyer kredia tek "Raiffeisen Bank"	-800 000
Kredi tek "Raiffeisen Bank" Konsumatore me Hipotekë datë K 16.12.2010 për 15 vjet	
Shlyer kredia tek "Raiffeisen Bank"	
Pasuri neto	5 370 813
Të ARDHURA dokumentuar	7 664 569
Të ardhura të subjektit si OPGJ nga 1.1.2005	3 530 883
nga shitja e tokës së nënës 2004	0
Nga shitja e apartamentit	3 700 000
Kursime të mbartura të subjektit	0
Të ardhura të bashkëshortes	0
Barrë lindje e bashkëshortes	0
Pensioni i nënës	433 685
Ndihmë nga prindërit e bashkëshortes	0
Ndihmë nga nëna	0
Ndihmë nga vëllai	0
Nga interesa bankare	0
SHPENZIME	2 582 318
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare	2 165 261
Shpenzime udhëtimi TIMS	268 460
Shpenzime Kredie tek "Raiffeisen Bank"	0

Paguar interesa kredie	148 597
Shpenzime transporti të brendshëm	0
Shpenzime qiraje (sipas P. 4)	0
Shpenzime arredimi sipas P. 2, Pyetja 2 c/1	0
Shpenzuar kredia	0
Mundësia për Kursime	-288 562

Kjo analizë është kryer bazuar në metodologjinë kumulative dhe fillon nga data 1.1.2005. Kjo sepse për vitet 2003 dhe 2004 subjekti ka kryer deklaratat e pasurisë si OPGJ dhe për të dy vitet nuk ka deklaruar kursime *cash*. Prandaj, mundësia për kursime, deri në fund të vitit 2004, është konsideruar 0 (zero). Për këtë periudhë, subjekti ka banuar në apartamentin e nënës së tij në Durrës duke bashkëjetuar me të dhe pjesëtarë të tjerë të familjes. Në këtë analizë janë përfshirë:

- të gjitha të ardhurat e dokumentuara të subjektit nga paga e tij, si dhe pensioni i nënës për periudhën e analizuar;
- të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë për të cilat është provuar pagesa e tatimit në burim/regjistrimi i pasurisë në emër të blerësit/blerësve;
- pasuritë e krijuara gjatë periudhës duke përfshirë këtu likuiditetin e krijuar nga subjekti, por të depozituar nga nëna E. Ll. në PCB Bank në datën 20.11.2009;
- shpenzimet e jetesës sipas standartit të ILDKPKI dhe përbërjes familjare të subjektit sipas deklarimeve të pyetësorit nr 3²⁰.
- është përfshirë si e ardhur një kredi konsumatore në shumën 800.000 lekë marrë pranë “Raiffeisen Bank” në maj 2008 dhe shlyer tërësisht në qershor 2009 dhe pasi u pyet për qëllimin dhe përdorimin e kësaj kredie, subjekti ka sqaruar se²¹ marrja e kredisë ka qenë për prenotimin e një apartamenti, veprim i cili nuk u konkludua, dhe kështu kredia e pashpenzuar u kthye përsëri në bankë në qershor 2009. Për këtë arsye, efekti financiar nga kjo kredi është zero.

29.5. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka kundërshtuar balancën negative dhe ka shpjeguar se të ardhurat e bashkëshortes për periudhën 1.1.2005 – 20.11.2009 janë pasqyruar gabimisht në vlerën “0” lekë në analizën e Komisionit, pasi, realisht të ardhurat nga paga e bashkëshortes për periudhën mars - tetor 2009, sipas të dhënave bankare rezultojnë në vlerën 297.864 lekë. Gjithashtu, sipas subjektit, punësimi për këtë periudhë provohet edhe me vërtetimin e Këshillit të Qarkut Durrës²² të depozituar nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Subjekti pretendon përfshirjen e këtyre të ardhurave në analizën financiare për periudhën 1.1.2005 – 20.11.2009, duke e konsideruar dukshëm një gabim material, pasi vetë Komisioni i ka përfshirë këto të ardhura për vitin 2009. Subjekti i ka bashkëlidhur prapësimeve nxjerrjen e llogarisë në “ProCredit Bank”, me të cilën provohen të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja për periudhën mars-tetor 2009 në shumën 297.864 lekë. Gjatë vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vëren se pretendimet e subjektit janë të bazuara dhe të provuara me dokumentacion shkresor ligjor. Pas përfshirjes së kësaj shume, analiza financiare e

²⁰ Ne përgjigje të pyetësorit numer tre, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara për anëtarët e familjes në të gjitha vitet, pasqyruar në mënyrë të hollësishme në rezultatet e hetimit administrativ.

²¹Shihni përgjigjen nr. 7 të pyetësorit nr. 3.

²²Vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016.

rishikuar për krijimin e shumës 10.000 euro, e cila ka shërbyer për pagesën e këstit të apartamentit në datën 6.7.2010, rezultoi me balancë pozitive.

29.6. Sa i takon të ardhurave të nënës që kanë shërbyer për krijimin e shumës 600.000 lekë, të cilat kanë shërbyer për të paguar këstin prej 10.000 euro, në datën 29.4.2011, subjekti deklaroi të ardhura nga: (i) shitja e pasurisë tokë arë (400.000 lekë) në fshatin Hardhisht, Shijak, për të cilën subjekti paraqiti disa dokumente shkresore, nga verifikimi i të cilave, vetëm shuma 200.000 lekë përfituar nga shitja e tokës me sip. 4.680 m² me kontratë të datës 17.10.2004, është konsideruar si e ardhur e ligjshme, pasi pasuria është regjistruar në emër të palës blerëse²³; (ii) pensioni i nënës ndër vite, për të cilat paraqiti vërtetimin nr. *** prot. dhe vërtetimin nr. ***, datë 9.6.2022, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Durrës, sipas të cilave shtetasja E. Ll. ka përfituar pension që nga data 1.1.2004 në vlerën 621.168 lekë, si dhe ka përfituar pensionin familjar nga bashkëshorti i vdekur për periudhën 1.1.2003 - 31.12.2003, në shumën totale 43.090 lekë.

Për të verifikuar mundësinë financiare të nënës së subjektit për të krijuar shumën 600.000 lekë të depozituar prej saj në PCB Bank, në datën 29.4.2011, Komisioni ka kryer analizën financiare deri në fund të vitit 2010, duke përdorur metodologjinë kumulative, sipas së cilës, nëna e subjektit ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të krijuar këtë shumë.

Përshkrimi	<i>2000 deri në fund 2010</i>
Pasuri	8 534 660
Apartament me sip. 75 m ² , Durrës, me privatizim 1/3 pjesë	230 541
Apartament me sip. 105.26 m ² , Durrës, blerë me K. 29.3.2014 (para detyrës)	4 164 300
Blerë apartament nga nëna 126.9 m ² , L. ***, Rr. "M. M." – Durrës	4 000 000
<i>Ndryshimet e Likuditeteve</i>	<i>139 819</i>
Detyrime	2 500 000
Kredi tek "Raiffeisen Bank" më 6.5.2008	800 000
Shlyer kredia tek "Raiffeisen Bank"	-800 000
Kredi tek "Raiffeisen Bank" Konsumatore me Hipotekë datë K. 16.12.2010 për 15 vjet	2 500 000
Pasuri Neto	6 034 660
Të Ardhura dokumentuar	11 800 847
Të ardhura të subjektit si OPGJ nga 1.2.2000	4 904 838
Nga shitja e tokës së nënës 2004	200 000
Nga shitja e apartamentit	3 700 000
Kursime të krijuara nga subjekti 2000 – 2003	1 224 090
Të ardhura të bashkëshortes	803 726
Pensionin e nënës	621 168
Ndihmë nga prindërit e bashkëshortes	347 025
Shpenzime	4 391 074

²³Me deklaratë notoriale nr. ***, datë 12.7.2020, shtetasit H. V., N. Ll., R. D. deklarojnë pëlqimin e tyre për përfitimin e shumës 400.000 lekë nga nëna e subjektit (nga e cila u vërtetua të jetë përfituar me kontratë shitjeje vetëm shuma 200.000 lekë), pasi ajo është kujdesur për prindërit deri në vdekjen e tyre, si dhe ka qenë amaneti i prindërve për ta ndihmuar.

Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare	3 060 566
Shpenzime udhëtimi TIMS	374 912
Shpenzime Kredie tek “Raiffeisen Bank”	7 000
Paguar interesa kredie	148 597
Shpenzuar kredia	800 000
Mundësia për Kursime	1 375 113

30. Sa i takon burimit “kredi bankare”

30.1. “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar se z. Kledian Llaho ka marrë një kredi në shumën 2.500.000 lekë, në datën 20.12.2010, të cilën e ka mbyllur në datën 27.4.2015²⁴, si dhe, ka vënë në dispozicion kontratën e kredisë bankare dhe hipotekës nr. ***, datë 16.12.2010, me kredihënës “Raiffeisen Bank” sh.a., kredimarrës Kledian Llaho dhe L. Ll., hipotekuese E. Ll., me objekt “kredi konsumatore me hipotekë në shumën 2.500.000 lekë, me afat 180 muaj”. Në këtë kontratë parashikohet vendosja e hipotekës mbi pasurinë e llojit “apartament” me nr. ***, z.k. ***, me sip. 126.9 m², ndodhur në Durrës. Në lidhje me këtë pasuri, ASHK-ja²⁵ Durrës ka konfirmuar se figuron në pronësi të znj. E. Ll. (nëna e subjektit), e cila e ka blerë sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 27.7.2007, pra 7 vjet para fillimit të detyrës së tij si prokuror, në shumën 4.000.000 lekë.

30.2. Sipas ekstraktit të llogarisë nr. ***, vërehen veprimet: i) me datë 20.12.2010 ka disbursim kredie në shumën 2.500.000 lekë; ii) me datë 22.12.2010 ka tërheqje të shumës 2,427,000 lekë; (iii) kjo shumë është konvertuar në 17.500 euro; (iv) pasi është shtuar shuma 2500 euro nga subjekti²⁶, 20.000 euro janë depozituar cash po në datën 22.12.2010²⁷ në llogarine e “****” shpk, me përshkrimin *derdhje nga Kledian Llaho likuidim pjesor blerje apartamenti*.

30.3. Në DPDFD/2014, subjekti ka deklaruar saktësisht kredinë dhe qëllimin për blerjen e apartamentit objekt verifikimi. Gjithashtu, në këtë deklaratë e ato në vijim deri në DPV për vitin 2015 kur është mbyllur kredia, subjekti ka kryer deklarime të sakta e në përputhje me të dhënat bankare në lidhje me këtë kredi dhe detyrimet financiare të lindura prej saj.

31. Sa i takon burimit “ndihmesë e vëllait nga punësimi në Itali”

31.1. Me qëllim justifikimin me të ardhura të ligjshme të shumës 7.000 euro paguar nga vëllai A. Ll., në datën 8.8.2011, si ndihmesë për apartamentin e subjektit, por edhe justifikimin me të ardhura të ligjshme të pagesës së çmimit për blerjen e pasurisë nga

²⁴Shihni aneksin nr. 4/ në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 16.2.2021, të “Raiffeisen Bank” dhe dokumentet bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

²⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.8.2021, ASHK-Durrës, në dosjen e Komisionit dhe dokumentet bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 16.2.2021, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit dhe aneksin nr. 4/4 certifikatë pronësie, lëshuar më 5.9.2007, nga ZVRPP-ja Durrës, sipas së cilës pasuria nr. ***, z.k. *** e llojit “apartament” me sip. 126.9 m², ndodhur në Durrës figuron në pronësi të znj.E. H. Ll., kartelë dhe hartë treguese në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁶ Me burim ndihmese nga prinderit e bashkeshortes (trajtuar ne paragrafin 32.3, pika ii)

²⁷ Nje pjese e kesaj shume eshte perfituar me kredi bankare per te cilen ne pyetesorin nr.3 subjekti ka paraqitur dokumentin banka “veprim në arkë” datë 22.12.2010 të RFZ Bank, me përshkrim Kledian Llaho tërheqje nga llogaria cash 2.427.000 lekë, kredi e mare sipas kontrates nr. *** rep., *** kol., datë 16.12.2010 (trajtuar ne vijim).

z. A. Ll. prej 50.000 euro, gjatë hetimit administrativ iu kërkua subjektit informacion nëpërmjet disa pyetësorëve në lidhje me periudhën e largimit të vëllait në Itali, vendin ku ka qëndruar, përbërjen e tij familjare, punësimin dhe të ardhurat e ligjshme të tij, shpenzime jetese (dhe jo vetëm) etj. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2, pyetësorit nr. 3 dhe pyetësorit të dërguar me *email* të datës 11.11.2022²⁸, në mënyrë të përmbledhur subjekti ka deklaruar se vëllai A. Ll. ka emigruar në Itali gjatë viteve 2002-2003 dhe vetëm gjatë fundit të vitit 2003 ka mundur të pajiset me kontratë të rregullt pune duke qenë në vijim i punësuar rregullisht. Subjekti ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me vendet ku ka jetuar e punuar vëllai, përbërjen familjare të tij para dhe pas martesës me bashkëshorten L., të ardhurat që burojnë nga puna e vëllait A. dhe e bashkëshortes, duke paraqitur dokumente shkresore për vendet ku kanë punuar dhe periudhat, si dhe të ardhurat e siguruara nga puna, duke vërtetuar që vëllai i tij A. Ll. ka pasur të ardhura të ligjshme që burojnë nga pagat në Itali që nga data 1.1.2004 e në vijim. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se shumata e depozituara nga nëna e tij E. Ll. pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, janë të siguruara nga vëllai në Itali, të cilat i sillte *cash*, kryesisht gjatë verës kur vinte me pushime, por jo vetëm, dhe ia dorëzonte nënës së tyre, e cila i depozitonte në bankë duke kryer disa pagesa në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k. Subjekti ka deklaruar se vëllai i tij ka ardhur në Shqipëri rregullisht dy herë në vit, ndërkohë që në maj 2010 ka ardhur enkas nga Italia për të sjellë kursimet e tij *cash*. Nga verifikimi i sistemit TIMS ka rezultuar se deklaratimet e subjektit janë të sakta. Më tej, subjekti ka dhënë sqarime të detajuara për lëvizjet në llogarinë bankare të nënës së tij pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, të cilat përputhen me të dhënat bankare²⁹. Sipas subjektit, pagesat për blerjen e apartamentit të vëllait janë kryer nga nëna e tyre, por, gjithmonë në emër të vëllait dhe sipas porosive përkatëse të tij, edhe pse ai nuk ka qenë prezent në Shqipëri. Në mbështetje të të gjitha deklaratimeve si më sipër, subjekti ka vënë në dispozicion një numër të konsiderueshëm dokumentesh shkresore³⁰.

31.2. Pavarësisht hetimit të thelluar të kryer në lidhje me mundësinë e z. A. Ll. për të blerë apartamentin e tij me vlerë 50.000 euro, si dhe për t’i dhënë subjektit 7.000 euro paguar në datën 8.8.2011, Komisioni iu referua faktit se z. A. Ll. deri në datën 2.3.2011 ka paguar dy këste për apartamentin e tij në shumën 49.000 euro (1.000 euro paguar në vitin 2013 me lidhjen e kontratës së shitjes), ndërsa shuma 7.000 euro i është dhënë subjektit pas kësaj date, në datën 8.8.2011. Në këto kushte është verifikuar mundësia e tij për t’i dhënë subjektit këtë shumë, duke kryer analizën financiare nga data 2.3.2011 deri më 8.8.2011, si në tabelën më poshtë.

Përshkrimi	2 mars deri më 8 gusht 2011
TË ARDHURA dokumentuar	11 411
Të ardhura nga vëllai në Itali euro (për 6 muaj)	11 411
SHPENZIME	13 079

²⁸Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit protokolluar me nr. *** prot., në datën 16.11.2022.

²⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, të “Intesa Sanpaolo Bank” dhe shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2021, të BKT-së në dosjen e Komisionit.

³⁰Shihni: Autorizim punësimi për shtetasin A. Ll. në datën 12.11.2003; kontratë pune datë 30.1.2004 e shtetasit A. Ll.; kontratë pune datë 4.12.2021 e znj. L. Ll.; leje qëndrimi të shtetasit A. Ll. datë 28.9.2019; kartë identiteti A. Ll.; kartë sigurimi; certifikatë familjare datë 10.6.2022 të shtetasit A. Ll.; vërtetim datë 6.12.2016 e noterit A. C.; njoftim mbi të ardhurat e shtetasit A. Ll., lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane, për periudhën 1.4.2004 – 31.3.2022; deklaratë noteriale e shtetasit A. Ll. datë 11.6.2022, i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

Shpenzime jetese për 4 persona	6 079
Dhënë subjektit për pagesë kësti apartamenti dt. 8.8.2011	7 000
Mundësia për Kursime	-1 668

Duke qenë se balanca negative prej 1.668 euro nuk është një vlerë e konsiderueshme dhe në konsideratë të faktit kjo analizë e vëllait të subjektit, i cili nuk ka qenë subjekt deklarues, është një analizë me rezervë bazuar vetëm në të dhënat që Komisioni dispononte, në respektim të parimit të proporcionalitetit, shuma 7.000 euro e dhënë nga vëllai i tij, është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën përfundimtare të subjektit, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të subjektit të rivlerësimit. Veç kësaj, pas verifikimeve, nuk rezultuan të dhëna për përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar të vëllait të subjektit, shtetasit A. Ll.³¹.

32. Në lidhje me burimin ndihmesë e prindërve të bashkëshortes, gjatë hetimit administrativ u kryen verifikimet si vijojnë:

32.1. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në shkurt të vitit 2016 dhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar ndihmën në shumën 1.500.000 lekë nga prindërit e bashkëshortes. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar që një shumë prej 7.000 euro, vjehrrit e tij e kanë kaluar në llogari bankare të djalit të tij B. Ll. Ky fakt vërtetohet me të dhënat bankare, sipas të cilave në llogari të B. K. Ll., pranë “ProCredit Bank”, në datën 8.4.2013 ka kaluar nga L. Gj., vjehrra e subjektit, shuma 7.000 euro dhe në datën 11.4.2013 vërehet veprimi “tërheq Kledian Llaho, shuma 7.000 euro”.

32.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara duke qartësuar se depozitimi në shumën 7.000 euro nga vjehrra në llogari të djalit, nuk ka qenë në funksion të pagesës për blerje të apartamentit, por ka qenë ndihmesë për arredimin e shtëpisë. Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti i referohet edhe periudhës kohore kur apartamenti kishte përfunduar rreth muajit prill 2013, ndërkohë që pagesat kishin përfunduar përpara këtij viti. Gjithashtu i referohet edhe deklaratës për kontrollin e figurës, ku ka deklaruar se në atë apartament ka filluar të banojë nga muaji maj 2013. Në këto kushte, shuma prej 7.000 euro nuk është konsideruar për pagesë kësti për blerjen e apartamentit në vitin 2014, por për arredimin e tij, dhe si e tillë është përfshirë si shpenzim për vitin 2013. Analiza e burimeve të ligjshme të shtetasve V. e L. Gj. për krijimin e shumës 7.000 euro, është kryer në vijim në paragrafin 33 të këtij vendimi.

32.3. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se vlera e kontributit të prindërve të bashkëshortes në shumën prej 11.000 euro ose 1.500.000 lekë, është dhënë prej tyre në vitin 2010 dhe është ndarë në katër pjesë për plotësimin pagesës së kësteve të apartamentit, duke u përdorur si më poshtë:

- i) vlera 2.500 euro është përdorur më 22.12.2010 për plotësimin e këstit prej 20.000 euro, paguar në këtë datë, për shkak se vlera e kredisë prej 2.427.000 lekësh konvertohej në 17.500 euro dhe ishte e pamjaftueshme;
- ii) vlera 5.500 euro është përdorur në datën 29.4.2011 së bashku me vlerën 600.000 lekë/4.500 euro të kontributit të nënës së tij, duke formuar kështu shumën prej 10.000 euro, shlyer sipas mandatpagesës së kësaj date;
- iii) shuma prej 2.000 euro është përdorur në datën 4.1.2012, kur është kryer pagesa në BKT, sipas mandatpagesës së kësaj date;
- iv) nuk ka deklarime për periudhën e dhënies së shumës 1.000 euro.

³¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

Bazuar në deklaratimet e subjektit, pagesat për blerjen e apartamentit me burim shumën e dhuruar nga prindërit e bashkëshortes prej 11.000 euro/1.500.000 lekësh janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, sipas kohës së pagesës së tyre nga ana e subjektit.

<i>Koha</i>	<i>22.12.2010</i>	<i>29.4.2011</i>	<i>4.1.2012</i>	<i>Deri më 29.3.2014</i>	<i>Totali</i>
<i>Shuma</i>	2.500	5.500	2.000	1.000	11.000

32.4. Sa i takon burimit të krijimit të vlerës 11.000 euro/1.500.000 lekë, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi të ardhurat nga shitja e apartamentit të prindërve të bashkëshortes në vitin 1997, sipas kontratës nr. ***, datë 11.1.1997, në vlerën 1.600.000 lekë. Sipas subjektit, pas përfitimit të kësaj shume vjeherri i subjektit ka dhënë atë hua tek miku i tij I. S. shumën 1.500.000 lekë pa ndonjë dokument shkresor dhe ky i fundit ia ka kthyer huan në nëntor të vitit 2010. Në vijim, kjo shumë i është dhënë bashkëshortes së subjektit dhe është përdorur për të paguar pjesërisht këstet për blerjen e apartamentit si më sipër. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur aktet e poshtëshënuara shkresore:

- Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 11.1.1997, sipas së cilës shtetasit V. Gj. dhe L. Gj. i shesin një apartament në Sarandë shtetasve V. Ç., në vlerën 1.600.000 lekë. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 11.5.2022, të ASHK Sarandë, nuk rezulton që kjo pasuri të jetë në emër të shtetasve L. dhe V. Gj., fakt që tregon se kontrata e shitjes datë 11.1.1997 është regjistruar në ZVRPP në emër të blerësve/blerësit, duke u paguar detyrimet tatimore përkatëse. Për rrjedhojë shuma prej 1.600.000 lekësh, e përfituar nga shitja e këtij apartamenti është konsideruar e ligjshme.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.8.2022, me deklarues V. Gj. dhe I. S., të cilët deklarojnë se shtetasi V. Gj., vjeherri i subjektit, i ka dhënë shumën 1.500.000 lekë hua mikut tij I. S. në dorë, shumë e cila është kthyer prej këtij të fundit tërësisht në nëntor 2010.

- Gjithashtu në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti paraqiti edhe një kontratë kredie bankare të marrë nga prindërit e bashkëshortes³². Më tej, me kërkesë të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti paraqiti dosjen e kredive³³, nga ku rezultoi se kreditë e marra në vitet 2004 dhe 2010 janë përdorur nga vjeherri i subjektit për investime të zgjerimit të hotel “***” në Sarandë dhe jo për t’ia dhënë bashkëshortes së subjektit me qëllim kryerjen e ndonjë pagese për blerjen e apartamentit objekt verifikimi.

32.5. Në përfundim të hetimit administrativ, në kushtet kur prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk kanë qenë subjekte deklarues, e për rrjedhojë nuk kanë pasur detyrimin e dokumentimit apo deklarimit të huas së dhënë e të marrë prej shtetasit I. S., si dhe në kushtet kur shuma prej 11.000 euro/1.500.000 lekësh dhënë nga babai i bashkëshortes së subjektit është përdorur nga subjekti për blerjen e apartamentit me sip. 104 m² përpara fillimit të detyrës, Komisioni i është referuar deklarimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ dhe akteve shkresore të paraqitura prej tij, të cilat përputhen edhe

³²Shihni dokumentin e datës 26.4.2010 “amendament i kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 18.5.2004” me kredimarrës V. Gj. në “Intesa Sanpaolo Bank”.

³³Shihni aktet si: kontratë kredie bankare datë 18.5.2004 mes shtetasve V. dhe L. Gj. dhe American Bank Of Albania në shumën 50.000 USD, me qëllim përdorimin për përfundimin e punimeve të brendshme të objektit bar-restorant-hotel; amendament i kontratës së kredisë bankare; *statement* bankar i llogarisë nr. *** në euro, në emër të shtetasve V. dhe L. Gj., etj.

me periudhat e likuidimit të çmimit ë blerjes së pasurisë. Sipas deklarimeve dhe akteve shkresore të paraqitura si prova, u vërtetua se: (i) shuma prej 1.600.000 lekësh është përfituar me kontratë shitjeje të datës 11.1.1997 nga shtetasit V. Gj. dhe L. Gj.; (ii) kjo shumë i është dhënë hua shtetasit Ismail Sinani dhe është kthyer prej këtij të fundit në nëntor 2010, kur i është dhënë subjektit dhe bashkëshortes së tij për t'u përdorur për kryerjen e katër pagesave përshkruar në paragrafin 32.3 më sipër. Për rrjedhojë, shuma prej 11.000 euro/1.500.000 lekësh, dhënë prej prindërve të bashkëshortes, në përfundim të hetimit administrativ është konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

Në lidhje me të ardhurat e prindërve të bashkëshortes për t'i kaluar djalit të subjektit shumën 7.000 euro në datën 8.4.2013, u konstatua se:

33. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: *“Për sa i përket burimit të transfertës prej 7.000 euro nga vjehrra ime në llogarinë e djalit në muajin prill 2013, sqaroj se kanë qenë të ardhurat e përfituara nga vjehrra si rezultat i dhënies në përdorim të vendparkimeve poshtë objektit të tij kryesisht gjatë stinëve vjeshtë - dimër (tetor - mars) në vitet 2010 – 2013. Vendparkimet i janë lënë në përdorim shtetasit V.K., sipërmarrës në fushën e ndërtimit sipas marrëveshjes midis tyre në muajin shtator 2010 me qëllim parkimin e disa mjeteve të tij, kundrejt një shpërblimi prej 3.500 (tre mijë e pesëqind) euro në vit. Bashkëlidhur ju vihet në dispozicion aktmarrëveshja datë 29 shtator 2010, midis vjehrit V. Gj. dhe administratorit të shoqërisë ‘****’ sh.p.k., V. K. Pavarësisht deklarimeve dhe aktmarrëveshjes së datës 29.9.2010, nuk u provua me dokumentacion: (i) përfitimi i shumave të vjela nga qiraja; dhe (ii) pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja, dhe për këtë arsye, në përfundim të hetimit administrativ, ky burim nuk është konsideruar si i ligjshëm.*

34. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe disa dokumente të tjera shkresore me qëllim vërtetimin e të ardhurave të tjera të prindërve të bashkëshortes. Bazuar në të gjitha të dhënat e administruara si nga ILDKPKI-ja³⁴ ashtu edhe nga Komisioni³⁵, në përfundim të hetimit administrativ është kryer analiza financiare përmbledhur në tabelën më poshtë, sipas të cilës prindërit e bashkëshortes nuk kanë justifikuar tërësisht me të ardhura të ligjshme shumën 7.000 euro kaluar në llogarinë e djalit të subjektit në PCB Bank datë 8.4.2013, për shkak të një balance negative prej 573.421 lekësh. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të subjektit për vitin 2013 (periudha përpara fillimit të detyrës).

Përshkrimi	2008 deri më 8.4.2013
Të ardhura dokumentuar	3 237 732
Vjehrra nga biznesi	2 996 264
Vjehrra nga paga nga 1.2012	241 468
Shpenzime	3 811 153
Shpenzime jetese për 2 persona	1 442 568
Dhuruar vajzës/bashkëshortja e subjektit	1 387 115
Dhuruar nipit në llogarinë bankare tek PCB Bank	981 470
Mundësia për Kursime	-573 421

³⁴Shihni anekset nr. 34, nr. 35 dhe nr. 36 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵Shihni dokumentet e paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

35. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, në ushtrim të barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, kundërshtoi këtë konstatim duke iu referuar aktmarrëveshjes së vitit 2010, që sipas tij vërteton marrëdhënien e qirasë midis vjehrrit dhe subjektit “****” sh.p.k., si dhe një deklaratë noteriale me datë 13.12.2022, ku pranohet nga palët se pagesat e qirasë janë paguar *cash* për çdo 6-mujor. Gjithashtu, subjekti i referohet edhe qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në lidhje me të ardhurat nga qiratë, në rastet kur pala qiramarrëse ka qenë subjekt tregtar dhe ka pasur detyrim për pagimin e tatimit mbi qiratë. Në mënyrë të përmbledhur qëndrimi i subjektit konsiston në argumentet se: (i) të ardhurat nga qiraja që kanë shërbyer si burim për dhënien e shumës 7.000 euro nga vjehrrit i përkasin periudhës para se ai të emërohej në detyrë kur as ai dhe as vjehrrit nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe, për këtë arsye, nuk ka pasur një kujdes të shtuar prej tij lidhur me formalizimin e tyre; (ii) marrëdhënia juridike e qirasë është krijuar midis një subjekti tregtar dhe një individi, nga ku detyrimi për pagesën e tatimit të qirasë i përket subjektit tregtar; (iii) marrëdhënia e vitit 2013 me prindërit e bashkëshortes për dhënien e shumës 7.000 euro është lehtësisht e provueshme pasi është materializuar me transfertë bankare; (iv) minimalisht Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare mundësinë për kursime nga prindërit e bashkëshortes në shumën 408.049 lekë.

36. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, në analizë të deklarimeve e dokumenteve të paraqitura në parashtrime, Komisioni çmoi se pavarësisht se në kuptim të pikës 3, neni D e të Aneksit të Kushtetutës subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të shumës 7.000 euro, ai ndodhet në kushte lehtësuese për shkak se të ardhurat e vjehrrit/vjehrrës, të cilat kanë shërbyer si burim për këtë shumë, së pari kanë kaluar në rugë bankare në llogari të djalit të tij në vitin 2013, dhe së dyti, nuk janë krijuar dhe as nuk lidhen me periudhën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit. Megjithatë, edhe në rastin kur kjo shumë nuk konsiderohet e ligjshme, në analizën financiare të vitit 2013, bilanci i këtij viti në analizën e rishikuar financiare është në vlerën + 616,863 lekë.

Analizë financiare për justifikimin me të ardhura të ligjshme të shumës 50.000 euro

37. Në tabelën më poshtë janë përmbledhur në mënyrë të shkurtuar burimet e krijimit të vlerës 50.000 euro për blerjen e pasurisë objekt verifikimi me kontratën e shitjes së datës 29.3.2014, duke specifikuar vlerën e secilit prej burimeve, vlerat e investuara dhe datat përkatëse, si dhe vlerat e konsideruara nga Komisioni me të ardhura të ligjshme.

Burimet e krijimit	Vlera sipas burimeve të deklaruara nga subjekti në Vetting	Vlera e investimit total	Datat e pagesës së secilës shumë/datat e dhurimeve	Vlera e konsideruar nga Komisioni
Kursime të subjektit dhe bashkëshortes	10 000 euro	50 000 euro	16.7.2010	10 000 euro
Kredi bankare në “Raiffeisen Bank”	2 500 000 lekë		22.12.2010	2 500 000 lekë
Ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes	11.000 euro		22.12.2010	11.000 euro
			29.4.2011	
		4.1.2012		
		29.3.2014		
Ndihmesë nga nëna e subjektit	600 000 lekë		29.4.2011	600 000 lekë

Ndihmesë nga vëllai i subjektit	7 000 euro	8.8.2011	7.000 euro
Totali	50 000 euro		50. 000 euro

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizë financiare për periudhën përpara fillimit të detyrës nga subjekti, periudhë në të cilën është paguar dhe blerë pasuria objekt verifikimi apartament me sip. 105 m², nga e cila rezultoi një balancë negative prej -1.390.354 lekësh sipas tabelës që subjektit i është vënë në dispozicion me rezultatet e hetimit administrativ. Në këto kushte, duket se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të justifikuar kështu për blerjen e pasurisë. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 83/2016, në ushtrim të së cilës ai ka paraqitur argumentet dhe dokumente shkresore (trajtuar hollësisht në paragrafët 48-52 të këtij vendimi).

38. *Interes vjetor bankar si rezultat i depozitës së lartpërmendur. Vlera: Afërsisht 150.000 lekë. Pjesa: 100 %. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Nga të dhënat bankare rezultoi se deklaratimet e subjektit janë të sakta.*

39. *Automjet tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2002, i targuar ***, shitur më 19.1.2017, tek noter T. K., Sarandë. Vlera: 400,000 lekë. Pjesa: 100%. Subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore³⁶.*

39.1. Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këtë automjet rezultoi se:

- DPSHTRR-ja³⁷ ka konfirmuar se shtetasi Kledian I. Llaho ka pasur të regjistruar në emër të tij automjetin me targa ***, të cilin e ka shitur më 19.1.2017³⁸. Nga dokumentet e dosjes së automjetit, rezulton se: (i) sipas deklaratës së shtetasit V. F. C. automjeti ishte blerë nga shtetasi E. A., në shumën 600 euro dhe është zhdoganuar sipas deklaratës doganore të datës 15.1.2015, në vlerën 54.341 lekë; (ii) sipas kontratës së shitblerjes automjeti nr. ***, datë 25.1.2015, z. Kledian Llaho i ka blerë automjetin shtetasit E. A., në çmimin 300.000 lekë.

- Automjeti është regjistruar në emër të subjektit, i cili e ka deklaruar në DPV/2015, por në vlerën 400.000 lekë dhe pa deklaruar burimin e krijimit.

- Siç vërehet, ka një mospërputhje në deklarinimin e vlerës së automjetit në DPV/2015 krahasimisht me vlerën e kontratës. Me kërkesë të Komisionit, në parashtrimet e tij subjekti sqaroi se: *“Pasaktësia në pasqyrimin e çmimit të blerjes së automjetit ka qenë një pakujdesi në momentin e plotësimit të deklaratës dhe kjo ka ndodhur sepse, ashtu sikurse e ka pasqyruar edhe në DPV, nuk posedonte fizikisht kontratën e blerjes në atë kohë. Sipas tij, nuk kishte asnjë arsye që të pasqyronte një shifër të ndryshme të çmimit kur dihet se kontrata noteriale është një dokument krejtësisht i verifikueshëm. Gjithashtu, duhet mbajtur në konsideratë edhe fakti se, ashtu sikurse është konstatuar nga Komisioni, subjekti në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting nuk e kam disponuar këtë mjet, për rrjedhojë, nuk kishte detyrim për ta deklaruar, por e ka deklaruar për të treguar transparencën ndaj procesit”.*

³⁶Shihni aneksin nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁷Shihni aneksin nr. 32 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2021, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

³⁸Sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 19.1.2017, Kledian Llaho i shet shtetasit L. Sh. T. mjetin me targa *** në shumën 400.000 lekë.

Në analizë të prapësimeve të subjektit dhe akteve shkresore të administruara, Komisioni çmoi se pasaktësia në deklarimin e vlerës së automjetit në DPV/2015 prej 400.000 lekësh, është e paqëllimshme dhe pa pasoja. Në përfundim të hetimit administrativ, nuk rezultuan problematika në lidhje me origjinën dhe fitimin e pronësisë së automjetit me targa ***, të cilin nuk e ka pasur në pronësi në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* në datën 25.1.2017.

39.2. Në lidhje me burimin e krijimit, në DPV/2015 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet me targë ***, por bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, ka paraqitur disa dokumente³⁹, nga të cilat rezultoi se me kontratën nr. ***, datë 19.1.2015 është shitur automjeti me targë *** në vlerën 500.000 lekë. Pra, duket se të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti janë përdorur gjashtë ditë më vonë, në datën 25.1.2015, për blerjen e automjetit objekt verifikimi në çmimin 400.000 lekë (në analizën financiare si vlerë e automjetit u konsiderua aq sa është deklaruar në DPV/2015). Sa i takon automjetit me targë ***, rezultoi se ky automjet ishte blerë me kontratën nr. ***, datë 4.6.2013, në shumën 400.000 lekë, deklaruar në DPFID me burim kursime familjare. Nga analiza financiare e vitit 2013, ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij kanë pasur fonde për blerjen e tij. Në lidhje me shtetasin Klodian Kaso⁴⁰, pas verifikimeve të kryera, nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar.

39.3. Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë automjet me targë *** në DPV për vitin 2015 dhe në deklaratën *Vetting*, në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se: *“Automjeti është deklaruar në DPV në vitin 2015 pranë ILDKPKI-së dhe nga mënyra se si është pasqyruar deklarimi i kësaj pasurie, ka vlerësuar se nënkuptohet qartë edhe burimi i krijimit, pasi fillimisht në rreshtin e dytë të rubrikës ‘Përshkrimi i pasurive dhe burimi’ ka pasqyruar shitjen e automjetit me targa *** në datën 19.1.2015 në vlerën 500.000 lekë dhe një rresht më poshtë ka pasqyruar blerjen në datën 25.1.2015 të automjetit me targa *** në vlerën 400.000 lekë”*. Sipas subjektit, duket shumë qartë përputhja në kohë të afërt (brenda 6 ditëve) e të dy veprimeve juridike, që do të thotë se të ardhurat nga shitja e automjetit me targë ***, kanë shërbyer si burim për blerjen e automjetit me targa ***. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi bindëse argumentet e subjektit se si burim kanë shërbyer të ardhura të ligjshme nga shitja e automjetit gjashtë ditë më parë, me kontratën nr. ***, datë 19.1.2015, kontratë të cilën subjekti e ka bashkëlidhur me deklaratën *Vetting*. Në këto kushte pasaktësia në deklarimin e burimit, është pa ndonjë pasojë.

40. *Apartament me sip. 105 m², kati 7, përballë xhamisë së qytetit, në përdorim. Pronar shtetasi P. B. (shihni deklaratën noteriale datë 24.11.2017).* Në lidhje me këtë pasuri në përdorim ILDKPKI-ja, ka konstatuar: është e paqartë marrëdhënia juridike që ka subjekti me shtetasit P. B. dhe F. K., si dhe me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., të cilët i kanë dhënë në përdorim apartamentin me sip. 105 m² në Vlorë, pa qira.

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri në përdorim

40.1. Nga deklaratimet e subjektit rezultoi se:

³⁹Shihni aneksin nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2021, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

⁴⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë regjistrimi në gjendjen civile: “*Lagjja Nr. ***, Sarandë*”, ndërsa si adresë të vendqëndrimit ka deklaruar: “*Lagjja ‘***’, pranë xhamisë së qytetit, Vlorë*”.
- Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar si adresë regjistrimi në gjendjen civile: “*Lagjja Nr. ***, Sarandë*”, ndërsa si adresë të vendqëndrimit ka deklaruar: “*Lagjja ‘***’, Vlorë, pranë pallatit F.*”. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar si adresë: “*Pranë *** së qytetit, Vlorë*”.
- Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se adresa e deklaruar në DPV/2016 “*Lagjja ‘***’, Vlorë, pranë pallatit F.*”, është plotësuar jo saktësisht në mënyrë të paqëllimshme, dhe se, kjo evidentohet nga deklarimi i adresës së saktë nga bashkëshortja L. Ll. në DPV/2016, me përshkrimin “*pranë xhamisë së qytetit Vlorë*”⁴¹.
- Në DPV/2017/2018 subjekti ka deklaruar si adresë regjistrimi në gjendjen civile: “*Lagjja Nr. ***, Sarandë*”, ndërsa si adresë të vendqëndrimit ka deklaruar: “*Vlorë, rr. ‘***’, nd. ***, k. ***, ap. ****”, e cila i përket apartamentit të marë me qira në pronësi të D. D. deklaruar në përdorim (verifikuar gjatë procesit, trajtuar në vijim).

40.2 Nga aktet e administruara në ILDKPKI në lidhje me këtë apartament, rezultoi se⁴²:

- Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.1.2017, shtetasi P. B. përfaqësues me prokurë i shoqërisë “***” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit, me administrator F. K., deklaroi se është posedues i pasurisë apartament banimi me sip. 105 m², në katin e shtatë, të cilin e ka marrë në dorëzim të përfunduar, por ende nuk është certifikuar. Sipas deklaruesit, në këtë apartament banon z. Kledian Laho që nga muaji janar 2016, kundrejt detyrimit që të kryejë të gjitha pagesat për energjinë elektrike dhe të ujësjellësit.
- Sipas *email*-it të datës 25.11.2019, rezulton se me kërkesë të ILDKPKI-së, ASHK Vlorë ka informuar se apartamenti me sip. 105 m², kati i shtatë, përballë xhamisë Vlorë nuk rezulton në emër të subjektit.

40.3. Gjatë hetimit administrativ në lidhje me apartamentin në përdorim, u kryen verifikimet si vijojnë:

- Iu kërkua subjektit të sqarojë në lidhje me mënyrën e lejimit të përdorimit të apartamentit, marrëdhënien e tij me shtetasit P. B., F. K. dhe shoqërinë “***” sh.p.k., të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë aktuale, dokumente që vërtetojnë posedimin e apartamentit nga shtetasi P. B., etj.
- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se shoqëria “***” sh.p.k. është në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në pallat, ku investitorë dhe përfitues të apartamenteve në pjesën më të madhe janë shtetasit P. B. dhe djali i tij E. B., me të cilin është dakordësuar verbalisht për të përdorur apartamentin në katin e shtatë pa pagesë qiraje, por duke paguar detyrimet për energjinë elektrike dhe konsumin e ujit të pijshëm. Subjekti sqaroi se nuk është nënshkruar ndonjë kontratë huaje apo qiraje, përveç deklaratës datë 24.1.2017, lëshuar nga shtetasi P. B. Sa i takon marrëdhëniet me shtetasit P. B., E. B. dhe “***” sh.p.k. dhe administratorin e saj, subjekti ka deklaruar se:

⁴¹ Adresa “*Lagjja ‘***’, Vlorë, pranë pallatit F.*”, i përket banesës në pronësi të shtetasit D. D. (deklaruar si vendqëndrim në DPV për vitin 2017), e cila nga verifikimi në *Google Map* ndodhet në zonën e lagjes “***” Vlorë. Kjo adresë duket të jetë deklaruar gabimisht si adresë vendqëndrimi në DPV/2016, për shkak se deklarata e këtij viti është plotësuar në muajin mars 2017.

⁴²Shihni aneksin nr. 4/5 dhe aneksin nr. 31 në dosjen e ILDKPKI-së.

a. Me shtetasin P. B. ka qenë një marrëdhënie miqësie për shkak të shoqërisë me djaln e tij E. B. dhe ka shpjeguar se gjatë ushtrimit të detyrës është përpjekur të tregojë integritet, pasi shoqëria e tij ka qenë e zgjedhur me persona që gëzonin respekt në qytetin e Vlorës, si familja B. Me këta shtetas nuk ka pasur ndonjëherë situatë apo gjendje në konflikt interesi.

b. Me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe administratorin e saj F. K., nuk ka asnjë lidhje/marrëdhënie apo ndikim në këtë marrëdhënie huapërdorjeje. Sipas subjektit, shoqëria “****” sh.p.k. ka qenë në cilësinë e shoqërisë sipërmarrëse në ndërtimin e pallatit, ndërsa investitorë dhe përfitues të numrit më të madh të apartamenteve kanë qenë familjet e shtetasve P. dhe E. B.

c. Për shtetasin F. K., në dijeninë e tij, ky shtetas përbën një figurë kontroverze në qytetin e Vlorës si biznesmen në aktivitetin e ndërtimit dhe ka qenë person konfliktual e me probleme me sistemin e drejtësisë. Sipas tij, gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën si prokuror në Vlorë, emrin e këtij personi e ka hasur në trajtimin e disa procedimeve dhe materialeve kallëzuese, të cilat i janë shortuar në mënyrë rastësore. Me sa i kujtohet, ky shtetas ka paraqitur dy herë kërkesa për zëvendësimin e tij nga çështjet ku ai ka qenë i përfshirë dhe i dyshuar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” sipas nenit 186 të Kodit Penal, të cilat janë pranuar nga dy ish drejtues të Prokurorisë së Rrethit Vlorë.

Për të vërtetuar këto pretendime, si dhe për të dhënë shpjegime për sa i është kërkuar nga Komisioni, subjekti paraqiti aktet shkresore si vijojnë:

a. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.6.2022 lëshuar nga shtetasit P. B. dhe E. B., të cilët konfirmojnë deklaratimet e subjektit.

b. Kërkesë nr. *** , datë 7.6.2022, e z. Kledian Llaho drejtuar ASHK Vlorë, me anë të së cilës kërkon informacion në lidhje me regjistrimin e objektit të identifikuar me pikën blu, të nxjerrë nga imazhet e printuara në datën 7.6.2022 nga faqja zyrtare ASIG dhe shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2022, lëshuar nga ASHK Vlorë në përgjigje të kërkesës, sipas të cilës, objekti ndodhet në zonën kadastrale *** dhe pozicionohet në fragmentin e hartës kadastrale ***; ***, dhe se në këtë fragment të hartës nuk vërehet të jetë regjistruar pasuria në fjalë.

c. Shkresë përcjellëse nr. *** prot datë 09.6.2022 lëshuar nga FSHU Vlorë. Bashkëngjitur kesaj shkrese, ndër të tjera ndodhet shkresa e titulluar “Dergim dokumentacioni për lidhje te re” me nr. *** prot. datë 18.07.2014, me anën e të cilës janë përcjellë të dhënat per *billing system* të abonentëve në pallatin e ndërtuar nga firma “****” sh.p.k., në adresën L. ***, Vlorë. Sipas këtyre të dhënave pasqyruar në aktin e titulluar “Kartela e furnizimit me energji *** sh.p.k” , vërehet se, në vitin 2014 si shoqëria “****” sh.p.k ashtu dhe shtetasi F. K., nuk rezultojnë abonent në asnjë prej apartamenteve dhe njesive private, ndërkohë që P. B. rezulton abonent në 25 apartamente dhe 6 njësi.

ç. Prokurë e posaçme nr. ***, datë 27.6.2017, sipas së cilës F. K. në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. autorizon dhe emëron si përfaqësues të posaçëm z. P. B. dhe z. E. B., për të përfaqësuar shoqërinë para institucioneve sa i përket objektit të ndërtuar në Vlorë në lagjen “****” ndërtuar me vendimin KKRT dhe lejen nr. ***, datë 24.2.2009.

d. Kopje lejeje ndërtimi në emër të shoqërisë “****” sipas vendimit nr. ***, datë 24.2.2009, të KRRT-së për objektin në lagjen “****” Vlorë. Si investitor në ndërtim është edhe shtetasi E. B.

dh. Shkresë nr. *** prot., datë 7.6.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas së cilës nuk rezulton të ketë kallëzime/procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me shtetasit E. B. dhe P. B.

- Në pyetësoin nr. 3, me kërkesë të Komisionit subjekti ka vënë në dispozicion planimetri të apartamentit përgatitur nga shtetasi A. G. në datën 2.9.2022, kërkuar nga shtetasi P. B. Po kështu, deklaroi se gjatë periudhës kohore që subjekti ka poseduar apartamentin në posedim të shtetasit P. B., por edhe aktualisht, z. B. ka jetuar në banesën e emërtuar si pasuria nr. ***, Vlorë, vërtetuar me dokumente shkresore lëshuar nga ASHK Vlorë dhe shkresë nga UK Vlorë.

- Sipas informacionit të RNSH⁴³-së, nuk rezulton ndonjë akt noterial ku të jenë palë subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi F. K. dhe/apo shoqëria “****” sh.p.k.

- Shoqëria “****” sh.p.k. ka informuar⁴⁴ se nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktuale me shtetasit Kledian Llaho, L. Ll., A. Ll., E. Ll., V. Gj. dhe L. Gj..

40.4. Me qëllim evidentimin e një konflikti të mundshëm interesi apo kontakteve të papërshtatshme, pas verifikimeve rezultoi se:

- Në lidhje me shtetasin P. B., nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar⁴⁵.

- Nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar për shtetasin E. B.⁴⁶.

- Në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk ka konfirmuar çështje të trajtuara nga subjekti.

- Nuk rezultuan të dhëna për përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar për shtetasin F. T. K.⁴⁷.

- Sa i takon trajtimin të çështjeve penale për shtetasin F. K. ka rezultuar se: (i) në dy raste ku ka qenë i akuzuar, shtetasi F. K. ka kërkuar përjashtimin e subjektit nga trajtimi i çështjeve, kërkesa që i janë pranuar; si dhe (ii) subjekti ka pasur në shqyrtim dy çështje penale ku F. K. ka qenë kallëzues, në të cilat ka vendosur mosfillimin e hetimeve. Nga vlerësimi i çdo informacioni që ka lidhje me çështje penale të shtetasit F. K., ka rezultuar se subjekti dhe ky shtetas kanë pasur një konflikt midis tyre dhe në asnjë rast nuk u vërtetua që subjekti ta ketë favorizuar atë (trajtuar hollësisht në paragrafin e aftësive profesionale).

40.5. Gjithsesi, pavarësisht konstatimeve në paragrafin më sipër, ajo që vlerësohet me peshë nga ana e Komisionit në këtë moment, është fakti që në vitin 2016 kur nga subjekti është përdorur apartamenti objekt verifikimi, nuk ka pasur asnjë marrëdhënie të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k. apo me administratorin e saj F. T. K. vërtetuar me:

(i) informacionin e dhënë nga FSHU, sipas të cilit, në momentin e lidhjes së kontratave me furnizimin e energjisë elektrike në vitin 2014, as shoqëria dhe as shtetasi F. K. nuk

⁴³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2022, të MD-së, RNSH, në dosjen e Komisionit.

⁴⁴Shihni shkresën të shoqërisë “****” sh.p.k., të protokolluar me nr. ***, datë 6.10.2022 dhe nr. *** prot., datë 10.11.2022, në dosjen e Komisionit.

⁴⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

⁴⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2022, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 dhe shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2022, të SPAK-ut në dosjen e Komisionit.

⁴⁷Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

rezulton abonent i ndonjë apartamenti, ndërkohë që P. B. ka lidhur kontrata per 26 apartamente.

(ii) shkresat e shoqërisë *** sh.p.k, protokolluar pranë Komisionit përkatësisht në numrat ***, datë 6.10.2022 dhe *** prot. datë 10.11.2022, të cilat konfirmojnë që nuk ka asnjë lidhje kontraktuale midis shoqërisë dhe subjektit Kledian Llaho dhe familjarëve të tij.

Pra, shoqëria dhe administratori i saj nuk kanë qenë posedues të asnjë prej apartamenteve në vitin 2016, çka përjashton tërësisht mundësinë që të kenë qenë posedues të apartamentit të përdorur nga subjekti.

40.6. Nga të gjitha provat e administruara, në përfundim të hetimit administrativ nuk ka pasur problematika e dyshime në lidhje me përdorimin për një vit pa qira (nga janari 2016 deri në fund të muajit janar 2017) të apartamentit objekt verifikimi nga ana e subjektit, pasi rezultoi e vërtetuar që: (i) subjekti nuk u gjend në situatë konflikti interesi me poseduesin e apartamentit P. B., ashtu sikurse edhe me djalin e tij E. B.; (ii) u vërtetua shkëputja e marrëdhënieve të subjektit me këtë apartament, pasi në DPV/2017 subjekti ka deklaruar si adresë banimi adresën e një pasurie tjetër të marrë me qira në lagjen “***”, Vlorë, në pronësi të shtetasit D. D., e cila është deklaruar si pasuri në përdorim me qira në DPV për vitin 2017 dhe në përgjigje të pyetësorit standard); (iii) nuk u vërtetua asnjë lidhje e subjektit me apartamentin në fjalë, përveç faktit që ai e ka përdorur për një vit, si dhe nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim i ligjshëm për një lidhje/pronësi të mundshme të subjektit me/në këtë pasuri.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur L. Ll., e cila në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është pjesë përbërëse e familjes dhe ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

41. *Depozitë në “Credins Bank” të krijuar si rezultat i transfertës nga babai V. Gj. në muajin maj 2016. Vlera: 6.000 euro. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë depozitë. Gjatë hetimit administrativ, “Credins Bank”⁴⁸ ka konfirmuar se shtetasi L. Ll. është klient i bankës dhe sipas ekstrakteve bashkëngjitur, rezulton se përputhet deklarimi me informacionin bankar.*

41.1. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, nga verifikimi i deklaratave rezultoi se:

- Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar transfertë nga babai i saj V. Gj. në muajin maj 2016. Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka paraqitur disa dokumente⁴⁹, sipas të cilave babai i saj V. Gj. ka përfituar të ardhura nga qiraja e një objekti/hotel në Sarandë.

- Në DPV/2016, subjekti si dhe bashkëshortja, kanë deklaruar: në datën 4.5.2016 derdhje nga babai i bashkëshortes në llogarinë e saj pranë “Credins Bank” vlerën 7.000 euro dhe pjesën takuese 100 %.

- Nga informacioni i përcjellë nga “Credins Bank”⁵⁰, ka rezultuar se origjina e kësaj llogarie vjen nga data 4.5.2016, ku në llogarinë e znj. L. Ll. është depozituar shuma 7.000 euro me përshkrimin “derdhje V. Gj.”; në datën 14.7.2016 bashkëshortja e

⁴⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2021, të “Credins Bank”, në dosjen e Komisionit dhe aneksin nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁹Shihni aneksin nr. 4/7 të ILDKPKI-së.

⁵⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2021, të “Credins Bank” në dosjen e Komisionit dhe aneksin nr. 4/7 dokument, në dosjen e ILDKPKI-së.

subjektit ka tërhequr *cash* shumën 1.000 euro, duke mbetur kështu balanca prej 6.000 euro.

41.2. Në lidhje me të ardhura të ligjshme të babait të bashkëshortes së subjektit nga qiratë, u kryen verifikimet si vijojnë:

- Sipas kontratës së qirasë nr. ***, datë 20.3.2015, shtetasi V. Gj. i jep me qira shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k. pasurinë e llojit “truall” me sip. 600 m², nga e cila 329.44 m² ndërtesë, në Sarandë, nr. pasurie ***, me afat 24-mujor dhe vlerë qiraje prej 1.250 euro/muaj, e cila do të realizohet në llogarinë bankare të qiradhënësit nr. *** në “Raiffeisen Bank”.

- Në sistemin *online* të QKB-së, rezultoi se shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. janë persona juridikë, me status “aktiv”.

- “Raiffeisen Bank”⁵¹ ka konfirmuar se shtetasi V. Gj., administrator dhe pronar i subjektit “V. Gj.” PF, me NIPT ***, ka llogari nr. ***, me gjendje 19.993,15 euro, ku vërehen veprimet: (i) në datën 26.3.2015, përshkrimi “pagesë sipas kontratës së qirasë me nr. *** dhe datë 20.3.2015”, me urdhërues ****, në shumën 7.500 euro; (ii) në datën 27.3.2015, përshkrimi “likuidim sipas kontratës nr. ***, datë 20.3.2015”, me urdhërues “****” sh.p.k., në shumën 7.500 euro; (iii) në datën 6.4.2016, përshkrimi “pagesë sipas kontratës së qirasë me nr. *** dhe datë 20.3.2016”, me urdhërues Sh. I., në shumën 7.500 euro; (iv) përshkrimi “likuiduar sipas kontratës nr. ***, datë 20.3.2015”, me urdhërues “****” sh.p.k., në shumën 7.500 euro.

- Sa i takon pagesave të tatimit në burim për të ardhurat nga qiraja të përfituara nga babai i bashkëshortes, sipas kontratave të paraqitura këtë detyrim e kanë qiramarrësit. Konkretisht, parashikohet se: *“Në këtë kontratë përcaktohet se qiramarrësit kanë detyrimin të paguajnë detyrimin e të ardhurave për qiradhënie, si dhe taksa të tjera për ndërtesën sipas tarifave ligjore në pronësi, 50 % nga secili qiramarrës”*.

41.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti paraqiti sërish kontratën e qirasë certifikatë/kartelë të pasurisë nr. *** (hoteli), foto të objektit hotel, si dhe dokumentacionin nga shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., me të cilat vërtetohet se:

- Me shkresën nr. ***, datë 6.6.2022, të shoqërisë “****” sh.p.k. provohen pagesat e tatimeve në burim, si dhe pagesa e taksave për ndërtesën që rrjedhin nga kontrata e qirasë, duke bashkëngjitur: urdhërpagesë tatim i mbajtur në burim datë 20.5.2015, periudha tatimore prill 2015, me përshkrimin “tatim mbi qiranë”, në shumën 180.000 lekë, duke përfshirë interesin dhe gjokat deri më 20.5.2015. Kjo shumë tatimi i korrespondon një qiraje në vlerën 1.200.000 lekë/rreth 8.700 euro⁵².

- Me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2022, të shoqërisë “****” sh.p.k., deklarohet se është paguar tatimi i të ardhurave nga qiraja, si dhe taksat e tjera për ndërtesën, duke bashkëngjitur: (i) mandat bankar datë 7.4.2015, me përshkrimin “tatim i mbajtur në burim mars 2015, në shumën 180.518 lekë”; (ii) urdhërpagesë tatim i mbajtur në burim datë 14.4.2016, periudha tatimore mars 2016, me përshkrimin “tatim mbi qiranë detyrimi principal, në shumën 219.342 lekë” dhe mandat bankar datë 15.4.2016 me përshkrimin “tatim i mbajtur në burim mars 2016, në shumën 219.342 lekë”, i cili i korrespondon një shume qiraje prej 1.462.000 lekësh/10.800 euro.

⁵¹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.6.2021, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁵²1 euro = 137.65 lekë, Banka e Shqipërisë, më 31.12.2015.

41.4. Në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se subjekti ka provuar: (i) marrëdhënien e qirasë midis shtetasit V. Gj. dhe shoqërive të sipërpërmendura me akt noterial; (ii) përfitimin me bankë të dy shumave nga 7.500 euro/secila, në mars 2015; (iii) faktin që shoqëria “***” sh.p.k. ka paguar pagesën e tatimit në burim për këto shuma e, për rrjedhojë, këto të ardhura janë të ligjshme. Në këto kushte, u vërtetua që vjehri i subjektit V. Gj., ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i depozituar vajzës së tij L. Ll., shumën 7.000 euro në datën 4.5.2016, e për rrjedhojë depozita objekt verifikimi në vlerën 6.000 euro, është me të ardhura të ligjshme.

42. *Llogari rrjedhëse në BKT të krijuar si rezultat i përfitimit të pagës si juriste pranë Universitetit I. Q..* Vlera: 401,846 leke. Pjesa: 100 %. ILDKPKI nuk ka konstatuar problematikë. Gjate hetimit administrativ: (i) BKT⁵³ka konfirmuar se shtetasja L. Ll. ka llogari page dhe sipas ekstraktit të llogarisë, rezulton kreditim page nga Universiteti I. Q.; (ii) ISSH⁵⁴ ka konfirmuar se kontributet e shtetasës L. Ll. për periudhën tetor 2015-shtator 2016, jane derdhur nga Universiteti I. Q. Vlorë. Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat bankare.

43. *Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” të krijuar si rezultat i përfitimit të pagës si juriste pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe Spitalit Rajonal Vlorë.* Vlera: 109.486 lekë. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematikë. Gjatë hetimit administrativ “Credins Bank”⁵⁵, ka konfirmuar se shtetasja L. Ll. është klient i bankës sipas ekstraktit bashkëngjitur të llogarisë në lekë dhe rezulton të jetë kredituar pagë nga Këshilli i Qarkut Durrës dhe Spitali Rajonal Vlorë. Deklarimet e subjektit përputhen me të dhënat bankare.

Konstatime të tjera

44. Në raportin e përpiluar nga ILDKPKI-ja, është konstatuar: *“Rezulton se subjekti ka shkelur ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’”*. Në lidhje me këtë konstatim, nga ana e Komisionit u kryen verifikimet si vijojnë:

44.1. QKB-ja⁵⁶ ka konfirmuar se shtetasit V. Gj. dhe L. Gj. figurojnë të regjistruar si persona fizikë, ku sipas ekstrakteve historike rezulton se: (i) shtetasi V. Gj. (babai i bashkëshortes) është regjistruar si person fizik me NUIS ***, me datë regjistrimi 1.1.2003, me fushë veprimtarie restorant, me adresë Vlorë, Sarandë, godinë ***-katëshe hotel “***”, me status “çregjistruar në datën 15.3.2016”; (ii) shtetasja L. Gj. (nëna e bashkëshortes) është regjistruar si person fizik me NUIS ***, me datë regjistrimi 25.11.2015, me fushë veprimtarie hotel-restorant, me adresë Vlorë, Sarandë, godinë private ***-katëshe, me status “pezulluar më 27.1.2021”.

44.2. APP-ja⁵⁷ ka konfirmuar se subjektet V. Gj. dhe L. Gj. janë regjistruar në sistem dhe janë shpallur fitues në procedura të prokurimit elektronik, për periudhën deri në datën 25.1.2017. Sipas listës bashkëlidhur, rezulton se shtetasi V. Gj. është shpallur fitues dy herë në vitin 2014 me objekt prokurimi “drekë festive për rastin e Vitit të Ri”,

⁵³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2021, të BKT-së në dosjen e Komisionit. Aneksi nr. 4/8; Aneksi nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021 të ISSH-së, në dosjen e Komisionit.

⁵⁵Shihni shkresën nr. ***prot., datë 12.7.2021, të “Credins Bank”, në dosjen e Komisionit; dhe aneksin nr. 4/9 dhe nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵⁶Shihni shkresën nr. ***prot., datë 4.6.2021, të QKB-së në dosjen e Komisionit.

⁵⁷Shihni aneksin nr. 38, shkresën nr. *** prot., datë 21.3.2019, të Agjensisë së Prokurimit Publik, në dosjen e ILDKPKI-së.

në vlera përkatësisht 22.950 lekë dhe 109.560 lekë, ndërsa, shtetasja L. Gj. është shpallur fituese një herë në vitin 2016, në vlerën 69.500 lekë.

44.3. Sipas nenit 21, pika 1, nenit 22, pikat 1 dhe 2, dhe nenit 24 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, personat e lidhur me subjektin (prindërit e bashkëshortes) nuk mund të lidhnin kontrata me institucione publike. Një ndalim i tillë vjen sipas ligjit nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, hyrë në fuqi në datën 5.6.2014.

44.4. Në lidhje me këtë konstatim, gjatë hetimit administrativ iu kërkua subjektit të japë sqarime, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, vlerëson se nuk ka shkelur ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, duke deklaruar se:

- Së pari, prindërit e bashkëshortes kanë ushtruar prej vitesh aktivitet privat familjar në fushën e restorant-hoteleri në qytetin e Sarandës dhe se ata nuk kanë qenë asnjëherë subjekt deklarues në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. Të ardhurat e përfituara nga shpallja fitues në procedura prokurimi nuk kanë asnjë lidhje me detyrën e tij si prokuror, për më tepër që detyra është ushtruar në një rreth tjetër, si dhe nuk janë destinuar/adresuar si të ardhura në favor të bashkëshortes së tij, të cilat do të krijonin qoftë edhe në dukje perceptimin e një gjendjeje në konflikt interesi. Një pjesë e kontributit financiar të prindërve të bashkëshortes në favor të saj, i përket periudhës kur ai nuk ka qenë subjekt deklarimi (viti 2010 - 2011), ndërsa të ardhurat e përfituara nga shpallja fitues në procedura prokurimi sipas konstatimit të ILDKPKI-së i përkasin dhjetorit të vitit 2014. Një pjesë tjetër e kontributit financiar të prindërve të bashkëshortes në favor të saj, i përket periudhës kohore maj 2016, burim i të cilave ka qenë kontrata e qirasë ndërsa të ardhurat e përfituara nga shpallja fitues në procedura prokurimi sipas konstatimit të ILDKPKI-së, i përkasin dhjetorit të vitit 2016. Sipas subjektit, është e qartë se ka shpëputje të dukshme në kohë midis ndihmesës financiare nga prindërit e bashkëshortes dhe të ardhurave të tyre nga aktiviteti ekonomik nga shpallja fitues në procedura prokurimi.

- Së dyti, në lidhje me pozicionin e tij si zyrtar/gjyqtar/prokuror në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, subjekti parashton se: *“Për këtë konstatim të ILDKPKI-së bëhet me dije për herë të parë nga Komisioni dhe se nuk i është bërë me dije shkelja e këtyre dispozitave të ligjit nga ILDKPKI-ja si institucioni përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit. Detyrën si prokuror e kam ushtruar në Vlorë, bashkëshortja ka punuar në Këshillin e Qarkut Durrës deri në shkurt 2015, ndërsa prindërit e saj kanë ushtruar aktivitetin në Sarandë, pra ka qenë tërësisht e pamundur marrja dijëni në lidhje me këto procedura prokurimi. Dijënia nuk mund të prezumohet apriori, por ajo duhet të provohet se subjekti ka pasur dijëni dhe nuk ka marrë masat e duhura për ta parandaluar atë. Nga prindërit e bashkëshortes më është bërë me dije se ata vetë nuk kanë lidhur ndonjë kontratë me ndonjë institucion publik dhe se rastet e referuara nga ILDKPKI-ja, kanë qenë procedura prokurimi me vlerë të vogël për të cilat nuk është lidhur ndonjë kontratë duke u shlyer me faturë tatimore shërbimi i ofruar. Subjekti deklaroi se me fillimin e detyrës në qershor 2014, ua ka bërë të qarta ndalimet ligjore prindërve të bashkëshortes për të mos lidhur kontratë me institucione publike, por ka qenë objektivisht e pamundur për ata të interpretojnë aq hollësisht çdo dispozitë konkrete (sikurse do të ishte neni 40, pika 6 e ligjit ‘Për prokurimet publike’,*

i cili barazon faturën tatimore me kontratën) të legjislacionit tatimor, financiar dhe juridik”.

44.5. Pavarësisht sa ka pretenduar subjekti, me njoftimin e rezultateve të hetimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të vijojë të japë sqarime e dokumente në lidhje me konstatimin se *duket se prindërit e bashkëshortes kanë shkelur ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.*

44.6. Në parashtrimet e tij subjekti dha përgjithësisht të njëjtat sqarime si në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, duke pretenduar se konstatimi i ILDKPKI-së nuk qëndron. Sipas subjektit, nga interpretimi gjuhësor, literal dhe sistematik i dispozitave të ligjit nr. 9367/7.4.2005, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Vlorë në periudhën qershor 2014 – janar 2022, nuk është ndodhur në asnjë nga situatat e përcaktuara nga dispozitat e ligjit, pasi ka qenë krejtësisht e pamundur një rrethanë e tillë (trajtimi i ndonjë çështjeje penale) për shkak të mungesës së juridiksionit dhe kompetencës territoriale për të shqyrtuar çështje në të cilat mund të përfshiheshin institucionet e Sarandës, për të cilat babai i bashkëshortes ka lëshuar fatura tatimore.

Sipas subjektit, fakti që prindërit e bashkëshortes në cilësinë e personit të lidhur sipas nenit 24 të ligjit nr. 9367/7.4.2005, kanë lëshuar fatura tatimore të cilat në kuptim të nenit 40, pika 6 e ligjit “Për prokurimet publike” barazohen me kontratën, duhet të vlerësohen në dritën e rrethanave konkrete, të tilla si: (i) nga aktet e referuara prej ILDKPKI-së prindërit e bashkëshortes nuk kanë lidhur kontrata publike në juridiksion territorial në qytetin e Vlorës dhe ai nuk ka zhvilluar hetime për institucionet që janë lëshuar fatura tatimore. Pra, nuk është krijuar as dukja se ka qenë ose mund të ketë qenë i ndikuar në zgjidhjen e ndonjë çështjeje; (ii) aktualisht ligji nr. 9367/2005, është në proces të ndryshimeve përkatëse në dispozitat e tij, ku sipas projektligjit të propozuar nga ILDKPKI-ja, kufizimi për të lidhur kontrata publike nga personat e lidhur me magjistratin që ushtron detyrën pranë gjykatës së shkallës së parë, lidhet vetëm me juridiksionin territorial ku gjyqtari ushtron detyrën; (iii) subjekti ka sjellë në vëmendje vendimin nr. 14/19.5.2022 të Kolegjit.

44.7. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të kësaj çështjeje, Komisioni ka mbajtur në konsideratë faturimet në vlera të vogla në emër të prindërve të bashkëshortes nga prokurimet publike në qytetin e Sarandës, si dhe largësinë gjeografike të subjektit të rivlerësimit, i cili banonte në qytetin e Vlorës, që bën të besueshme padijeninë e tij për këto prokurime. Në këto kushte, si dhe, referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në një rast të ngjashëm, me vendimin nr. 14/2022, Komisioni çmon se, ndonëse në kuptimin formal dhe strikt të ligjit subjekti duhet të identifikonte aspektet që do t’i vinin prindërit e bashkëshortes në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, në një vlerësim tërësor të rrethanave të çështjes, çmohet se konflikti i interesit i konstatuar nuk mund të përbëjë shkelje nën dritën e ligjit nr. 84/2016 dhe as të sjellë pasojën e shkarkimit në procesin e rivlerësimit, si në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, për sa kohë nuk rezulton se subjekti ka krijuar ndonjë pasuri për shkak të kësaj gjendjeje, ashtu edhe në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, për sa kohë që subjekti ka qenë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Vlorë dhe nuk ka trajtuar çështje te institucioneve që kanë kryer prokurimet në qytetin e Sarandës⁵⁸.

45. Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se nga maji 2015 - dhjetor 2015, ka banuar në adresën: lagjja “****”, rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Vlorë, në pronësi

⁵⁸Shihni vendimin nr. 14 /19.5.2022 të Kolegjit, paragrafët 19/4, 19/11 dhe 19/20.

të shtetasit D. D. Nga ana e Komisionit u kryen verifikime në lidhje me këtë deklaram, nga ku nuk rezultuan problematika. Në lidhje me shtetasit D. D. dhe babain e tij L. D.⁵⁹, nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar.

46. Nga informacioni i përcjellë Komisionit nga “Raiffeisen Bank”, u evidentua se në datën 16.1.2014, ishte kryer një transfertë në shumën 600.000 lekë nga shtetasja H. V., tezja e subjektit, në llogarinë e tij. Me kërkesë të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti sqaroi se këtë shumë tezja e tij e kishte përfituar nga ndarja me ish-bashkëshortin dhe duke qenë e sëmure në atë periudhë, i kishte kërkuar subjektit t’i mbante në llogarinë e tij, të cilat më pas, në vitin 2015 ia ka kthyer tezes. Në mbështetje të këtyre deklarimeve, paraqiti disa dokumente shkresore si vendim gjykate, certifikata nga aktet e gjendjes civile e dokumente bankare, në analizë të të cilave Komisioni krijoi bindjen se deklaramet e subjektit ishin të sakta. Pavarësisht kësaj, duke qenë se në DPF/2014 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 600.000 lekë, por në deklaramat në vijim, ai nuk ka deklaruar sipas ligjit asnjë fakt për gjendjen *cash* (ashtu sikurse edhe në deklaramtën *Vetting*), në analizën financiare është konsideruar që kjo shumë ka qenë gjendje e subjektit nga momenti para fillimit të detyrës deri në fund të vitit 2016, dhe se, ajo është shpenzuar para deklaramtës *Vetting*. Referuar faktit që analiza financiare gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka rezultuar me balanca negative, Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrë prove në lidhje me gjendjen *cash* në shumën 600.000 lekë. Megjithatë, në parashtrimet e veta subjekti i rivlerësimit ka parë të nevojshme të shpjegojë se deklarami i tij në DIPP/2014 ka qenë një përpjekje për të detajuar në mënyrë transparente çdo të ardhur që ai posedonte në atë periudhë kohore, pavarësisht se shuma 600.000 lekë nuk ishte një pasuri e tij, por e tezes së tij, të cilën ai ia ka kthyer në vitin 2015. Mosdeklarami në DPV/2015 i pakësimit ose zerimit të gjendjes *cash*, sipas tij, ka qenë një pakujdesi e tij në momentin e plotësimit të deklaramtës.

47. ILDKPKI-ja ka administruar një *email* të dërguar nga shtetasi H. M., me përmbajtje: “*Prokurori i Vlorës Kledian Llaho, kur ka qenë OPGJ në Sarandë, me vjehrrin e tij V. Gj. filloi hotelin *** kate te Sr tani e përfundoi dhe e ka dhënë me qira me vlera maksimale pa deklaruar në Tatime dhe Bashki*”. Pavarësisht se nuk vërehet që ILDKPKI-ja të ketë kryer verifikime në lidhje me këtë *email*, në lidhje me pasurinë e llojit “hotel” në emër të V. Gj. në Sarandë, nga ana e Komisionit u kryen verifikimet si vijojnë:

47.1. Nga dokumentacioni i administruar⁶⁰ rezultoi se:

- Në lidhje me statusin juridik, objekti në pronësi të shtetasit V. Gj. me nr. pasurie ***, në Sarandë, figuron me dy kate, vërtetuar me kartelën e pasurisë së paluajtshme, sipas së cilës pasuria nr. ***, z. k. ***, ka sipërfaqe totale prej 603.03 m², nga të cilat trull 603.03 m²; ndërtesë 329.44 m². Në seksionin të dhënat e regjistrimit paraprak në kartelë përshkruhet: objekt hotel-restorant *** kate, regjistruar: nr. ***, datë 12.11.2012.

- Sipas aktkolaudimit datë 9.12.2003, përgatitur nga kolaudatori M. M., objekti ka dy kate.

⁵⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; dhe shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

⁶⁰Shihni aneksin nr. 35 dhe nr. 36 në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2022, të ASHK Sarandë dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

- Në lidhje me situatën faktike, nga fotoja⁶¹ e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ky objekt figuron me katër kate dhe një kat parkim.

- Në lidhje me vitet e ndërtimit u administruan disa akte shkresore, përmbajtja e të cilave iu bë me dije subjektit të rivlerësimit me njoftimin e rezultateve të hetimit.

47.2. Nga të gjitha të dhënat e administruara, për Komisionin mbetet e paqartë periudha e ndërtimit të dy kateve të tjera, të cilat duket të jenë ndërtuar pas vitit 2004. Duke qenë se subjekti është martuar me bashkëshorten në vitin 2007, mbetet e paqartë nëse ai dhe bashkëshortja kanë kontribuar në investimin e objektit katërkatësh. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime e dokumente mbi kohën e saktë të ndërtimit të të gjitha kateve dhe të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e objektit.

47.3. Në parashtrimet e veta, subjekti ka deklaruar se pasuria në fjalë është krijuar më parë se data e lidhjes së martesës, 26.10.2007, vërtetuar me certifikatë nga aktet e gjendjes civile. Sipas subjektit, faktet e paraqitura nga shtetasi H. M. janë të rreme dhe alogjike, por edhe lehtësisht të verifikueshme si të tilla. Subjekti vlerëson se ka sqaruar bindshëm që objekti në pronësi të vjehrrit V. Gj. është ndërtuar para vitit 2007 dhe tërësisht me të ardhurat nga puna e prindërve të bashkëshortes nga aktiviteti i biznesit që prej vitit 1994 dhe në vijim, si dhe kreditë e marra ndër vite. Subjekti argumenton se ai dhe bashkëshortja jo vetëm që nuk kanë kontribuar asnjë vlerë financiare në ndërtimin e atij objekti, por përkundrazi, ata kanë përfituar ndihma prej prindërve të bashkëshortes. Sipas subjektit, nga komunikimi me prindërit e bashkëshortes, dy katet e sipërme të objektit (i treti dhe i katërti) kanë përfunduar si strukturë betoni dhe muraturë në verën e vitit 2004 dhe si burim të ardhurash ka shërbyer kredia e përfituar në maj 2004. Në vijim, subjekti u referohet ortofotove të administruara me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 6.12.2022 të ASIG-ut, ku sipas tij rezulton se objekti përgjatë viteve 2007 (ortofoto 2007), 2015 (ortofoto 2015) dhe 2019 (ortofoto 2019), nuk ka pësuar ndryshime as në lartësi dhe as në shtrirje horizontale. Sipas subjektit, nga pamjet imazherike konstatohet shumë qartë se e njëjta strukturë (godinë/objekt katër kate) që rezulton në fotot e realizuara në vitet 2015 dhe 2019, ka ekzistuar edhe në ortofoton e vitit 2007.

Subjekti konkludon se: *“Në kushtet kur është provuar me akte shkresore që deri në prill 2004 objekti ka qenë i përfunduar në lartësinë dy kate, në vitin 2007 provohet me ortofotot e administruara nga institucionet shtetërore se ai rezulton me të njëjtën madhësi (4 kate), sikurse në ortofotot e viteve 2015 – 2019, atëherë konkluzioni logjik mbi kohën e ndërtimit të dy kateve të tjera është se ato janë ndërtuar gjatë vitit 2004 dhe në vijim, por para muajit tetor 2007 (data e lidhjes së martesës me bashkëshorten ka qenë 26.10.2007)”*.

Veç sa më sipër, subjekti sjell në vëmendje vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, të Kolegjit, sipas të cilit subjekti duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Në mbështetje të pretendimeve të tij subjekti paraqiti: (i) shkresë nr. *** prot., datë 6.12.2022, të ASIG-ut, me fotografimet ajrore të vitit 2007, 2015, 2019; (ii) kontratë kredie nr. *** rep., *** kol., datë 19.5.2015, lidhur mes shtetasit V. Gj. si person fizik dhe “Intesa Sanpaolo Bank”, për shumën 7.000.000 lekë, me qëllim investime në biznes; (iii) kontratë nr. ***, datë 26.4.2010, “Amendament i kontratës së Kredisë bankare nr. ***, datë. 18.5.2004” me kredimarrës V. Gj. pranë “Intesa

⁶¹Shihni aneksin nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

Sanpaolo Bank”. Në përgjigje të pyetësorit tre, subjekti paraqiti dosjen e kredive, nga ku rezultoi se kreditë e marra në 2004 dhe 2010 janë përdorur nga vjehri i subjektit për investime të zgjerimit të Hotel *** në Sarandë.

47.4. Sa i takon pretendimit se pasuria në fjalë është ndërtuar përpara tetorit të vitit 2007, kur subjekti është martuar me bashkëshorten, Komisioni, për sa kohë nuk disponon dokumente shkresore si dhe në kushtet kur prindërit e bashkëshortes, por as subjekti, nuk kanë qenë subjekte deklaruese, që do të passillte detyrimin e tyre për të deklaruar vlerat e investimeve ndër vite, burimet e tyre, pakësim të likuiditeteve, etj., është në pamundësi objektive për të vërtetuar periudhat e investimeve në objekt dhe vlerat e tyre. Por, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, çmoi se ka disa elemente që i bëjnë të besueshme deklaratimet e subjektit, analizuar si më poshtë vijon:

i) Duke iu referuar shkresës të ASIG nr. *** prot., datë 6.12.2022, nga fotografimet ajrore të viteve 2007, 2015 dhe 2019, vërehet se nuk ka ndryshim në ndërtesë nga viti 2007 deri në vitin 2019.

ii) Nga ana tjetër, është e vërtetë që ortofotot nuk mjaftojnë për të vërtetuar faktin se ndërtesa ka përfunduar përpara tetorit të vitit 2007, për sa kohë nuk ka informacion mbi sipërfaqe të ndërtesës apo të kuotave ndër vite. Por, Komisioni administroi disa akte shkresore, duke marrë disa të dhëna që hedhin dritë mbi periudhat e ndërtimit të dy kateve të tjera në godinë. Konkretisht:

Së pari, është administruar deklarata për aktivitetin e hotelerisë “****” të vitit 2009, sipas së cilës numri i dhomave të hotelit është deklaruar 6. Por, një fakt i tillë nuk provon në vetvete numrin faktik të kateve në këtë vit, pasi një pjesë e godinës, siç rezulton nga aktet, ka qenë banesë e shtetasit V. Gj., ndërsa nuk përjashtohet mundësia që vetëm gjashtë dhoma të godinës të ishin në funksion të aktivitetit të hotelerisë, për shkak të të cilit është lëshuar kjo deklaratë.

Së dyti, është administruar formulari i deklaratimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, datë 23.3.2010 (dhe në vijim), nga ana e shtetasit V. Gj., ku është deklaruar adresa *godinë ***-katëshe hotel ****, një e dhënë kjo që tregon se në vitin 2010 godina ka qenë katërkatëshe. Ndërsa, sipas aktkolaudimit në datën 9.12.2003, në fillim të vitit 2004, objekti ka qenë me dy kate. Pra, referuar të dhënave të këtyre dy shkresave, dy katet e tjera janë ndërtuar pas vitit 2004. Ndërkohë, në vitin 2004 shtetasi V. Gj. ka marrë një kredi prej 50.000 euro me qëllim përdorimin për përfundimin e punimeve të brendshme të objektit bar-restorant-hotel, fakt që tregon se ndërtimet kishin përfunduar dhe se investimet për përfundimin e punimeve të brendshme janë kryer menjëherë pas marrjes së kredisë në vitin 2004, duke bërë më të besueshëm deklaratimin e subjektit që ndërtimi i dy kateve të tjera ka përfunduar përpara tetorit të vitit 2007, kur ai është martuar me bashkëshorten.

47.5. Sa i takon pretendimit se investimet janë kryer me të ardhura të prindërve të bashkëshortes dhe kredi të marra prej tyre, Komisioni çmon se për shkak se ata nuk kanë qenë subjekte deklaruese, është objektivisht e pamundur kryerja e një analize financiare të mirëfilltë për të evidentuar investimin në objekt me të ardhura të ligjshme nga ana e tyre. Por, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se ka disa elemente që tregojnë të dhëna mbi burimin e të ardhurave për të kryer investimet në objekt. Konkretisht është vërtetuar se:

- Shtetasi V. Gj. është regjistruar si person fizik me NUIS *** në datën 1.1.2003, me fushë veprimtarie restorant, me adresë: Vlorë-Sarandë, Lagjja nr. ***. Ndërsa L. Gj. është regjistruar si person fizik me NUIS *** me datë regjistrimi 25.11.2015 me fushë

veprimtarie hotel-restorant, me adresë Vlorë-Sarandë, fakte që vërtetojnë ushtrimin e aktivitetit privat të legjitimuar që në vitin 2003.

- Nga aktet shkresore bashkëlidhur dosjeve të kredisë ka të dhëna që tregojnë për aktivitetin privat të subjektit “***” që nga viti 1994, ashtu sikurse dhe subjekti ka deklaruar. Konkretisht, në kërkesën me datë 25.2.2004 të shtetasit V. Gj. për marrje kredie, ai deklaroi se ushtron aktivitetin hotel-bar-restorant prej dhjetë vitesh. Në “letër referencën” e datës 20.2.2004 nga ekonomisti G. K., ky i fundit deklaroi se prej 10 vjetësh V. Gj. ushtron aktivitet në fushën e shërbimeve turistike bar-restorant-hoteleri, në objektin në pronësi të tij.

- Sipas kontratës nr. ***, datë 18.5.2004, nga ana e shtetasit V. Gj. është marrë një kredi në shumën 50.000 euro.

- Sipas kontratës nr. ***, datë 26.4.2010, “amendament i kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 18.5.2004” mes shtetasve V. dhe L. Gj. dhe “American Bank Albania”, vërtetohet se kredia në shumën 50.000 euro është marrë në vitin 2004 me qëllim përdorimin për përfundimin e punimeve të brendshme të objektit bar-restorant-hotel. Sipas kësaj kontrate (akti me nr. ***, datë 26.4.2010), vërtetohet edhe kredia në shumën 23.000 euro e marrë në vitin 2010.

- Me kontratë kredie nr. ***, datë 19.5.2015, mes shtetasit V. Gj. si person fizik dhe “Intesa Sanpaolo Bank”, është marrë kredi në shumën 7.000.000 lekë, me qëllim investime në biznes.

- Sipas *statement*-it bankar të llogarisë nr. *** në euro, në emër të shtetasve V. dhe L.Gj., etj., vërtetohen veprime bankare, të cilat kanë shërbyer për pagesat e kredive.

- Ka pasur të dhëna që vërtetonin se babai i bashkëshortes së subjektit ka dhënë me qira pasuri për të cilat nuk është vërtetuar pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga qiratë. Por, mospagimi i këtij tatimi, ashtu sikurse dhe mungesa e të dhënave për pagimin e të gjitha detyrimeve tatimore që rrjedhin nga aktiviteti privat ndër vite nga ana e çiftit Gj., nuk mund të penalizojnë ata dhe as subjektin e rivlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit të tij.

47.6. Bazuar në të gjitha sa më sipër, nuk mund të arrihet në një konkluzion përfundimtar nëse prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për investimin në objekt ndër vite, e aq më tepër për të arritur në përfundimin se objekti është investuar me kontribut të pajustificuar ligjërisht të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës që ka qenë OPGJ apo që subjekti të ketë fshehur një pasuri të mundshme të tij. Për më tepër: (i) ka pasur mjaftueshëm të dhëna që tregojnë ushtrimin aktiv të biznesit nga ana e çiftit Gj. që nga viti 1994 dhe është vërtetuar marrja e kredive të përdorura si për investimin në objekt, ashtu dhe për zhvillimin e biznesit; (ii) nuk u evidentua asnjë lidhje e subjektit dhe bashkëshortes së tij me objektin në fjalë si fatura, aktmarrëveshje/kontrata të çdolloji me cilindo subjekt të së drejtës civile apo transaksione bankare të çdolloji midis subjektit apo/dhe bashkëshortes me prindërit e kësaj të fundit; (iii) të dhëna të tilla mungojnë të jenë paraqitur edhe nga denoncuesi, shtetasi H. M., ndërkohë që, nuk ka pasur të dhëna të tjera, nga cilido burim qoftë, në lidhje me kontribute të subjektit në objektin hotel në pronësi të shtetasit V. Gj. në Sarandë.

47.7. Në përfundim të procesit, Komisioni nuk evidentoi asnjë provë e rrethanë që të hidhte dritë mbi një pasuri të mundshme fshehur të subjektit të rivlerësimit për shkak të kontributit të tij në objektin hotel në Sarandë, si dhe nuk u konstatua asnjë veprim apo mosveprim i subjektit, që do ta vinte atë në kushtet e cenimit të besimit të publikut

si pjesë e sistemit të drejtësisë. Në këto kushte, subjekti me të drejtë i referohet qëndrimin të Kolegjit⁶², sipas të cilit analiza financiare nuk mund të shtrihet edhe për pasuri të tjera të personave të tjerë të lidhur, me përjashtim të atyre të dhuruara apo të dhëna hua subjekteve të rivlerësimit. Ndihmësit modestë familjarë të prindërve të bashkëshortes të deklaruar nga subjekti, të cilat janë tërësisht legjitime në kuadër të marrëdhënieve familjare prind - fëmijë, por edhe të traditës zakonore në vendin tonë, u analizuan në mënyrë të detajuar nga ana e Komisionit, nga ku nuk u evidentuan problematika.

Analizë financiare

48. Në përfundim të hetimit administrativ u krye analiza financiare për të gjithë periudhën kur subjekti ka qenë në detyrë, nga ku nuk rezultuan balanca negative për asnjë prej viteve. Sa i takon periudhës përpara fillimit të detyrës nga analiza financiare, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar apartamentin, garazhin, likuiditetet në bankë dhe *cash* në banesë, si dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e evidentuara të kësaj periudhe, për shkak të një balance negative prej -1.390.354 lekë. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

49. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konstatim, duke pretenduar se balanca negative ka rezultuar për shkak të disa gabimeve materiale në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Konkretisht parashtron se:

i) Në shpenzimet e udhëtimeve TIMS në vitet 2012 (480 euro) dhe 2013 (130 euro), janë përfshirë dy udhëtime pune të financuara nga Prokuroria e Përgjithshme/organizatorët. Subjekti depozitoi komunikimet elektronike, biletat dhe axhendën e vizitës, dërguar nëpërmjet *email*-it nga përfaqësues të G.-it dhe O.-it, për udhëtimet në vitin 2012 dhe 2013 dhe mbulimin e këtyre shpenzimeve nga organizatorët.

ii) Në llogaritjen e pasurisë për periudhën 2010 - 20.6.2014, Komisioni ka përfshirë gabimisht jo vetëm “ndryshimin e likuiditeteve” që kanë ndodhur çdo vit, por edhe “Gjendjen e likuiditeteve” në shumën 814.528 lekë, duke e vlerësuar kështu më tepër pasurinë, nga 12.440.578 lekë që duhej në 13.255.105 lekë.

iii) Duhet të merret në konsideratë diferenca në shumën prej + 408.049 lekë si mundësi kursimi e prindërve për të dhuruar shumën 7.000 euro kaluar në llogari të djalit.

⁶²Në vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka mbajtur këtë qëndrim: “Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues”. Ndërsa në vendimin nr. 20, datë 31.7.2019, për subjektin G. O., Kolegji ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke theksuar se: “Kolegji vlerëson se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre”.

iv) Duhet të shtohen edhe të ardhurat përfituara nga pensioni i pleqërisë së nënës së subjektit për vitin 2011 në shumën 111.606 lekë, për vitin 2012 në shumën 116.070 lekë dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2013 në shumën 60.158 lekë, në total + 287.834 lekë. Për të vërtetuar sa pretendon, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 9.6.2022, të DRSSH-së Durrës.

Vlerësimi i Komisionit

50. Në analizë të pretendimeve dhe dokumenteve të paraqitura, Komisioni vëren se:

50.1. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me mospërfshirjen në analizën financiare të shpenzimeve të udhëtimit në shumat 480 euro për vitin 2012 dhe 130 euro për vitin 2013, pasi ka provuar me dokumentacion ligjor pretendimin e tij se pagesat për këto udhëtime pune janë mbuluar nga qendra e punës ose organizatorët.

50.2. Në lidhje me pretendimin se Komisioni gabimisht për periudhën 2010 – 20.6.2014 ka përfshirë në analizën e kryer jo vetëm ndryshimin e likuiditeteve, por edhe gjendjen e likuiditeteve, është i drejtë dhe qëndron. Në këto kushte, në sinkron edhe me metodologjinë e përdorur gjatë hetimit administrativ, ku pasuria e çdo viti vlerësohet duke përfshirë vetëm ndryshimet (pakësimet ose shtesat) në likuiditet, Komisioni bëri saktësimet në vlerat e përlogaritura për pasurinë për periudhën 1.1.2005 – 20.6.2014, duke ndryshuar shumën nga 13.255.105 lekë në 12.440.578 lekë, në rubrikën “pasuri” të analizës financiare.

50.3. Në lidhje me pretendimin për të përfshirë në analizë financiare vetëm mundësinë për kursime të prindërve në shumën 408.049 lekë, u vlerësua se nuk qëndron, pasi sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor në kuptim të pikës 3, neni D i Aneksit të Kushtetutës të provojë burimin e ligjshëm të të gjithë shumës që ka rezultuar nga marrëdhënia e interesit me personin tjetër të lidhur, në rastin konkret të shumës 7.000 euro dhuruar nga vjehrrit e subjektit (trajtuar hollësisht në paragrafin 32.1 e në vijim të këtij vendimi).

50.4 Në lidhje me pretendimin e subjektit për të përfshirë të ardhurat nga pensioni i nënës për periudhën 2011 – 6/2013, për aq kohë sa nga Komisioni janë llogaritur dhe shpenzime jetike për nënën, e vlerëson pretendimin e subjektit të drejtë. Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit, saktësoi dhe përfshiu në analizën financiare të rishikuar të ardhurat nga pensioni i nënës për periudhën 2011 – 6/2014⁶³ dhe konkretisht: për vitin 2011 në shumën 111.606 lekë, për vitin 2012 në shumën 116.070 lekë, për vitin 2013 në shumën 120.317 dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2014 në shumën 62.050 lekë, pra në një total prej 410.043 lekësh.

51. Në përfundim të procesit, Komisioni, pasi mori në konsideratë disa nga pretendimet si më sipër, rishikoi analizën financiare për periudhën para detyrës, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 80.269 lekë, e cila nuk u konsiderua penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

Përshkrimi	Periudha 1.1.2005 - 20.6.2014
PASURI	12,440,578
Apartament 105.26 m ² , Durrës blerë me K. 29.3.2014 (para detyrës)	6,934,950

⁶³Subjekti ka deklaruar në pyetësoin nr. 3 se nëna ka jetuar me të nga data 1.1.2004, si dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni janë përfshirë shpenzimet jetike të nënës për periudhën 2011 – 6.2014.

Garazh me sip. 23 m ² , Durrës, blerë 17.4.2014 - 50%	500,000
Automjet tip "Volkswagen Passat" V. 2001 – ***, datë 4.6.2013	400,000
Blerë apartament nga nëna 126.9 m ² , L. ***, Rr. "****", Durrës	4,000,000
<i>Ndryshimet e Likuiditeteve</i>	605,628
Detyrime	2,179,718
Kredi tek "Raiffeisen Bank" më 6.5.2008	800,000
Shlyer kredia tek "Raiffeisen Bank"	-800,000
Kredi te "Raiffeisen Bank" Konsumatore me Hipotekë datë K 16.12.2010 për 15 vjet	2,179,718
Pasuri Neto	10,260,860
TË ARDHURA dokumentuar	17,656,206
Të ardhura të subjektit si OPGJ nga 1.2.2000	7,379,420
Nga shitja e apartamentit	3,700,000
Të ardhura të bashkëshortes	2,392,091
Barrë lindje e bashkëshortes	127,388
Pensioni i nënës	959,589
Ndihmë nga prindërit e bashkëshortes	1,527,225
Ndihmë nga nëna	600,000
Ndihmë nga vëllai	968,100
Nga interesa bankarë	2,393
SHPENZIME	7,475,615
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare	4,967,727
Shpenzime udhëtimi TIMS	618,697
Shpenzime kredie tek "Raiffeisen Bank"	7,000
Paguar interesa kredie	846,721
Shpenzime arredimi sipas P. 2, pyetja 2 c/1	981,470
Shpenzime transporti të brendshëm	54,000
Mundësia për kursime	-80,269

Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë

52. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës "a", të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të këtij ligji, për shkak se: (i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (germa "a" e pikës 5); (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa "b" e pikës 5); (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë (germa "c" e pikës 5); si dhe (iv) nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa "d" e pikës 5).

Kontrolli i figurës

53. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2006. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin me nr. *** prot., datë 30.10.2017 mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Kledian I. Llaho, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.6.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në

deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Kledian I. Llaho.

54. Pavarësisht konstatimit të DSIK-së, Komisioni si organ i pavarur nga organet ndihmëse të vlerësimit, kreu disa verifikime në lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit. Konkretisht janë ndërmarrë hapat hetimorë si vijojnë: (i) është kërkuar përditësimi i të dhënave nga organet ligjzbatuese, nga ku ka rezultuar një informacion konfidencial për të cilin nuk ka pasur të dhëna/zhvillime të mëtejshme; (ii) u verifikuan informacionet konfidenciale pranë këtyre organeve dhe në vijim, u administruan dosjet përkatëse për çdo informacion që kishte lidhje ose ishte përmendur emri i subjektit të rivlerësimit (trajtuar te aftësitë profesionale); (iii) SPAK-u ka informuar se nuk rezulton që në emër të subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho të jetë regjistruar ndonjë procedim penal, dhe se, ndaj prokurorit Kledian Llaho është regjistruar kallëzimi nr. ***, për të cilin pas verifikimeve është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 10.5.2018; (iv) nga verifikimi në sistemin TIMS, u evidentuan udhëtimet e subjektit dhe bashkëshortes së tij, me mjetet me targa ***, ***, ***, ***, *** dhe ***. Nga verifikimi i kryer nuk rezultoi ndonjë rast konflikt interesi apo përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar të personave me të cilët subjekti ka udhëtuar⁶⁴.

55. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të kriterit të figurës, Komisioni nuk evidentoi prova, fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit për shkak të veprimtarisë korruptive apo kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin e Grupit të Punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nga analizimi në mënyrë të plotë e të detajuar të dosjeve penale të administruara, trajtuar në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, pasi shqyrtoi parashtrimet e subjektit dhe dokumentet shkresore të paraqitura, Komisioni nuk evidentoi elemente, veprime a mosveprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat do të cenonin etikën dhe besimin e tij në publik sipas nenit 61 pika 5 e ligjit 84/2016 në kuadër të vlerësimit të figurës, dhe jo vetëm (trajtuar dhe arsyetuar hollësisht në paragrafin 89 e në vijim).

Vlerësimi i aftësive profesionale

56. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho, bazuar në: (i) raportin nr. *** prot., datë 14.11.2022, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti për analizën e aftësive profesionale nga KLP-ja

57. Analiza e kryer nga KLP-ja, në vlerësimin e aftësive profesionale, është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti

⁶⁴Shihni shkresat nr. *** prot., datë 29.3.2022, nr. *** prot., datë 15.11.2022 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2022, nr. *** prot., datë 10.11.2022, të SPAK-ut.

i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore. Në përfundim, KLP-ja, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar pozitivisht subjektin e rivlerësimit, si vijon:

58. Aftësitë profesionale

58.1. Njohuritë ligjore

Prokurori Kledian Llaho shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit, përdor arsytim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret hetimi. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale. Ai shfaq njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të akteve që normojnë fushën e ndërtimit, institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, detyrave përkatëse të çdo punonjësi të këtyre institucioneve. Ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë, menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Kledian Llaho, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit ai është vlerësuar “shumë mirë”.

58.2. Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho shfaq aftësi në arsyetim ligjor, organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar, bën analizë të normave të ligjeve përkatëse, siç janë ligjet në fushën e ndërtimit, në fushën e lojërave të fatit dhe Kodit Penal dhe Procedurës Penale. Nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit, analizë e zgjeruar e provave të mbledhura, provave të paraqitura nga mbrojtja, si edhe kërkesave dhe pretendimeve të mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

59. Aftësitë organizative

59.1. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës prokurori ka trajtuar 312 çështje. Rezulton se nga ana e prokurorit Kledian Llaho tregohet vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Konkretisht: dosja 1, kohëzgjatja 8 ditë; dosja 2, kohëzgjatja 9 muaj dhe 29 ditë. Nga shqyrtimi i fashikullit rezulton se regjistrimi i procedimit është bërë nga prokurori K. Z. në datën 11.6.2014. Në datën 3.7.2014 ka një vendim për zëvendësimin e prokurorit K. Z., i cili është emëruar prokuror në Prokurorinë e Apelit Vlorë me prokurorin Kledian Llaho. Në dosje gjenden edhe zgjatje të afatit të hetimit datë 11.9.2014 - 11.12.2014, 11.12.2014 - 11.3.2014 dhe 11.3.2015 - 11.6.2015; dosja 3, kohëzgjatja 4 muaj 7 ditë. Subjekti Kledian Llaho ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës.

59.2. Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Prokurori Kledian Llaho kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve, konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Gjithashtu, qëndrimi i

prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

59.3. Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

60. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

60.1. Etika në punë

Rezulton se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

60.2 Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

60.3. Paanësia

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Kledian Llaho. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

61. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

61.1. Aftësitë e komunikimit

Komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

61.2. Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Kledian Llaho për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

61.3. Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Kledian Llaho rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës. Konkretisht, rezulton të ketë marrë pjesë në 10 aktivitete profesionale.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

62. Nga Komisioni janë shqyrtuar tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj.

63. Sa i takon informacionit nga burimet arkivore, sipas të dhënave në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, rezulton që ndaj prokurorit Kledian Llaho nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Gjithashtu, u gjetën

vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm që i përkasin punës së tij për vitet 2014, 2015 dhe 2016, vlerësuar “shumë mirë”. Pas shqyrtimit të të dhënave arkivore të vëna në dispozicion nga KLP-ja, nga ana e Komisionit u kryen verifikime të mëtejshme në rastet si vijojnë:

Në lidhje me një informacion të televizionit “T.-Ch.”

64. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, bazuar mbi disa pamje filmike të transmetuara në datën 2.9.2019, në emisionin investigativ “****” të televizionit “T.-Ch.”, në datën 3.9.2019 ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprat penale të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal. Në pamjet filmike është intervistuar personi me emrin K. A., i cili ka pretenduar se ka paguar një shumë monetare te avokati V. S., me qëllim për të mos u arrestuar dhe për t’u pushuar hetimet për një procedim penal të regjistruar për veprën penale “vjedhje”, e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Nga hetimet e deritanishme rezulton se rasti që përmend shtetasi K. A. lidhet me procedimin penal nr. ***, viti 2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, regjistruar për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Ky procedim penal është pezulluar në datën 12.4.2019. Për kryerjen e hetimeve lidhur me këtë procedim penal ka qenë i ngarkuar prokurori Kledian Llaho. Hetimet paraprake lidhur me këtë procedim penal ende nuk kanë përfunduar. Me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë informohet se procedimi penal nr. *** i vitit 2019 është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

65. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me procedimin penal nr. *** dhe veprimet hetimore të kryera prej tij, duke paraqitur dosjen penale. Në parashtrimet e tij, subjekti ka dhënë sqarime bazuar në dokumente shkresore, në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- Procedimi penal nr. ***, viti 2018, i Prokurorisë së Rrethit Vlorë, është regjistruar për veprën penale “vjedhje” e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 22 të Kodit Penal, mbi referimin e OPGJ-së. Fakti penal është referuar nga Komisariati i Policisë Himarë dhe nuk paraqiste ndonjë problematikë serioze. E vetmja situatë e diskutueshme ka qenë veprimi hetimor “njohja e personit”, i kryer në shkelje të dispozitave procedurale penale. Pas kryerjes së veprimeve të mundshme hetimore, kryesisht pyetje shtetasve që mund të kishin dijeni për rrethanat e hetimit, çështja është pezulluar dhe dosja hetimore i është dërguar për vijimin e veprimeve Komisarariatit të Policisë Himarë.

- Në lidhje me vendimin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar datë 14.9.2022, “Për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve”, subjekti ka sqaruar se prokurori i çështjes është shprehur se fakti për të cilin është hetuar, ka dyshime se përmbush elementët e veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe jo për veprën penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit”, të parashikuar nga neni 319 dhe/ose neni 319/ç të Kodit Penal.

Bashkëlidhur parashtrimeve për këtë çështje, subjekti ka paraqitur: shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; kopje të akteve të procedimit penal nr. ***; kopje të vendimit datë 14.9.2022, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në kuadër të procedimit penal nr. ***.

66. Në analizë të deklarimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, rezulton se: Së pari, nga analizimi i akteve të procedimit penal nr. ***, vërehet se:

- Në datën 6.9.2018, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “vjedhje” e kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, pa emër autori, duke ngarkuar OPGJ-në për hetimin e këtij procedimi. Sipas procesverbalit të njohjes datë 23.8.2010, shtetasi M. Sh. ka njohur si person shtetasin K. A. Ky procesverbal është refuzuar të firmoset nga personi që njihet dhe është firmosur nga av. G. Y. Në datat 15.10.2018, 26.10.2018 dhe 7.3.2019 subjekti ka mbajtur proceverbale për marrjen e të dhënave nga personat që tregojnë rrethana të hetimit. Më 12.4.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pezullimin e procedimit penal nr. ***, duke arsyetuar mbi provat e administruara, deklaratimet e personave, faktin që veprimi hetimor i njohjes është zhvilluar në kundërshtim me nenet 172/1 dhe 171/4 të Kodit të Procedurës Penale. Në funksion të këtij procedimi, subjekti ka vlerësuar se nuk ka vend për të kryer ndonjë veprim tjetër hetimor me qëllim individualizimin e autorit të veprës penale dhe rasti duhet të ndiqet me të dhëna operative nga OPGJ-të e Komisarariatit. Me shkresën e datës 26.4.2019 i është dërguar për njohje vendimi i pezullimit shtetasit M. Sh.

Së dyti, nga shqyrtimi i vendimit 14.9.2022 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, vërehet se në lidhje me faktin e denoncuar në “***” është regjistruar çështja kryesisht dhe janë kryer hetime, ku rezulton të jetë administruar fashikulli penal nr. ***, si dhe është pyetur subjekti i rivlerësimit. Në këtë vendim është konkluduar se *pamjet filmike janë të pamjaftueshme për të ngritur akuzën penale; krijohen dyshime se avokatët kanë gënjyer shtetasin K. A.; nuk rezulton ndonjë akt që avokati të jetë zgjedhur si avokat mbrojtës i tij; avokati nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për marrje provash, siç pretendohet në bisedën e regjistruar.*

67. Nga gjithë sa më sipër, në përfundim të procesit çmohet se sqarimet e subjektit janë të qarta, të plota dhe argumentuese, pasi, sa i takon trajtimit të procedimit penal nr. ***, nuk konstatohet ndonjë problematikë në veprimet hetimore të kryera nga subjekti, i cili ka vepruar në ushtrim të funksioneve të tij sipas nenit 24/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3/2 të ligjit nr. 96/2016. Ndërkohë që, sa i takon pretendimit për korrupsion, një pretendim i tillë i është nënshtruar hetimit penal dhe nuk rezulton i provuar.

Në lidhje me ankesën e shtetasit N. Xh.

68. Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme është administruar ankim nga shtetasi N.Xh., depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme, me nr. ***, datë 20.2.2018, i cili në kërkesën e tij kërkon nga Prokurori i Përgjithshëm hetim penal për disa persona, institucione e funksionarë publikë të përfshirë në konfliktin e tij të pronësisë në Vlorë. Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme kjo kërkesë i është dërguar për ndjekje Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, subjektit i është kërkuar të japë sqarime për vijimësinë e trajtimit të kësaj çështjeje nga Prokuroria e Rrethit Vlorë.

69. Në parashtrimet e tij subjekti deklaroi se kjo çështje është trajtuar prej tij dhe se nga ana e tij janë kryer të gjitha veprimet hetimore. Në lidhje me vijimësinë, subjekti paraqiti shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas së cilës çështja ndodhet në gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Po kështu, subjekti ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me trajtimin e kësaj çështjeje penale që nga momenti i regjistrimit të kallëzimit penal të denoncuesit, si dhe ka

paraqitur dy vendime gjykatash⁶⁵. Nga deklaratimet e subjektit dhe përmbajtja e këtyre dy vendimeve, rezulton se:

- Fillimisht subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me vendim të datës 7.2.2018, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- Pas ankimit në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë me vendimin nr. ***, datë 16.4.2018, vendosi shfuqizimin e vendimit të mosfillimit datë 7.2.2018, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve.

- Në vijim, subjekti ka kryer veprimet hetimore dhe çështja ka kaluar në datën 12.6.2020 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë për shqyrtimin e kërkesës për pushim.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, datë 15.7.2020, ka vendosur pushimin e çështjes sipas kërkesës së prokurorit dhe se kjo çështje ndodhet në shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Në vendimin nr. ***, datë 15.7.2020, gjykata, ndër të tjera, është shprehur se: *“Organi i akuzës ka kryer në mënyrë tërësore veprimet hetimore të orientuara nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 4.7.2018. Personat përgjegjës për regjistrimin e pronësisë së shtetasit Dh. Sh. janë deklaruar fajtorë. Kallëzuesi është orientuar në mënyrë të gabuar në zgjidhjen e pretendimeve të pronësisë dhe se nga hetimet nuk është konkluduar në ekzistencën e elementeve të veprës penale për të cilën dyshohet”*.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk evidentoi shkelje e mangësi që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me ankesën e shtetasës Th. Ç.

70. Në kërkesën e saj nr. ***, datë 13.4.2018, shtetasja Th. Ç., midis të tjerash, kërkon zëvendësimin e prokurorit Kledian Llaho nga hetimi i procedimit penal nr. ***, pasi mendon se ka shkaqe serioze që të bëjnë të dyshosh për paanshmërinë e tij në hetimin e këtij procedimi penal dhe në marrjen e vendimit. Po e njëjta shtetase ankohet për zvaritje të hetimeve. Por, nga verifikimi i akteve të përcjella me raportin profesional të KLP-së, rezulton se çështja penale me kallëzuese këtë shtetase i takon procedimit penal nr. ***, për të cilin është vendosur pushimi nga prokurori F. Ç. dhe jo nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, nga aktet rezulton se ankuesja Th. Ç. ka paraqitur kërkesë drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për dijeni dhe Prokurorit të Përgjithshëm, për zëvendësimin e prokurorit Kledian Llaho, në hetimin e procedimit penal nr. ***.

71. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti i është kërkuar të japë sqarime e dokumente se çfarë është vendosur në lidhje me kërkesën për zëvendësimin e tij në procedimin nr. ***. Në parashtrimet e tij subjekti parashtron se kërkesa është bërë në kushtet e një perceptimi subjektiv të shtetasës Th. Ç., të pabazuar në prova dhe në ligj dhe, për këtë shkak, është rrëzuar nga Drejtuesi i Prokurorisë. Në mbështetje të këtij pretendimi paraqiti kopje të kërkesës së shtetasës Th. Ç., në datën 10.4.2018, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë, si dhe kopje të vendimit “Për mospranimin e kërkesës për zëvendësim prokurori”, të datës 10.4.2018, drejtuar shtetasës Th. Ç. me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 16.4.2018. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se pretendimet e shtetasës Th. Ç. janë gjetur të pabazuara.

⁶⁵Shihni vendimin nr. ***, datë 15.7.2020 dhe vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

Denoncimet e publikut

72. Në adresë të subjektit janë paraqitur nëntë denoncime të paraqitura nga publiku (në dy raste të njëjtët denoncues kanë paraqitur më shumë se një denoncim), në katër prej të cilave nuk referoheshin shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit ose ngriheshin pretendime mbi vendimmarrje të padrejtë të subjektit, vlerësimi i të cilave në zbatim të pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, është jashtë tagrit të vlerësimit nga Komisioni. Për të tjerat janë kryer verifikimet si vijojnë:

Në lidhje me denoncimet e shtetasit G. T. ⁶⁶

73. Në tri denoncimet e tij, ky shtetas, i cili denoncon disa gjyqtarë dhe prokurorë, për subjektin Llaho ngre pretendim për fillim të paligjshëm të ndjekjes penale, shpërdorim detyre, fyerje dhe kanosje ndaj tij, si dhe korrupsion, zvarritje të procesit, në lidhje me procedimet penale nr. *** dhe nr. **. Me qëllim verifikimin e pretendimeve të ngritura për subjektin Llaho, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁷ vuri në dispozicion dosjen e procedimit penal nr. ** (gjithashtu është kërkuar edhe dosja e procedimit penal nr. **, e cila është trajtuar në vijim gjatë shqyrtimit të denoncuesit E. Y.), nga shqyrtimi i akteve të së cilës rezultoi se:

74. Nga data e regjistrimit të procedimit penal 2.2.2016 deri më 8.6.2017 të dërgimit të çështjes për gjykim, çështja ka zgjatur 1 vit e 4 muaj, ndërsa nga data e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale datë 10.1.2017, çështja ka zgjatur pothuajse 5 muaj. Afatet e hetimeve janë zgjatur dy herë me nga 1 muaj, me qëllim njoftimin e akuzës të pandehurit dhe njohjen e akteve, pasi:

- Me shkresa të datave 3.3.2017, 7.3.2017 dhe 10.3.2017, janë dërguar ftesat për paraqitje shtetasit G. T. dhe Komisarariatit të Policisë Fier.

- Në datën 7.4.2017 prokurori Kledian Llaho ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor me 1 muaj, për shkak se avokati nuk është paraqitur duke argumentuar shkaqet e shtyrjes. Në datën 10.4.2017 i ka dërguar njoftim vendimi për zgjatjen e afatit datë 7.4.2017 shtetasit G. T. dhe av. A. H..

- Në datën 2.5.2017 ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal për shtetasin G. T. “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, me arsyetimin se i është fshehur Prokurorisë dhe nuk pranon të vihet në dispozicion të hetimeve, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata me vendimin nr. **, datë 4.5.2017, lënë në fuqi me vendimin nr. **, datë 8.6.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

- Në datën 10.5.2017 ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor me një muaj, duke argumentuar shkaqet e shtyrjes.

- Në datën 16.5.2017 ka bërë kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal të shtetasit G. T., duke i caktuar masën “arrest me burg”, me arsyetimin se nuk është paraqitur në organin procedues sipas urdhrit të gjykatës, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. **, datë 19.5.2017, i ndryshuar më pas me vendimin nr. **, datë 21.6.2017, të Gjykatës së Apelit, e cila ka rrëzuar

⁶⁶Shihni denoncimin nr. ** prot., datë 20.3.2018 dhe nr. ** prot., datë 20.10.2020 dhe nr. ** prot., datë 31.3.2022 në dosjen e Komisionit.

⁶⁷Shihni shkresën nr. ** prot., datë 15.4.2022, në dosjen e Komisionit.

kërkesën e Prokurorisë për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe lirimin e menjëhershëm të shtetasit G. T.

- Në datën 8.6.2017 i është dërguar shtetasit G. T. në adresën IEVP Vlorë, kërkesa datë 6.6.2017, e prokurorit Kledian Llaho, për gjykimin e procedimit penal nr. ***.

- Në dosjen penale nuk ndodhet vendimi i gjykatës për shpalljen fajtor të të pandehurit. Në formularin e përfundimit të çështjes, rezulton i pasqyruar vendimi i gjykatës i datës 4.4.2018, i cili ka shpallur fajtor dhe dënuar me 5 vjet burgim të pandehurin G. T., i cili nuk është ankimuar nga Prokuroria.

75. Nga kërkimi në sistemin e Gjykatës së Lartë u gjend vendimi nr. ***, datë 2.12.2021, për mospranim rekursi të shtetasit G. T., në lidhje me procedimin penal nr. ***. Sipas këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 4.4.2018, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit G. T. për kryerjen e veprës penale “vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim, i cili është ankimuar nga shtetasi G.T. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 21.1.2021, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 4.4.2018, dhe dërgimin e akteve në gjykatën kompetente, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Në arsyetimin e vendimit nr. ***, datë 2.12.2021, të Gjykatës së Lartë, kjo gjykatë ka arsyetuar se *i pandehuri G. T. ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në seancën e datës 28.9.2017, shpalljen e moskompetencës tokësore për gjykimin e procedimit penal me nr. ***, të vitit 2016 në ngarkim të tij dhe dërgimin e fashikullit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kërkesë e cila nuk është pranuar prej asaj gjykate. Këtë kërkesë i pandehuri G. T. e ka ripërsëritur në ankimin e tij të depozituar pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykata e Apelit Vlorë, në përputhje me nenin 83/2 të Kodit të Procedurës Penale, është shprehur se kërkesa është bërë në momentin e duhur procedural dhe se, në lidhje me rrethanat e faktit penal, kompetente nga pikëpamja tokësore është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.*

76. Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza e akteve të administruara rezultoi se:

- Sa i takon pretendimit për fillim të paligjshëm të ndjekjes penale për shkak të moskompetencës së Prokurorisë së Rrethit Vlorë, pretendim i cili është ngritur nga i pandehuri vetëm kur çështja ka shkuar në gjykatë, rezultoi se çështja e kompetencës tokësore është bërë objekt gjykimi në tri shkallët e gjyqësorit.

- Sa i takon pretendimit për zvarritje hetimesh, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimeve dy herë me nga një muaj, për shkaqe të justifikuara dhe të argumentuara. Ndërkohë, është e vërtetë që nga data e regjistrimit të procedimit penal 2.2.2016 deri më 8.6.2017, të dërgimit të çështjes për gjykim, çështja ka zgjatur 1 vit e 4 muaj, ndërsa nga data e regjistrimit të emrit të personit, që i atribuohet vepra penale datë 10.1.2017, çështja ka zgjatur pothuajse 5 muaj. Por, këto afate janë justifikuar me një numër të konsiderueshëm veprimesh hetimore nga ana e subjektit.

Sa më sipër, konstatohet se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë. Në lidhje me vendimmarrjen nga ana e prokurorit, në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, verifikimet dalin jashtë tagrit të Komisionit.

Në lidhje me denoncimin e shtetasit E. Y. etj.⁶⁸

77. Denoncuesit pretendojnë se prokurori Kledian Llaho nuk ka marrë masa ndaj shtetasit M. M., duke çuar çështjen në gjykim vetëm për shtetasin V. M. në bazë të nenit 134, paragrafi i parë i Kodit Penal dhe jo me paragrafin e tretë. Bashkëngjitur denoncimit kanë paraqitur disa vendime gjyqësore. Me qëllim verifikimin e pretendimeve, me kërkesë të Komisionit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁹ vuri në dispozicion dosjen e procedimit penal nr. *** dhe nga shqyrtimi i akteve rezultoi se:

- Sindikata e Pavarur e Transportit të Shqipërisë ka paraqitur kallëzimin nr. ***, ndaj shtetasve M. M. etj., akuzuar për “falsifikim të dokumenteve” dhe “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”. Pasi janë kryer disa veprime, prokurori Kledian Llaho ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Në vijim, janë paraqitur kallëzime nga S. P. P. N. në Shqipëri, Sindikata e Pavarur e Q.P.N K*** dhe F. N. P., të cilat i janë bashkuar procedimit penal nr. ***.

- Me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2017, është dërguar kërkesa në gjykatë për pushimin e çështjes penale nr. ***, duke arsyetuar, ndër të tjera, se pretendimi i falsifikimit të dokumenteve nuk mund të provohet, pretendimet e shtetasve në strukturat e ndryshme të sindikatave nuk duhet t'i drejtohen Prokurorisë në lidhje me mënyrën se si administrohen të ardhurat financiare.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 5.2.2018, ka vendosur kthimin e akteve dhe urdhërimin e Prokurorisë të formulojë akuzë në ngarkim të shtetasve M. M. dhe V. M., për veprën penale “vjedhje” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, duke arsyetuar se ka prova të mjaftueshme për të formuluar akuzën e “vjedhjes” kryer në bashkëpunim. Ky vendim është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 6.6.2018, e ka ndryshuar vendimin nr. ***, datë 5.2.2018, duke vendosur pushimin e çështjes nr. ***.

- Në datën 19.10.2018, Drejtuesi i Prokurorisë i ka kaluar subjektit për shqyrtim kallëzimin penal nr. *** të shtetasve V. F. etj., ndaj shtetasve M. M., V. M. etj. Në vijim, prokurori Kledian Llaho ka kërkuar: (i) revokimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr. ***, me arsyetimin se me vendimin nr. ***, datë 26.7.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, janë deklaruar fajtorë shtetasit M. M., V. M. etj., për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, kërkesë e cila është pranuar me vendimin nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit V. M. për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe e ka bashkuar në një procedim të vetëm me atë nr. ***; (iii) ka kërkuar dërgimin në gjykatë të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit V. M..

- Me vendimin nr. ***, datë 27.3.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: (i) kthimin e akteve dhe urdhërimin e prokurorisë të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale lidhur me të pandehurin V. M., duke e akuzuar për veprën penale “vjedhje” me pasoja të rënda në bashkëpunim parashikuar nga nenet 134/2 dhe 25 të Kodit Penal; (ii) të formulojë akuzë në ngarkim të shtetasit M. M. për veprën penale “vjedhje” me pasoja të rënda në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 25 të Kodit Penal. Në arsyetimin e saj, gjykata, ndër të tjera, është shprehur se: “Rezulton e

⁶⁸Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 16.10.2019, në dosjen e Komisionit.

⁶⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

*provuar se shtetasi M. M. ka bashkëpunuar me shtetasin V. M. për marrjen e detyrës nga ky i fundit me qëllimin e përbashkët dhe të vetëm, shtënien në dorë të të ardhurave...”; (iii) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim subjekti dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 11.6.2019, ka vendosur mospranimin e ankimit.*

- Pas administrimit të vendimit nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të formës së prerë, prokurori ka vijuar duke: (i) regjistruar emrin e shtetasit M. M. për veprën penale “vjedhje” me pasoja të rënda, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 134/3 të Kodit Penal; (ii) marrë të pandehur shtetasit V. M. dhe M. M., për veprën penale “vjedhje” të kryer në bashkëpunim, me pasoja të rënda parashikuar nga nenet 134/2 dhe 134/3 të Kodit Penal; (iii) dërguar në gjykatë kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit nr. *** në ngarkim të tyre.

78. Ndërkohë që çështja ka qenë në gjykim, më 15.6.2021 prokurori Kledian Llaho i ka paraqitur Drejtuesit të Prokurorisë deklaratë për heqje dorë nga përfaqësimi në gjykim i çështjes, për shkak se nga palët në proces janë ngritur pretendime se ka zvarritur çështjen dhe ka ushtruar në mënyrë të padrejtë ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 27.3.2019, si dhe nuk ka marrë asnjë masë sigurie ndaj të pandehurve. Me vendimin datë 16.6.2021, Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur mospranimin e heqjes dorë të prokurorit Kledian Llaho, duke argumentuar se prokurori ka vepruar në respektim të ligjit material dhe procedural, ka disponuar me vendimet përkatëse në vlerësimin e tij profesional, të cilat janë objekt kontrolli vetëm nga Gjykata dhe, sipas rastit, nga ILD-ja dhe KLP-ja.

79. Në përfundim të hetimit administrativ, nga shqyrtimi i akteve të mësipërme, duket se: (i) nga data e regjistrimit të kallëzimit penal 26.5.2015 deri në datën e regjistrimit të procedimit penal më 9.9.2015, ka kaluar një kohë prej 3 muajsh e gjysmë, pra është tejkaluar afati 30-ditor sipas udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar; (ii) sipas vendimit të formës së prerë nr. ***, datë 27.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesa e subjektit datë 18.2.2019 për dërgimin e çështjes në gjykim vetëm me një të akuzuar V. M., ka pasur mangësi në hetime dhe ngritjen e akuzës. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti të japë sqarime mbështetur në dokumente shpresore për këto konstatime.

80. Në parashtrimet e tij, subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 1.7.2021, sipas të cilit është vendosur dërgimi i çështjes për gjykim me të pandehurit V. M. dhe M. M., si dhe shkresën e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas të cilave çështja është në gjykim pranë kësaj gjykate. Gjithashtu, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me konstatimet e Komisionit, duke deklaruar se:

80.1. Sa i takon tejkalimit të afatit 30-ditor, subjekti pretendon se kjo ka ardhur për shkak dhe të moshës së thyer të noteres në administrimin e dokumenteve objekt verifikimi, si dhe paraqitjes me vonesë dhe marrjes së deklarimeve nga kallëzuesi E.Y., i cili është intervistuar nga OPGJ-ja në datën 8.9.2015. Me administrimin e të dhënave të mjaftueshme, ditën e nesërme, në datën 9.9.2015, ka regjistruar procedimin. Sipas subjektit, vonesa nuk ka prodhuar ndonjë efekt negativ në hetimin e çështjes. Subjekti ka sjellë në vëmendje vendimin nr. ***, datë 3.11.2021, të Kolegjit, për një rast të ngjashëm, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk ngarkohet me përgjegjësi në kuptimin e shkeljes disiplinore, edhe pse ka regjistruar procedimin penal tej afatit 30-ditor.

Në përfundim të procesit, nga ana e Komisionit vlerësohet se, edhe pse subjekti është përpjekur dhe ka mundur të justifikojë tejkalimin e afatit 30-ditor me argumente të bazuara, ai duhet të ishte treguar me i kujdesshëm në respektimin e këtij afati që, sipas

udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, prokurori duhet të kryejë një minimum verifikimesh. Sa i takon qëndrimin të Kolegjit referuar nga subjekti, sipas të cilit ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi në kuptimin e shkëlqes disiplinore edhe pse ka regjistruar procedimin penal tej afatit 30-ditor, vërehet se në rastin e trajtuar nga Kolegji, regjistrimi i procedimit është bërë 1 muaj e 25 ditë pas regjistrimit të kallëzimit dhe, në këtë rast, Kolegji⁷⁰ është shprehur në lidhje me vendimin e pushimit të procedimit penal, jo mbi tejkalimin e këtij afati.

80.2. Në lidhje me konstatimin se sipas vendimit të formës së prerë nr. ***, datë 27.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkesa e subjektit datë 18.2.2019 për dërgimin e çështjes në gjykim vetëm me një të akuzuar V. M., ka pasur mangësi në hetime dhe ngritjen e akuzës, subjekti pretendon se hetimi ka qenë shterues dhe objektiv, se ai ka vlerësuar marrjen të pandehur vetëm të një personi dhe se vendimi i Gjykatës ka të bëjë me interpretim të ndryshëm të faktit penal. Ai pretendon se nuk rezulton që gjyqtarja të jetë shprehur se ka pasur mangësi në hetime, por ajo ka kryer thjesht një vlerësim të ndryshëm të rrethanave të faktit dhe provave të administruara gjatë fazës së hetimit paraprak. Subjekti i referohet vendimit nr. ***, datë 11.6.2019, të Gjykatës së Apelit, ku gjykata është shprehur: *“Përderisa dispozita nuk lejon në mënyrë të shprehur ankim ndaj vendimit të gjykatës për kthimin e akteve prokurorit me qëllim që ky i fundit të formulojë akuzë të re apo të formulojë qartë dhe saktë akuzën, Gjykata e Apelit Vlorë nuk mund ta marrë në shqyrtim vendimin nr. ***, datë 27.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe as ankimin kundër këtij vendimi dhe në kushte të tilla konkludon të vendosë mospranimin e ankimit”*.

Në vlerësim të pretendimeve të subjektit, Komisioni çmoi se, pavarësisht se gjykata në vendimin nr. ***, datë 27.3.2019, është shprehur që organi i akuzës duhet të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale, si dhe të formulojë akuzë për shtetasin M. M., detyrë që subjekti e ka zbatuar pasi çështja është kthyer për hetim, gjykata nuk ka evidentuar mangësi në hetime nga ana e subjektit dhe as nuk ka lënë për detyrë kryerjen e veprimeve hetimore të tjera, duke kryer kështu një vlerësim të ndryshëm të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga të gjitha veprimet hetimore të kryera nga subjekti. Për këtë arsye, pretendimet e subjektit janë gjendur të bazuara, për më tepër, u vërtetua që ai në cilësinë e prokurorit të çështjes ka vepruar hap pas hapi duke kryer hetime, duke marrë vendime e ushtruar ankime, bazuar në faktet, provat dhe bindjen e brendshme, në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur, sipas parashikimeve të neneve 24/1 dhe 25/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3/2 të ligjit nr. 96/2016.

Subjekti referon një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sipas tij, ka qëndrim të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në një rast të ngjashëm, por nuk ka paraqitur një vendim gjykate. Ky rast i referuar nga subjekti nuk mund të merret në konsideratë, për sa kohë Komisioni nuk është në dijeni të fakteve e rrethanave specifike mbi të cilat ka vendosur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

80.3. Veç sa më sipër, subjekti sjell në vëmendje vendimin nr. ***, datë 3.11.2021, të Kolegjit, që për një situatë të ngjashme ka mbajtur qëndrimin, sipas të cilit kërkesa për pushimin e çështjes penale ka qenë në shqyrtim gjyqësor në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, për pasojë ky i fundit ndodhej në kushtet e pengesës

⁷⁰Shihni vendimin nr. 33, datë 3.11.2021, të Kolegjit, pika 68: *“Mungesa e arsytimit në vendimin e pushimit të procedimit penal, në lidhje me “shpejtësinë e marrjes së tij”, apo edhe nxjerrja e vendimit për regjistrimin e procedimit penal në kufijtë e një akti formal në mungesë të ndërmarjes së veprimeve hetimore, të cilat në fakt kanë qenë të panevojshme, nuk mund të konsiderohet si një shkëlqje që duhet të mbahet në konsideratë në kuptim të nenit 73, të ligjit nr. 84/2016, pasi në rastin konkret, trupi gjykues çmon se qartësia dhe kuptueshmëria e aktit të prokurorit nuk është cenuar”*.

ligjore për vlerësimin e subjektit, të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim. Siç vërehet, subjekti pretendon se Komisioni ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e çështjes objekt verifikimi. Nga ana e Komisionit vlerësohet se ky pretendim nuk qëndron, pasi, sipas vendimit nr. ***, datë 1.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur pranimi i kërkesës për dërgimin në gjyq të çështjes penale dhe, për më tepër, të pandehurit kanë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar. Nisur edhe nga praktika e Kolegjit⁷¹, konstatimet e Komisionit për subjektin në rastin konkret kanë të bëjnë me momente procedurale të zgjidhura në mënyrë përfundimtare, dhe për rrjedhojë, Komisioni nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për të verifikuar pretendimet e ngritura nga denoncuesit.

81. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni në analizë të të gjitha veprimeve të kryera nga subjekti, vëren se ai ka përmbushur detyrat e tij si prokuror, dhe se, si regjistrimi i çështjes tej afatit 30-ditor, ashtu edhe ngritja e akuzës dhe vlerësimi fillimisht për marrjen të pandehur vetëm të një personi, nuk kanë qenë me qëllim zvarritjen e hetimeve dhe as favorizimin e ndonjë të pandehuri, por kanë ardhur natyrshëm për shkak dhe bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë kryerjes së një numri të konsiderueshëm veprimesh hetimore, si dhe vlerësimit të tyre sipas bindjes së tij të brendshme. Mungesa e vullnetit për zvarritje hetimesh apo favorizimin e palëve

⁷¹ i) Shihni vendimin e Kolegjit, nr. 28/2020, prg. 14.7: “Kolegji gjithashtu çmon të padrejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo çështje, duke qenë se gjendet e rekursuar në Gjykatën e Lartë, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi e analizimi nga organet e rivlerësimit. Në një qëndrim të konsoliduar tashmë²³, Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: ‘[...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve, të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë. Në këto rrethana, çështja gjyqësore e analizuar ka përfunduar shqyrtimin e saj prej subjektit të rivlerësimit, i cili është shprehur me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e saj, dhe qenia e saj e varur para Gjykatës së Lartë, në prirje të një gjykimi atje, nuk e bën këtë çështje ‘nën shqyrtim’, në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, për pasojë Komisioni ka qenë i legjitimuar të analizojë e vlerësojë edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit”.

ii) Shihni vendimin e Kolegjit nr. 7/2019, prg. 47: “... trupi gjykues çmon se denoncimi i bërë nga shtetasi A. Ll., në emër të denoncuesit M. M., për sa u përket veprimeve dhe mosveprimeve procedurale të subjektit të rivlerësimit, nuk duhet konsideruar si një çështje në shqyrtim, pasi çështja konkrete që ka vlerësuar Komisioni lidhet vetëm me vendimmarrjen për fillimin ose jo të procedimit penal. Në kohën që Komisioni ka bërë rivlerësimin e subjektit E. S., ky moment procedural rezulton të ketë qenë i zgjidhur në mënyrë përfundimtare, sipas vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Korçë, si më sipërcituar, dhe për këtë arsye, Komisioni, sa i takon vlerësimit mbi fillimin ose jo të procedimit penal, nuk ishte në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar në ligj dhe në prova këtë shkak ankimi”.

iii) Shihni vendimin e Kolegjit nr. 16/2020, prg. 22.8: “Lidhur me parashtrimin e subjektit se kjo çështje është trajtuar nga Komisioni në kundërshtim me përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, i cili në pikën 2 të tij shprehet: “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”, në vlerësimin e Kolegjit, ky parashikim nuk lidhet me statusin në tërësi të çështjes, por me ato çështje të cilat janë në proces shqyrtimi nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit dhe çështja në fjalë nuk është në këtë status, pasi subjekti ka dhënë për të një vendim përfundimtar dhe, në kuptim të dispozitave procedurale, do të kishte ndalesë të rigjykonte këtë çështje, edhe në rast se Gjykata e Lartë do të dispononte për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Në këtë mënyrë, asnjë vlerësim që organet e rivlerësimit bëjnë në këto raste, nuk afekton vendimmarrjen për këtë çështje, për më tepër që vlerësimi në çdo rast u referohet treguesve të kriterit të aftësive profesionale, pa marrë përsipër të gjykohe mbi korrektësinë e vendimmarrjes”.

në proces ka gjetur pasqyrim edhe te kërkesa e tij e datës 15.6.2021 për heqje dorë nga përfaqësimi në gjykim i çështjes, e cila është rrëzuar me vendim të arsyetuar në datën 16.6.2021 të Drejtuesit të prokurorisë, i cili jo vetëm nuk ka gjetur shkelje të subjektit të rivlerësimit, por ka evidentuar se ka vepruar sipas ligjit procedural e material. Për më tepër, subjekti ka qenë konsistent në qëndrimin e tij duke mos qenë dakord me vlerësimin e gjykatës për faktin penal, qëndrim të cilin e ka mbajtur Edhe në ankimin ndaj vendimit të gjykatës.

Në konkluzion, Komisioni çmon se nuk ka elemente që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në trajtimin e çështjes objekt verifikimi.

Në lidhje me denoncimin e shtetasit V. R.⁷²

82. Denoncuesi ngre pretendimin në lidhje me vendimmarrjen e prokurorit për pushimin e çështjes penale nr. *** dhe vlerësimin e provave, në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, pretendime të cilat dalin jashtë tagrit të Komisionit. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se ka zvarritje të procesit. Me qëllim evidentimin e zvarritjeve të procesit apo shkeljeve të tjera procedurale, me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë vuri në dispozicion dosjen e procedimit penal nr. ***⁷³, nga shqyrtimi i akteve të së cilës rezultuan veprimet hetimore si vijojnë:

a. Në datën 27.9.2017, prokurori Kledian Llaho ka vendosur regjistrimin e procedimit penal të kallëzimit penal nr. ***, datë 20.9.2017, paraqitur nga shtetasi V. R. për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

b. Në datën 7.11.2017 ka vendosur caktimin e ekspertit për kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik të formularit nr. ***, “Listë e familjeve që marrin tokë në pronësi”. Sipas aktekspertimit, rezulton se formulari nr. *** ka shtesa dhe ndërhyrje nga persona që nuk kanë plotësuar formularin.

c. Në datën 4.10.2018 ka vendosur për sekuestrimin e dokumenteve pranë DAMT-it të Këshillit të Qarkut Vlorë.

ç. Në datën 7.3.2019 ka njoftuar për përfundimin e hetimeve viktimën e veprës penale V. R. dhe më 21.3.2019 është dërguar në gjykatë kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. ***.

d. Me vendimin nr. ***, datë 30.5.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur kthimin e akteve me qëllim plotësimin e hetimeve brenda 3 muajve, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: *“Duke qenë se organi i akuzës ka arritur në përfundimin se shtesat dhe ndërhyrjet në dokument janë bërë jo nga persona që kanë plotësuar formularin dhe me mjete shkruese të ndryshme, duke qenë se kallëzuesi ka dyshime se janë kryer nga shtetasi B. P., është e rëndësishme të kryhet aktekspertimi me qëllim përcaktimin nëse janë bërë nga B. P., si dhe kohën e kryerjes së tyre nëse është e mundur për efekt të parashkrimit. Të hetohet nëse ky dokument është përdorur nga B. P. dhe të pyetet nëse ka pasur dijeni për falsitetin, si dhe të hetohet se si ky dokument është përcjellë në DAMT të Qarkut Vlorë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 4.7.2019, ka vendosur lënien në fuqi”*.

dh. Pas vendimit të gjykatës, nga subjekti janë kryer disa veprime hetimore shtesë, si thirrja dhe pyetja e shtetasit V. R., thirrja dhe pyetja e shtetasit B. P., është vendosur sekuestrimi i AMTP-së, këqyrja e dokumenteve të paraqitura nga shtetasi B. P. në

⁷²Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 23.4.2019, në dosjen e Komisionit.

⁷³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.4.2022, në dosjen e Komisionit.

ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, por nuk është kryer aktekspertimi me qëllim përcaktimin nëse shtesat dhe ndërhyrjet në dokument janë bërë nga shtetasi B. P.

e. Kallëzuesi V. R. ka paraqitur memo, ku ka kërkuar kryerjen e veprimeve hetimore, si dhe informacion në lidhje me veprimet hetimore dhe të njihet me aktet e procedimit.

ë. Në datën 2.11.2020, prokurori ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, B. P. Në vijim ka vendosur marrjen e tij si të pandehur, njoftimin e akuzës për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, si dhe njoftimin e shtetasve B. P. dhe V. R. për përfundimin e hetimeve.

f. Në datën 21.1.2021 është protokolluar kërkesa nga avokati i të pandehurit, me anë të së cilës kanë kërkuar kryerjen e hetimeve shtesë që konsistojnë në kryerjen e aktekspertimit tekniko-grafik të të pandehurit B. P. Nuk rezulton të ketë vendim të prokurorit në lidhje me kërkesën e të pandehurit për kryerjen e aktekspertimit.

g. Me kërkesën e datës 25.1.2021, prokurori Kledian Llaho ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. *** në ngarkim të të pandehurit B. P. për kryerjen e veprës penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me arsyetimin se ka përdorur dokument të falsifikuar.

83. Në përfundim të hetimit administrativ, nga analizimi i akteve të dosjes penale duket se: (i) nga data 27.9.2017 e regjistrimit të procedimit penal, pa emër autori, deri në datën 21.3.2019 të dërgimit të kërkesës në gjykatë për pushimin e procedimit penal, çështja ka zgjatur pothuajse 1 vit e 6 gjashtë muaj dhe gjatë kësaj periudhe vërehen intervale kohore nga 9 muaj dhe 5 muaj pa kryer veprime hetimore; (ii) pas vendimit nr. ***, datë 3.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga ana e prokurorit nuk është kryer aktekspertimi me qëllim përcaktimin nëse ndërhyrjet janë bërë nga shtetasi B. P., veprim i cili është kërkuar edhe nga ana e të pandehurit; (iii) vendimi i formës së prerë nr. ***, datë 30.5.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka vendosur plotësimin e hetimeve brenda 3 muajve, i është komunikuar prokurorit Kledian Llaho më 15.8.2019 dhe subjekti deri në datën 9.6.2020, pra, për një periudhë rreth 10-mujore, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime për konstatimet e mësipërme, si dhe të informojë mbi përfundimin e çështjes në gjykatë, duke paraqitur edhe vendimet përkatëse.

84. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se dosja ndodhet në gjykim pranë gjyqtarës M. M., për gjykimin në themel të çështjes dhe nuk ka ende vendim përfundimtar. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjekti sqaroi se:

84.1. Sa i takon konstatimit të parë që ka lidhje me moskryerjen e hetimeve për periudhën 9 dhe 5 muaj, subjekti pretendon se kjo ka ardhur si pasojë e ngarkesës në punë. Me qëllim verifikimin e këtij pretendimi, Komisioni verifikoi tabelën e ngarkesës ndër vite, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit në vitin 2017 ka pasur gjithsej 138 çështje, në vitin 2018 gjithsej 420 çështje, në vitin 2019 gjithsej 469 çështje. Siç vërehet, në vitet 2018 dhe 2019, ai ka pasur një rritje të konsiderueshme të ngarkesës, mbi trefishin e ngarkesës së vitit 2017, e cila mund të ketë ndikuar në moskryerjen e veprimeve hetimore në intervalet 9 dhe 5 muaj. Për më tepër, sipas rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të miratuar nga KLP-ja⁷⁴, rritja e papritur e volumit të

⁷⁴Shihni vendimin nr. 95, datë 9.5.2022, të KLP-së “Për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”.

çështjeve përcaktohet si element që duhet të mbahet në konsideratë në analizën e afateve kohore të veprimeve hetimore dhe procedurale.

84.2. Sa i takon konstatimit të dytë se *pas vendimit nr. ****, datë 3.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga ana e prokurorit nuk është kryer aktekspertimi me qëllim përcaktimin nëse ndërhyrjet janë bërë nga shtetasi B. P., veprim i cili është kërkuar edhe nga ana e të pandehurit, subjekti pretendoi se vlerësimi i gjykatës është i gabuar, duke paraqitur të njëjtat argumente të parashtruara dhe në ankimin kundër vendimit nr. ***, datë 3.5.2019, të gjykatës. Pra, siç vërehet, subjekti është konsistent në qëndrimin e tij, sipas të cilit arsytimi i gjykatës i përshkruar si në paragrafin 82/d më sipër, është i gabuar, duke e argumentuar qëndrimin e tij. Në një vlerësim tërësor të situatës, Komisioni çmon se nuk ka tagër dhe as mundësi të vlerësojë një qëndrim të caktuar dhe të argumentuar të subjektit si prokuror ndaj njërit prej konstatimeve të gjykatës, bazuar në bindjen e tij të brendshme. Për më tepër, edhe pse nuk është kryer aktekspertimi me qëllim përcaktimin nëse ndërhyrjet janë bërë prej shtetasit B. P., me kërkesë të datës 25.1.2021, subjekti ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. *** në ngarkim të këtij shtetasi për kryerjen e veprës penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Pas shqyrtimit të çështjes, gjykata me vendimin nr. ***, datë 7.4.2021, të cilin subjekti e vuri në dispozicion, i ka konsideruar hetimet të plota, duke arsyetuar se nuk është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore, duke e dërguar çështjen për gjykim mbi akuzën e ngritur nga subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, nuk u evidentuan elemente që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit për shkak të moskryerjes së aktekspertimit, me qëllim përcaktimin nëse ndërhyrjet janë bërë prej shtetasit B. P., sidomos kur nga ana e gjykatës hetimet e subjektit janë konsideruar të plota për akuzën e ngritur.

84.3. Sa i takon konstatimit të tretë, në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore tej afatit tremujor të caktuar me vendimin nr. ***, datë 30.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vërehet se subjekti mungon të ketë dhënë shpjegime të qarta dhe vlerësohet se ai duhet të kishte marrë masa për ta respektuar afatin e përcaktuar nga gjykata.

84.4. Veç sa më sipër, subjekti ka parashtruar se, në zbatim të vendimeve të Gjykatës të cilat kanë pasur shprehje në kohë, ka disponuar me kërkesat përkatëse për të cilat nuk mundet të parashtrohen opinione të mëtejshme ligjore, duke qenë se shqyrtimi i saj ndodhet ende pranë gjyqtarit të themelit të çështjes. Subjekti sjell sërish në vëmendje vendimin nr. ***, datë 3.11.2021, të Kolegjit, sipas të cilit kërkesa për pushimin e çështjes penale ka qenë në shqyrtim gjyqësor në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, për pasojë, pretendon se ky i fundit ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Ky pretendim nuk qëndron, pasi në rastin konkret subjekti i ka paraqitur kërkesë gjykatës dhe gjykata e ka shqyrtuar atë duke e pranuar (arsyetuar hollësisht në paragrafin 80.3 të këtij vendimi).

84.5. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes objekt verifikimi, Komisioni vërejtë mosrespektimin e afatit tremujor sipas vendimit nr. ***, datë 30.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, se është i vetmi rast i kësaj natyre evidentuar për subjektin e rivlerësimit. Po kështu, edhe moskryerja e hetimeve për periudha të gjata kohore nuk u vërtetua të jetë një sjellje e përsëritur/metodë pune e subjektit të rivlerësimit. Duke mbajtur në konsideratë volumin e madh të punës së subjektit, si edhe opinionin e Komisionit të Venecias apo jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një

seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale⁷⁵, mangësitë e konstatuara nuk mund të cenojnë aftësitë e tij profesionale.

Informacioni i marrë gjatë hetimit të kriterit pasuror

85. Gjatë hetimit administrativ janë kryer verifikime në lidhje me shtetasin F. K., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., e cila ka qenë sipërmarrëse e ndërtimeve të pallatit ku subjekti ka banuar për një vit (trajtuar në paragrafin 40 të vendimit), në funksion të evidentimit të ndonjë konflikti të mundshëm interesi me këtë shtetas. Me kërkesë të Komisionit Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka dërguar informacion dhe dokumentacion për çështje të trajtuara nga subjekti për këtë shtetas⁷⁶, analizuar si më poshtë.

a. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes së vendimit, datë 7.11.2018, për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 15.10.2018, të prokurorit Kledian Llaho, rezulton se shtetasi F. K. ka bërë kallëzim pasi është dhunuar nga një shtetas. Sipas aktit mjekoligjor të datës 8.10.2018, të dorëzuar pranë Prokurorisë më 7.11.2018, dëmtimet në trupin e shtetasit F. K. kanë sjellë humbjen e aftësisë në punë në masën deri në 9 ditë. Në lidhje me këtë kallëzim, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90 etj., ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Për këtë grup veprash Prokuroria nuk ka kompetencë lëndore, pasi këtë të drejtë ligji ia njeh viktimës akuzuese.

b. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes për mosfillimin e procedimit nr. ***, të prokurorit Kledian Llaho, rezulton se:

- Në datën 21.7.2021 është regjistruar kallëzimi i z. F. K. mbi bazën e materialit të dërguar nga Policia e Drejtorisë Vendore Vlorë, sipas të cilit ky shtetas ka pretenduar se ndërkohë që po fliste me shtetasin A. B. , ky i fundit vuri dorën në brez duke e sharë me fjalë fyese.

- Në datën 30.7.2021 shtetasi F. K. është paraqitur në prokurori dhe ka deklaruar se nuk ka pasur kanosje nga shtetasi A. B., duke shpjeguar se ditën e kallëzimit ka qenë konfuz dhe kishte konsumuar alkool. Prokurori Kledian Llaho, në datën 30.7.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk parashikohet si vepër penale.

c. Nga aktet e procedimit penal nr. *** dhe atij me nr. *** rezulton se në të dyja këto raste, prokurori Kledian Llaho është zëvendësuar me urdhër të Drejtuesit të Prokurorisë për shkak të kërkesës së shtetasit F. K., i kallëzuar penalisht, i cili ka ngritur pretendime për mosmarrëveshje me subjektin e rivlerësimit.

Nga të dhënat si më sipër, rezulton e vërtetuar se, pasi shtetasi F. K. kishte paraqitur dy kërkesa për përjashtim të subjektit përkatësisht në vitet 2016 dhe 2017, në vitet 2018 dhe 2021 subjekti ka shqyrtuar dy kallzime penale të ketij shtetas, për të cilat ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Nga ana e Komisionit nuk është evidentuar ndonjë situatë e konfliktit të interesit të subjektit në trajtimin e dy kallzimeve penale, për shkak se: (i) në rastin e parë (gërma a më sipër), referuar rrethanave të çështjes, prokuroria nuk ka kompetencë lëndore për rregjistrimin e vepres penale, ashtu sikurse

⁷⁵Shihni opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias dhe vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

⁷⁶Shihni shkresën nr. ***, datë 29.3.2022 dhe shkresën nr. ***, datë 19.4.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë në dosjen e Komisionit.

dhe subjekti ka arsyetuar në vendim; (ii) në rastin e dytë (gërma b më sipër), referuar akteve shkresore, në datën 21.07.2021 shtetasi F. K. ka paraqitur kallzimin penal dhe në datën 30.7.2021 ky shtetas ka tërhequr kallzimin. Për më tepër, fakti që shtetasi F. K. ka kërkuar në dy raste në vitet 2016 dhe 2017 përjashtimin e subjektit për arsye të pavërtetuara (dhe pse janë pranuar), në vlerësim të Komisionit, nuk përbën shkak ligjor në kuptim të neneve 26 dhe 17 të K.Pr.P, që subjekti të kërkonte dorëheqjen nga trajtimi i kallzimeve penale në vitet 2018 dhe 2021.

Veç sa më sipër, ashtu sikurse rezultoi e vërtetuar dhe arsyetuar më sipër në këtë vendim, nuk ka pasur asnjë marrëdhënie të subjektit me shtetasin F. T. K. në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., shoqëri e cila ka qenë në cilësinë e sipërmarrësit në ndërtimin e një pallati ku subjekti ka banuar gjatë vitit 2016.

Në përfundim të procesit, Komisioni çmoi që, përveç faktit se nuk vërehen favorizime të shtetasit F. K. nga ana e subjektit (përkundrazi, këto fakte hedhin dritë mbi pretendimin e subjektit se ka pasur një marrëdhënie konfliktuale me këtë shtetas), nuk u evidentuan as shkelje procedurale apo veprime/mosveprime të subjektit që do të cenonin aftësitë e tij profesionale apo besimin e tij në publik.

Informacion i marrë nga mediat publike

86. Sipas artikullit të publikuar në mediat *online* me titull “Sarandë/Mafia e tokave e liroi drejtorin P. Zh. A do ta apelojë prokurori Kledian Llaho?”⁷⁷, vërehet se: (i) ditën e hënë, më 6 qershor, drejtori P. Zh. është rikthyer përsëri në zyrën dhe postin e tij të Bashkia e Sarandës, ku bashkë me kryebashkiakun A. G. kanë vijuar zullumet me dosjet e trojeve, tokave e lejeve të ndërtimit. Pra, gjyqtari Sh. L. e la të lirë, duke i dhënë të drejtën të shkojë në zyrë; (ii) çështja ka ngelur në dorën e prokurorit të Sarandës Kledian Llaho, nëse do ta ankimojë apo jo në Apel vendimin e gjyqtarit matrapaz Sh. L. për lirimin e drejtorit të Urbanistikës së Bashkisë Sarandë, P. Zh.; (iii) drejtori Zh. ka deklaruar në mjedise konfidenciale se “bosët e pushtetit” i kanë dhënë garanci që prokurori i çështjes Kledian Llaho, njëherazi dhe Drejtues i Prokurorisë së Sarandës, nuk do të bëjë ankim në Apel.

87. Bazuar në informacionin e bërë publik si më sipër, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të informojë bazuar në dokumente shkresore në lidhje me: (i) çfarë është kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Sarandë për shtetasin P.Zh.; (ii) nëse subjekti ka ankimuar vendimin e gjykatës dhënë nga gjyqtari Sh. L. për lirimin e shtetasit P. Zh.

88. Në parashtrimet e tij, subjekti duke pretenduar se shkrimi në artikull është i pasaktë, pasi ky shtetas vazhdon ende nën efektin e masës së sigurisë “arrest në shtëpi” dhe nuk është i liruar, sqaroi se për shtetasin P. Zh. prej tij është kërkuar masa e sigurisë “arrest në burg”, ndërsa gjyqtari i çështjes ka vendosur caktimin e masës së sigurisë “arrest në shtëpi”. Këtë pretendim e vërtetoi me kërkesën “Për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal ‘arrest në burg’” për shtetasin P. Zh. etj., datë 3.6.2022, të prokurorëve Kledian Llaho dhe A. Dh., si dhe vendimin nr. ***, datë 4.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, sipas të cilit për këtë shtetas është vendosur masa e sigurisë “arrest në shtëpi”.

⁷⁷ https://pamfleti.net/sarande-mafia-e-tokave-e-liroi-drejtorin-p***-zh***-a-do-ta-apeloje-prokurori-kledian-llaho/

Bazuar në këto prova shkresore, pretendimet e ngritura në artikull, të cilat nuk i referohen asnjë prove a dokumenti, nuk qëndrojnë, pasi rezultoi e dokumentuar që subjekti ka kërkuar “arrest me burg” për shtetasin P. Zh., masë e cila nuk është pranuar nga Gjykata, e cila ka vendosur masën “arrest shtëpie”. Në këtë mënyrë, rezultojnë të pavërteta informacionet në shkrimin *online* për këtë shtetas, sipas të cilit gjyqtari Shkëlzen Liçaj e la të lirë, duke i dhënë të drejtën të shkojë në zyrë.

Informacion i marrë pranë organeve ligjzbatuese

Në lidhje me dosjen e procedimit penal nr. ***

89. Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁷⁸ vuri në dispozicion dosjen e procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit M. B. etj., aktet e së cilës iu nënshtruan një analize të detajuar, duke evidentuar dhe dokumentuar në çdo rast veprimet hetimore të kryera nga subjekti përpara paraqitjes së akuzës përpara gjykatës, të cilat i janë bërë me dije subjektit duke u bërë pjesë e rezultateve të hetimit administrativ. Nga analizimi i të gjitha veprimeve hetimore, në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se: (i) nga data e regjistrimit të emrave të personave 12.6.2019 deri në datën 10.1.2020 të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim, çështja ka zgjatur 7 muaj; afatet e hetimit janë zgjatur një herë me 3 muaj dhe një herë me 1 muaj, dhe vendimet për zgjatje hetimesh janë të arsyetuara nga subjekti, duke përcaktuar dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme, të cilat janë kryer në mënyrë të plotë prej tij; (ii) subjekti ka kërkuar në gjykatë deklarin fajtor të katër të pandehurve, për dy nga të cilët gjykata ka vendosur sipas kërkesës së tij, ndërkohë që për dy të pandehur të tjerë ka vendosur pushimin e çështjes.

90. Pavarësisht këtyre konstatimeve, me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të vërë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 19.10.2020, të gjykatës, si dhe të japë sqarime e dokumente në lidhje me faktet: (i) është bërë ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale të procedimit penal nr. ***, nga “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, e kryer në bashkëpunim, me viktimë shtetasin A. Gj. dhe mbetur në tentativë ndaj shtetasit F. O., në veprën penale “vrasje nga pakujdesia” në dëm të shtetasit A. Gj., parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit M. B. (P.); (ii) me kërkesë të datës 18.12.2019 subjekti ka kërkuar shuarjen e masës “arrest në burg” dhe caktimin e një mase tjetër “arrest në shtëpi”, për shtetasit N. B., A. B. dhe J. B., të cilën Gjykata e ka konstatuar si të pabazuar në ligj dhe prova.

91. Në parashtrimet e tij sa i takon konstatimit të parë, subjekti në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar se:

i) Sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, pas një analize të hollësishme të provave, ai ka disponuar me urdhër për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale.

ii) Në vendimin nr. ***, datë 25.2.2020 të gjykatës, nuk janë konstatuar akte procedurale absolutisht të pavlefshme dhe akuzat e ngritura ndaj të pandehurit M. (B.) P. etj., nga pikëpamja e hetimeve të kryera dhe cilësimit juridik të veprave penale janë të plota. Kërkesa e organit të akuzës për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. ***, është e bazuar në prova dhe në ligj.

iii) Kjo çështje është gjykuar në themel edhe me vendimin nr. ***, datë 19.10.2020, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur, midis të tjerash, deklarin fajtor të të

⁷⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dosjen e Komisionit.

pandehurit M. B. (P.), për veprën penale “vrasje nga pakujdesia” në dëm të shtetasit A. Gj. dhe dënimin me 5 vjet burgim. Në arsyetim gjykata ka konstatuar *se formulimi i akuzave respektive për secilin prej të pandehurve është i drejtë dhe i bazuar. Nisur nga rrethanat e sqaruara më lart dhe përmbajtja e dispozitës, rezulton se kualifikimi ligjor i veprimeve të të pandehurit është i drejtë. Ky vlerësim është në harmoni të të gjitha provave dhe konkluzionit që del prej tyre.*

92. Në vlerësim të këtyre parashtrimeve dhe të gjitha rrethanave të çështjes, argumentet e subjektit konsiderohen bindëse dhe të bazuara, për shkak se: (i) ai ka ushtruar detyrën në përputhje me nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, duke kryer hap pas hapi një numër të konsiderueshëm veprimesh hetimore; (ii) ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale në bazë të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale ka ardhur për shkak të vlerësimit të provave dhe fakteve sipas bindjes së tij të brendshme në përputhje me nenin 3/2 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme; (iii) vlerësimi i subjektit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale mbështetet nga gjykata në vendimin nr. ***, datë 19.10.2020, i cili nuk është ankimuar, duke marrë formë të prerë, vendim i cili ka konstatuar se formulimi i akuzave ndaj të pandehurve është i drejtë dhe i bazuar.

93. Në kushtet kur nuk u evidentuan mangësi në procedura dhe as kanë munguar veprimet hetimore të domosdoshme për ngritjen e akuzës, e cila është mbështetur edhe nga gjykata me vendim të formës së prerë, Komisioni çmon se nuk mund të vlerësojë zgjidhjen në themel të çështjes apo të kryejë një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave, nga ajo e prokurorit të çështjes. Në të kundërt, do të gjendej në tejkallim të kompetencës si organ rivlerësimi në drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjektit bazuar në ligjin nr. 96/2016, neni 73/4, sipas të cilit: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”*. Po kështu, në trajtimin e kësaj çështjeje nuk u evidentua asnjë fakt e rrethanë në lidhje me veprime a mosveprime të subjektit të rivlerësimit, që do të cenonin besimin e tij në publik si pjesë e sistemit të drejtësisë. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji në vendimmarrjet e veta, në vendimin nr. 28, datë 23.10.2020, për subjektin F. V. dhe në vendimin nr. 20, datë 8.9.2020, për subjektin F. L.

94. Sa i takon konstatimit të dytë, se *me kërkesë të datës 18.12.2019 subjekti ka kërkuar shuarjen e masës “arrest në burg” dhe caktimin e një mase tjetër “arrest në shtëpi”, për shtetasit N. B., A. B. dhe J. B., të cilën Gjykata e ka konstatuar si të pabazuar në ligj dhe prova*, subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 19.10.2020, të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe vendimin nr. ***, datë 25.2.2020 me objekt “dërgimin e çështjes në gjyq”. Subjekti parashtrroi se në përpilimin e kërkesës së tij, ka vlerësuar që në kushtet kur personat nën hetim, për të cilët me vendimin nr. ***, data 15.6.2019, ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” pa afat dhe në datën 13.12.2019 ishin marrë të pandehur për vepra penale më të lehta, ishin tejkalluar afatet e paraburgimit. Nga aktet e dosjes rezulton se ky pretendim është i vërtetë, pasi për veprën penale “vrasje nga pakujdesia” dhe “armëmbajtje pa leje” (pas ndryshimit të akuzës së parë), afati i paraburgimit është gjashtë muaj dhe në datën 18.12.2019 kur subjekti ka bërë kërkesën, ky afat ishte tejkalluar.

Në vijim, subjekti argumenton se kërkesa është bërë vetëm për shkak të qasjes së tij me qëllim respektimin rigoroz të dispozitave procedurale. Ai shpjegon se nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të Gjykatës, duke qenë se në vijim hetimet ndodheshin në fazën përmbyllëse, dhe se, e ka vlerësuar qëndrimin e gjykatës thjesht si një interpretim të

ndryshëm ligjor. Sipas tij, kërkesa për shuarjen e masës nuk solli ndonjë efekt negativ në vijimin dhe zgjidhjen e çështjes.

95. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi të bazuara argumentet e subjektit, duke çmuar se kërkesa e tij për shuarjen e masës “arrest në burg” për shtetasit N. B., A. B. dhe J. B., të cilën Gjykata nuk e ka pranuar, ka qenë një vlerësim i tij bazuar në një interpretim ligjor⁷⁹ sipas këndvështrimit dhe bindjes së tij, për të cilën gjykata ka pasur një interpretim ndryshe. Më tej, sikurse edhe subjekti pretendoi, Komisioni çmon se kërkesa e subjektit nuk ka pasur asnjë pasojë negative në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, për shkak se kjo kërkesë nuk u pranua nga gjykata dhe, për më tepër, subjekti nuk e ka ankimuar vendimin e gjykatës, qëndrim i cili dëshmon mungesën e vullnetit dhe dëshirës për një favorizim të palëve në procesin e rivlerësimit.

Në lidhje me procedimin penal nr. ***

96. Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë vuri në dispozicion dosjen e procedimit penal nr. ***, me viktimë R. K. Në lidhje me këtë çështje ka pasur një informacion të marrë nga mediat *online* me titull “Vdiq se i ra vetrata e xhamit në kokë. Prokurori prej 2 vitesh zvarrit hetimin, kërcënon familjarët”. Në këtë artikull janë ngritur pretendime në lidhje me zvarritjen e hetimeve, mosmarrjen si provë të videos së ngjarjes, mosadministrimin e aktit të ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe, ngrihen pretendime për një debat mes prokurorit dhe djalit të viktimës, i cili degjeneroi në dhunë verbale dhe fizike.

Pasi janë shqyrtuar të gjitha aktet e dosjes, nga ana e Komisionit janë evidentuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes, të cilat janë bërë pjesë e rezultateve të hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se: (i) nga data e regjistrimit të procedimit penal, datë 29.3.2018, deri në datën e dërgimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim, çështja ka zgjatur 2 vjet e 3 muaj, afat gjatë të cilit nga ana e subjektit janë kryer disa veprime hetimore në mënyrë të vijueshme pa u evidentuar zvarritje në hetime; (ii) subjekti ka dërguar tre persona për gjykim të akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyre”.

97. Pavarësisht këtyre konstatimeve, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti iu kërkua të japë sqarime e dokumente në lidhje me: (i) ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale të procedimit penal nr. *** nga “shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë” në “vrasje nga pakujdesia”, si dhe në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës, duke paraqitur vendimin e saj; (ii) faktin se janë paraqitur memorie dhe kërkesa me shkrim nga të pandehurit, të cilët kanë kërkuar kryerjen e veprimeve hetimore, por nga aktet në dosje nuk rezulton që prokurori të jetë shprehur me vendim sipas parashikimit të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale; (iii) pretendimet e ngritura në median *online*.

98. Në parashtrimet e tij, sa i takon ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, subjekti ka sqaruar se ka vepruar sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se prokurori gjatë fazës së hetimit paraprak, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, mund të urdhërojë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës. Subjekti parashtron se gjykata si me vendimin nr. ***, datë 7.10.2020, për kthimin e akteve prokurorisë, ashtu edhe me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, me objekt

⁷⁹Në bazë të nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale, afati i kohëzgjatjes së paraburgimit humbet fuqinë në qoftë se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në 10 vjet burgim pa u dorëzuar aktet në gjykatë.

“dërgimin e çështjes në gjyq”, nuk ka marrë në analizë aktin procedural “urdhër për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës”, por është mjaftuar me analizën e kërkesave të prokurorit. Në të tilla kushte, gjyqtari i seancës paraprake duke pranuar në tërësi të dyja kërkesat e prokurorit, me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, ka pranuar rrjedhimisht edhe logjikën juridike të parashtruar në aktet e prokurorit.

99. Subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 7.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë “Mbi kthimin e akteve Prokurorisë Vlorë” dhe vendimit nr. ***, datë 26.1.2021, me objekt “dërgimin e çështjes në gjyq”, në të cilat vërehet se:

- Sipas vendimit nr. ***, datë 7.10.2020, çështja i është kthyer Prokurorisë për plotësim hetimesh duke u shprehur se: (i) nuk ka prova të mjaftueshme në ngarkim të të tre të pandehurve; (ii) të pandehurit pretenduan se nuk u është vënë në dispozicion projekti i miratuar i KRT-së Bashkia Vlorë, dhe se, organi i akuzës nuk ka hetuar nëse ka pasur ndryshime në projekt, pretendim i cili duhet të hetohet nga prokurori; (iii) prokurori duhet të marrë sqarime nga të gjithë ekspertët që kanë bërë aktekspertimin.

- Pas kryerjes së këtyre veprimeve hetimore nga ana e subjektit, çështja ka kaluar për gjykim me kërkesë të prokurorit Llaho dhe gjykata me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, dërgoi çështjen për gjykim me po të njëjtën akuzë e të njëjtët të pandehur të paraqitur si në kërkesën e subjektit. Gjykata, ndër të tjera, është shprehur se: (i) prokurori, pasi ka kryer veprimet hetimore sipas orientimit të gjykatës, i ka paraqitur gjykatës kërkesën me të njëjtin objekt; (ii) me plotësimin e hetimeve ka bazë të mjaftueshme në ngarkim të të pandehurve dhe se në këtë moment procedural hetimet janë të plota; (iii) sa i takon të dyshuarit A. H., ka vlerësuar se nuk janë konsumuar elementet e veprës penale “vrasje nga pakujdesia”. Në përfundim, gjykata ka vendosur dërgimin për gjykim në ngarkim të të pandehurve dhe pushimin e çështjes për shtetasin A. H.

100. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve shkresore, vërehet se pretendimi i subjektit se në të dyja vendimet e saj gjykata nuk ka marrë në analizë aktin procedural “urdhër për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës”, duke qenë në të njëjtën vijë logjike me subjektin, është i bazuar. Kjo për faktin se, përfundimisht Gjykata me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, ka pranuar kërkesën e prokurorit të çështjes, duke e dërguar çështjen në gjykim me të njëjtën akuzë dhe të njëjtët të pandehur të paraqitur në këtë kërkesë. Është e vërtetë se me vendimin nr. ***, datë 7.10.2020, çështja i është kthyer Prokurorisë për plotësim hetimesh, detyrë që subjekti e përmbushi, por të gjitha veprimet hetimore shtesë të kryera ishin në funksion të së njëjtës kërkesë të paraqitur në Gjykatë.

Sa i takon ndryshimit të cilësimit juridik në bazë të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, Komisioni, pasi ka evidentuar se subjekti ka kryer një numër të konsiderueshëm veprimesh hetimore në afate të justifikuara ligjrisht, çmon se subjekti ka vepruar në përputhje me nenin 3/2 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit magjistrati ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme. Parë nën këtë këndvështrim, Komisioni çmon gjithashtu se nuk mund të vlerësojë zgjidhjen në themel apo kryejë një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të dhëna nga prokurori i çështjes, në të kundërt, do të gjendej në tejkallim të kompetencës si organ rivlerësimi në drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjektit sipas nenit 73/4 të ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”*, qëndrim i mbajtur edhe nga Kolegji. Për më tepër, në vendimin nr. ***,

datë 26.1.2021, gjykata nuk ka evidentuar fakte dhe rrethana që do të çonin në një cilësim ligjor të veprës penale të ndryshëm nga ai i subjektit të rivlerësimit, duke e dërguar çështjen në gjyq për të njëjtën akuzë dhe të njëjtët të pandehur.

101. Sa i takon faktit që janë paraqitur memorie dhe kërkesa me shkrim nga të pandehurit, të cilët kanë kërkuar kryerjen e veprimeve hetimore, por nga aktet në dosje nuk rezulton që prokurori të jetë shprehur me vendim sipas parashikimit të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti sqaroi se, në fazën e përfundimit të hetimeve dhe pasi janë njohur me to, të pandehurit kanë parashtruar kërkesa me qëllim që prokurori të kryente veprime të tjera dhe në alternativë të ndryshonte qëndrimin ndaj tyre, ndërsa përpara gjyqtarit në seancën paraprake kanë shprehur dakordësinë e tyre me veprimet e prokurorit, duke kërkuar që çështja të zgjidhej sipas ritit të gjykimit të shkurtuar. Subjekti argumenton se Gjykata ka vlerësuar që veprimet hetimore janë kryer në mënyrë të plotë, dhe se, organi i akuzës ka siguruar një bazë të mjaftueshme provueshmërie për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurave. Sipas subjektit, për shkak të ngarkesës tepër të lartë dhe presionit që të pandehurit dhe mbrojtësit ushtronin me sjelljet e tyre, nuk është bërë i mundur përpilimi nga ana formale e një vendimi për refuzimin e kryerjes së veprimeve të tjera, ndonëse moskthimi i përgjigjes nënkupton refuzim të kërkesës.

Siç vërehet, në përpjekje për të justifikuar mospërpilimin nga ana formale të refuzimit të kërkesave të të pandehurve, subjekti e ka pranuar që nuk ka vepruar sipas parashikimit të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithsesi, në konsideratë të faktit se të pandehurve, të cilët kanë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar, u janë siguruar mundësitë procedurale për paraqitjen e provave mbi mbrojtjen e tyre, ashtu sikurse është shprehur edhe Gjykata në vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, Komisioni vlerësoi se mangësia e konstatuar është e një niveli formal, pa ndonjë peshë specifike në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

102. Veç sa më sipër, në parashtrimet e veta subjekti sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit në vendimin nr. ***, datë 3.11.2021, pika 84, sipas të cilit kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. {***} e vitit 2017 ka qenë në shqyrtim gjyqësor në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, për pasojë ky i fundit ndodhej në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Pra, subjekti pretendon që Komisioni ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për të vlerësuar rastin në fjalë, duke paraqitur shkresë përcjellëse nr. *** prot., datë 2.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas së cilës çështja ndodhet në gjykim në themel. Komisioni vlerëson se, pavarësisht se çështja është në shqyrtim gjyqësor, nuk gjendet në kushtet e vendimmarrjes së Kolegjit, referuar nga ana e subjektit, pasi veprimet hetimore të kryera prej tij në rastin objekt verifikimi kanë përfunduar dhe çështja është dërguar dhe pranuar për gjykim, ku të pandehurit kanë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji në raste të ngjashme (arsyetuar hollësisht në paragrafin 80.3 të këtij vendimi).

103. Në lidhje me pretendimet e ngritura në artikull, subjekti sqaroi se: (i) sikurse është konstatuar, zgjatja e afatit të hetimeve ka ndodhur për shkaqe objektive, kryesisht për shkak të aktekspertimit tekniko-ligjor, i cili ka kërkuar thuhetse 6 muaj kohë dhe periudhës së pandemisë Covid-19 dhe sipas tij, hetimet paraprake, duke përfshirë edhe periudhën kohore të pandemisë, kanë zgjatur gjatë periudhës mars 2018 - maj 2020 dhe kohëzgjatja ka qenë vetëm për shkaqe objektive dhe jo për neglizhencë apo zvarritje të prokurorit; (ii) në lidhje me mosadministrimin e një videoje të pretenduar, sqaron se asnjëherë nuk është vënë në dispozicion as nga djali i viktimës dhe as nga përfaqësuesi i tij ligjor dhe, nëse ka pasur një të tillë, ajo do të duhej të ishte administruar nga policia

gjyqësore në momentet e para pas ngjarjes; (iii) lidhur me mungesën e aktekspertimit mjeko-ligjor, pretendon se vonesa në kohë e dërgimit të akteve mjeko-ligjore ka qenë fenomen i vazhdueshëm në veprimtarinë e punës së prokurorëve, edhe pse nga titullari i Institucionit të Prokurorisë i është tërhequr vëmendja Institutit të Mjekësisë Ligjore; (iv) i konsideron të pabazuara dhe të pavërteta pretendimet për konfliktin midis subjektit dhe djalit të viktimës.

104. Pretendimet e subjektit në lidhje me kohëzgjatjen e hetimeve janë të bazuara, pasi nga analiza e detajuar e akteve shkresore të dosjes penale ka rezultuar se afatet e hetimeve apo zgjatjet e tyre janë justifikuar gjithmonë me veprime hetimore të kryera në mënyrë të vijueshme nga subjekti. Sa u takon pretendimeve mbi mosadministrimin e provave, si videoja e ngjarjes dhe aktekspertimi, çmohet se, pavarësisht argumenteve të subjektit, në kushtet kur gjykata është shprehur se *organi i akuzës ka siguruar një bazë të mjaftueshme provueshmërie për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve*, Komisioni nuk mund të kryejë vlerësime të mëtejshme në lidhje me provat e paraqitura nga subjekti për mbështetjen e akuzës. Sa u takon pretendimeve në artikull për konfliktin midis subjektit dhe djalit të viktimës, si në artikullin *online*, por edhe nga burime të tjera, nuk ka pasur të dhëna e prova që vërtetojnë këto pretendime.

Në përfundim të procesit, Komisioni nuk evidentoi elemente që cenojnë aftësitë profesionale apo besimin në publik të subjektit, në trajtimin e çështjes penale nr. ***.

Në lidhje me çështjen e shtetasit P. P.

105. Për shtetasin P. P., Prokuroria e Rrethit Vlorë ka informuar se nga ana e subjektit janë trajtuar 2 çështje për këtë shtetas⁸⁰, si dhe ka vënë në dispozicion disa dokumente nga të cilat rezultoi se:

105.1. Subjekti ka marrë një vendim mosfillimi për kallëzimin penal nr. ***. Nga analizimi i akteve të dosjes rezultoi se:

- Në datën 23.3.2021, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë ka dërguar materialet procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe, sipas shortit të datës 24.3.2021, materiali kallëzues nr. ***, datë 24.3.2021, i është caktuar për ndjekje prokurorit Kledian Llaho.

- Në datën 13.4.2021, prokurori Llaho ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, datë 30.3.2021, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në vendim subjekti ka paraqitur rrethanat e kallëzuara nga shtetasi P.B., i cili në vitin 2018 ishte njohur me shtetasin P. P. dhe ky i fundit i kishte thënë se do ta ndihmonte për marrjen e pronave nga hipoteka kundrejt dhënies së një shume. Kallëzuesi P. B. ka firmosur një kontratë për të marrë disa lekë nga shtetasi A. K., që ia kishte sugjeruar shtetasi P. P., por këtë kontratë e ka firmosur pa e lexuar. Prokurori Llaho, pasi ka analizuar elementet e veprës penale “mashttrim”, ka arsyetuar se pretendimet e natyrës teknike në lidhje me modalitetet e kontratës noteriale janë pretendime që i përkasin juridiksionit civil. Për çdo pretendim në lidhje me aktin noterial “kontratë shitblerjeje e të drejtës reale”, kallëzuesi mund t’i drejtohet gjykatës dhe pretendimet mund të zgjidhen vetëm përmes paraqitjes së padisë në gjykatë. Bazuar në nenet 24/2 dhe 290/1 “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur mosfillimin e këtij procedimi.

- Nga gjithë sa më sipër, përveç faktit që vendimi i mosfillimit është marrë 20 ditë pas regjistrimit, pra 5 ditë jashtë afatit të përcaktuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës

⁸⁰Shihni komunikimin me *email* të datës 24.11.2022.

Penale, nuk vërehen problematika të tjera. Vendimi është i arsyetuar dhe janë analizuar elementet e veprës penale të parashikuara nga neni 143 i Kodit Penal.

105.2. Prokurori Kledian Llaho, me autorizimin e datës 20.10.2015, ka përfaqësuar në gjykim çështjen penale që i përket procedimit penal nr. ***. Në lidhje me këtë procedim, nga analizimi i akteve të përcjella, rezulton se:

- Prokurori M. S., në datën 16.4.2009, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “falsifikim dhe përdorim të dokumenteve të falsifikuara”, “falsifikim të dokumenteve nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin” dhe “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga nenet 186, 186/3 dhe 248 të Kodit Penal.

- Prokurorja E. H., në datën (ditë/muaj s’ka) 2015, ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë gjykimin e çështjes nr. *** me të pandehur P. P., i akuzuar për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, etj.

- Me autorizimin datë 20.10.2015 të Drejtuesit të Prokurorisë, është autorizuar z.Kledian Llaho që të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në gjykatë. Në konkluzionet përfundimtare, subjekti ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin e shtetasit P. P. për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1⁸¹ i Kodit Penal, me 1 vit e 6 muaj burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin datë 3.4.2018, ka vendosur dënimin e shtetasit P. P. për veprën penale “falsifikim të dokumenteve” me 3 vjet burgim.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk kanë rezultuar problematika që do të bënin të domosdoshme kryerjen e verifikimeve të tjera për subjektin e rivlerësimit, i cili në ushtrim të funksioneve të caktuara me ligj, sipas neneve 24 dhe 25 të Kodit të Procedurës Penale, ka përfaqësuar organin e akuzës vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, duke kërkuar deklarinimin fajtor të shtetasit P. P. dhe dënimin sipas parashikimit të nenit 186/1 të Kodit Penal, sipas vlerësimit të provave të grumbulluara nga organi i akuzës.

Në lidhje me shtetasin R. H.

106. Në lidhje me këtë shtetas u kryen disa kërkime, me qëllim evidentimin e hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit. Konkretisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë⁸² ka informuar se nuk ka dosje penale që i përket shtetasit R. H. Nga komunikimi me Ministrinë e Drejtësisë rezulton se ky shtetas është dënuar në vitet 2013, 2017 dhe 2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Kjo gjykatë vuri në dispozicion tri vendime gjyqësore të këtyre viteve, nga shqyrtimi i të cilave nuk rezultoi që subjekti të ketë qenë prokuror i ndonjëres prej çështjeve⁸³.

107. Pas kërkesës së Komisionit me *email* të datës 25.11.2022 për informacion në lidhje me shtetasin R. H., subjekti ka informuar se nuk ka hetuar çështje penale në ngarkim të këtij shtetasi, si dhe ka dhënë informacion në lidhje me procedimin penal nr. ***, në kuadër të të cilit janë zhvilluar hetime ndaj këtij shtetasi. Në mënyrë të përmbledhur, në deklarinimet e tij, subjekti ka informuar se:

⁸¹Neni 186/1 i Kodit Penal “*Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet*”.

⁸²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe *email* datë 17.11.2022, në dosjen e Komisionit.

⁸³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 21.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër në dosjen e Komisionit.

a. Hetimet për procedimin penal nr. *** janë drejtuar fillimisht nga prokurori E. H. dhe, pas transferimit të tij, nga prokurorja A. Dh.

b. Në vijim, në datën 4.7.2022, është proceduar me vendim për zëvendësimin e prokurores A. Dh. dhe hedhjen në short për prokurorin që do të vijonte me hetimin e çështjes, në përfundim të të cilit prokurori i çështjes u caktua subjekt i rivlerësimit.

c. Subjekti deklaron se në cilësinë e prokurorit nuk është kryer asnjë veprim hetimor prej tij, duke deklaruar se: *“Pas analizës së akteve në dosje, në vlerësimin dhe bindjen time kam përpiluar dy kërkesa në datën 19.9.2022; një për dërgimin e çështjes në gjyq dhe një kërkesë për pushim të pjesshëm të akuzës, të cilat po jua vë në dispozicion”*.

d. Sa i takon statusit aktual të çështjes, subjekti deklaron se aktualisht kjo çështje ndodhet për shqyrtim pranë gjyqtarit të seancës paraprake në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

108. Në mbështetje të këtyre deklarimeve, subjekti ka paraqitur: (i) shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2022, drejtuar Komisionit të Policisë Sarandë mbi marrjen e masave për mbajtjen nën vëzhgim të vazhdueshëm të shtetasit R. H.; (ii) kërkesë e datës 19.9.2022 e subjektit, për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. ***; në ngarkim të të pandehurve R. H. dhe S. I.; (iii) kërkesë e datës 19.9.2022 e subjektit për pushimin e pjesshëm të akuzës në funksion të çështjes penale nr. *** në ngarkim të të pandehurit R. H.

109. Në përfundim të hetimit administrativ, ka pasur paqartësi në lidhje me procedurën e caktimit të çështjes subjektit të rivlerësimit përmes zëvendësimit të prokurores së mëparshme. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë paqartësi, duke paraqitur aktet procedurale të zëvendësimit të prokurores së çështjes nga ana e tij, si procesverbalet e hedhjes së shortit, vendimin e zëvendësimit etj., si dhe të vërtetojë me dokument shkresor zyrtar statusin aktual të çështjes.

110. Në parashtrimet e tij, subjekti paraqiti shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, sipas së cilës kërkesa “për dërgimin e çështjes në gjyq dhe pushimin e pjesshëm të hetimeve”, në kuadër të procedimit penal nr. ***, është duke u gjykuar në seancë paraprake. Referuar këtij fakti, subjekti sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit për një rast të ngjashëm, konkretisht vendimin nr. 33, datë 3.11.2021, ku në pikën 84 është konkluduar se: *“Në këto kushte, rezulton se kërkesa për pushimin e çështjes penale të vitit 2017 ka qenë në shqyrtim gjyqësor në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, për pasojë ky i fundit ndodhej në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: ‘Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim’”*.

111. Pavarësisht referimit si më sipër, duke vijuar me të njëjtat deklarime, ashtu si dhe gjatë hetimit administrativ, në parashtrimet e veta, subjekti ka paraqitur shkaqet e ndryshimit të prokurores A. Dh. dhe procedurat ligjore të kryera me këtë qëllim duke vënë në dispozicion disa dokumente shkresore⁸⁴, nëpërmjet të cilave vërtetohet se:

⁸⁴Shihni vendimin për zëvendësimin e prokurorit E. H., datë 19.10.2021; vendimin për zëvendësimin e prokurores A. Dh., datë 4.7.2022; urdhër për zhvillimin e procedurave për hedhjen e shortit, datë 7.7.2022; procesverbal për zhvillimin e procedurave për hedhjen e shortit datë 7.7.2022; kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes, datë 14.6.2022; shkresë e datës 17.6.2022 + vendim shqyrtim kërkesë datë 16.6.2022; kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes, datë 20.6.2022; relacion mbi kërkesën për zëvendësim të prokurores A. Dh., datë 27.6.2022; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

- Me kërkesë për përjashtimin e prokurores A. Dh., datë 14.6.2022, shtetasi R. H. pretendon për njëanshmëri nga ana e prokurores A. Dh., në kuadër të procedimit nr.***.
- Me vendim të datës 16.6.2022 prokurorja A. Dh. ka vendosur rrëzimin e kërkesës për shtetasin R. H., për përjashtimin e saj.
- Në datën 20.6.2022, shtetasi R. H. ka paraqitur një kërkesë tjetër për zëvendësimin e prokurores A. Dh.
- Në datën 27.6.2022, prokurorja A. Dh. ka përgatitur një relacion drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë Kledian Llaho, ku ka parashtruar se kërkesa e shtetasit R. H. është e pabazuar, pasi ajo nuk ka treguar njëanshmëri. Në këtë relacion ka kërkuar që për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimeve të vazhdueshme për njëanshmëri, të vlerësohet nga drejtuesi zëvendësimi i saj.
- Në datën 4.7.2022, subjekti në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurores A. Dh. dhe caktimin e një prokurori tjetër përmes një procedure shorti manual, duke arsyetuar, ndër të tjera, se shtetasi R. H. ka krijuar perceptim subjektiv për veprimtarinë e prokurores dhe sipas relacionit çështja paraqitet komplekse. Në këto kushte, veprimtaria e magjistratit duhet dhe të duket e paanshme.
- Në datën 7.7.2022 është zhvilluar shorti në praninë e tre prokurorëve dhe, sipas procesverbalit me këtë datë, çështja i ka kaluar prokurorit Kledian Llaho.

112. Në përfundim të procesit vlerësohet se, duke qenë që çështja për shqyrtimin e kërkesave të subjektit është në proces shqyrtimi nga gjykata, ashtu si me të drejtë subjekti referon qëndrimin e mbajtur në një rast të ngjashëm nga Kolegji, Komisioni ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, sipas parashikimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, Komisioni nuk ka kryer verifikime dhe as i ka kërkuar sqarime/barrë prove subjektit në lidhje me kërkesat e paraqitura gjykatës për shtetasin R. H. Por, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në parashtrime, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumente shkresore për sa i është kërkuar nga Komisioni në lidhje me zëvendësimin e prokurores A. Dh. dhe procedurat e ndjekura me këtë rast. Nga ana e subjektit si drejtues i prokurorisë janë argumentuar dhe justifikuar ligjërisht shkaqet e zëvendësimit të prokurores A.Dh., si dhe u vërtetua që zëvendësimi i kësaj prokuroreje me subjektin e rivlerësimit është kryer sipas procedurave ligjore nëpërmjet shortit. Referuar këtyre veprimeve të ndërmara nga subjekti dhe rrethanave në të cilat është vlerësuar zëvendësimi i prokurores A. Dh., Komisioni nuk mund të çmojë që informacionet e marra nga organet ligjzbatuese kanë qenë të vërteta. Për më tepër, këto informacione kanë qenë në kuadër dyshimesh të pavërtetuara me ndonjë të dhënë a provë konkrete.

Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Sarandë, datë 16.8.2022, administruar në Prokurori në datën 28.9.2022; dëftesë komunikimi, datë 28.9.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për vendimin e datës 16.8.2022; shkresë nr. *** prot., datë 29.9.2022, drejtuar Komisarariatit të Policisë Sarandë; deklaratë nga prokurore A. Dh., datë 4.7.2022, për heqjen dorë nga procedimi penal nr. ***; vendim për pranimin e kërkesës për heqje dorë të prokurorit, datë 11.7.2022; shkresë përcjellëse për Komisarariatit e Policisë Sarandë, nr. *** prot., datë 4.10.2022 + akt procedural, datë 4.10.2022.

113. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar edhe në opinionin e Komisionit të Venecias⁸⁵ dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁸⁶, të cilat kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të germës “e” të Aneksit të Kushtetutës, apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

Po kështu, Komisioni, pasi ka administruar në çdo rast dosjet penale për të gjitha çështjet që dispononte informacione konfidenciale, dhe jo vetëm, ka analizuar në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet hetimore të kryera nga subjekti dhe rrethanat në të cilat janë marrë vendimet e vëzhguara. Në përfundim të analizimit të çdo çështjeje, ka konstatuar se: (i) subjekti ka ushtruar detyrën sipas parashikimeve ligjore mbi rolin e prokurorit si përfaqësues i organit të akuzës, duke u mbështetur në provat e administruara pas një hetimi gjithëpërfshirës dhe bindjen e brendshme; (ii) në asnjë prej çështjeve të analizuara nuk u vërtetua që vendimmarrjet kanë pasur si qëllim favorizimin apo shkeljen e të drejtave të palëve në proces, pasi u vërtetua që ato kanë qenë pasojë e një vlerësimi në koherencë të plotë me provat e administruara, por edhe me qëndrimin e gjykatave. Për rrjedhojë, nuk u vërejtën elemente që të krijojnë bindjen se subjekti me veprimet ose me mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut si pjesë e sistemit të drejtësisë.

Në përfundim, për subjektin është vlerësuar se: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016; si dhe (iv) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

114. Në datën 19.12.2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho, në përfundim të së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Kledian Llaho dhe shpalli vendimin në seancën e datës 22.12.2022, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

115. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me

⁸⁵Shihni opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias.

⁸⁶Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr.84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi u është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve. Gatishmëria dhe qëndrimi bashkëpunues janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

116. Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare/kundër

*Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli*